

VENDIM
Nr. 00-2024-2162 (275), datë 6.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir Panda	kryesues;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Medi Bici	anëtar;
Sandër Simoni	anëtar,

më datë 6.11.2024, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që u përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

KUNDËR: Gjergj Lekaj

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sandër Simoni; përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorin Alfred Progonati, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 110, datë 30.7.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër, mbrojtësin e të gjykuarit Gjergj Lekaj, avokat Petrit Hysi, i cili kërkoi, prishjen e vendimit nr. 110, datë 30.7.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 194, datë 19.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se, më datë 8.7.2010, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur kallëzim penal shtetasi Pashuk Masmalaj, duke pretenduar se shtetasi Gjergj Lekaj në cilësinë e drejtorit pranë shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. ka shpërdoruar kompetencat e tij. Më datë 4.6.2004, në bazë të aktit të themelimit, themeluesit Gjergj Lekaj dhe Brunilda Kromiçi kanë vendosur të themelojnë shoqërinë “Emanuel Gas” sh.a. Më datë 17.6.2004, me anë të vendimit nr. 31777, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë vendimi për regjistrimin si person juridik të shoqërisë tregtare pa ofertë publike “Emanuel Gas” sh.a. me aksioner Gjergj Lekaj dhe Brunilda Kromiçi, ku të dy aksionerët zotëronin nga 50% të aksioneve. Shoqëria kishte si objekt të veprimtarisë së saj import-eksportin e gazit natyror të lëngshëm, tregtimin me shumicë dhe pakicë etj. Aksionerët e shoqërisë kanë nënshkruar edhe statutin e shoqërisë anonime pa ofertë publike “Emanuel Gas” sh.a., ku janë përcaktuar edhe organet e shoqërisë. Kështu, sipas statutit organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve, që përbëhet nga të gjithë aksionerët dhe do të ketë kompetenca në bazë të ligjit nr. 7632, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” (ligji në fuqi në momentin e krijimit të shoqërisë), si dhe nga statuti. Tjetër organ i parashikuar në statut është edhe këshilli mbikëqyrës që zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe ushtron kontroll të vazhdueshëm për mënyrën në të cilën drejtoria administron shoqërinë. Sipas statutit anëtar të Këshillit Mbikëqyrës janë Emiljan Kromiçi (njëkohësisht edhe në cilësinë e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës), Marjeta Lekaj dhe Brunilda Kromiçi. Tjetër organ i shoqërisë është edhe drejtoria që administron aktivitetin dhe biznesin e shoqërisë nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës dhe si anëtar i drejtorisë është zgjedhur shtetasi Gjergj Lekaj, i cili njëkohësisht ka pasur edhe funksionin e drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë.

2. Me anë të vendimit nr. 1, datë 4.9.2004 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të shoqërisë ka vendosur të pranojë kërkesën e aksionerëve, ku Gjergj Lekaj ka vendosur t'i shesë shtetasit Ludovik Masmalaj 20% të aksioneve dhe Brunilda Kromiçi ka vendosur t'i shesë Arta Masmalaj 20% të aksioneve të saj. Në bazë të kësaj vendimmarrje, shoqëria "Emanuel Gas" sh.a. është bërë me 4 aksionerë, ku aksionerët Gjergj Lekaj dhe Brunilda Kromiçi zotëronin nga 30% të aksioneve, ndërsa shtetasit Ludovik Masmalaj dhe Arta Masmalaj nga 20% të aksioneve.

3. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, shoqëria "Emanuel Gas" sh.a., me anë të kontratës së kredisë nr.rep.2582 dhe nr.kol.1528, datë 27.12.2005 ka marrë një kredi bankare pranë bankës "BKT" sh.a., ku limiti total i kredisë së miratuar ka qenë në shumën 500.000 USD (që më pas është konvertuar në monedhën lek). Konkretisht, sipas kësaj kontrate rezulton se kredidhënës është Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (dega Lezhë), ndërsa kredimarrës është shoqëria "Emanuel Gas" sh.a. me aksionerët Gjergj Lekaj, Brunilda Kromiçi, Ludovik Masmalaj dhe Arta Masmalaj, ku konstatohet se kontrata është nënshkruar rregullisht nga të gjithë personat e përfshirë në kontratë. Në shkresën me nr.prot.147, datë 27.4.2010 të BKT sh.a. jepen në mënyrë të detajuar kreditë e marra pranë kësaj banke, ku rezulton se shuma totale e kredisë së disbursuar për shoqërinë "Emanuel Gas" sh.a. është 46,280,000 lekë. Në vijim të shkresës, përcaktohet se shoqëria "Emanuel Gas" sh.a. deri në fund të muajit mars 2010 ka qenë shumë korrekte në marrëdhëniet me bankën dhe në likuidimet e detyrimeve shtetërore, duke kryer të gjitha veprimet nëpërmjet degës së BKT sh.a. Lezhë, ndërsa për këstin e muajit prill 2010 ka filluar të paraqesë vonesa për likuidimin e kësteve.

4. Më datë 17.5.2008, ndërmjet qiradhënësit "Emanuel Gas" sh.a. dhe qiramarrësit Gjergj Lekaj është lidhur kontrata e qirasë me nr.rep.4578 dhe nr.kol.899/1, sipas së cilës qiradhënësi i jep me qira shtetasit Gjergj Lekaj një pasuri të paluajtshme, me sipërfaqe 1970 m², e llojit truall+ndërtesë. Afati i kontratës është 5 vjet me të drejtë përsëritje dhe vlera e qirasë për objektin e kontratës është 5600\$ në muaj. Nga kontrata rezulton se qiradhënia është bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë dhe vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të datës 15.5.2008.

5. Duke qenë se midis aksionerëve kanë lindur konflikte, më datë 24.4.2010 është larguar nga detyra shtetasi Gjergj Lekaj, duke u bërë administrator pranë shoqërisë shtetasja Majlinda Përgega, detyrë që e ka mbajtur deri më datë 7.6.2010, duke qenë se pas kësaj date, administrator i shoqërisë është bërë shtetasi Pashuk Masmalaj. Më datë 1.12.2010 është larguar aksioneri Gjergj Lekaj, ndërsa aksionerët Arta Masmalaj dhe Brunilda Kromiçi pas largimit të aksionerit Gjergj Lekaj janë bërë zotëruese të aksioneve prej 40% secila, kurse shtetasi Ludovik Masmalaj ka pasur 20% të aksioneve. Më datë 14.1.2011, statusi i shoqërisë është pezulluar, ndërsa më datë 15.8.2011 është larguar edhe shtetasi Ludovik Masmalaj dhe si rrjedhojë aksionere të vetme të shoqërisë kanë qenë shtetaset Arta Masmalaj dhe Brunilda Kromiçi, të cilat kanë zotëruar secila prej tyre nga 50% të aksioneve të shoqërisë. Të dhënat e mësipërme rezultojnë nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri anonime sh.a.", lëshuar nga QKR-ja më datë 11.5.2012.

6. Për sa i përket largimit të aksionerit Gjergj Lekaj nga shoqëria, rezulton se më datë 15.11.2010 është marrë një vendim i jashtëzakonshëm nga aksionerët e shoqërisë "Emanuel Gas" sh.a., konkretisht vendimi nr. 1, datë 15.11.2010, ku sipas këtij vendimi është vendosur transferimi i aksioneve të aksionerit Gjergj Lekaj prej 30% tek aksionerët e tjerë të shoqërisë Brunilda Kromiçi (10%) dhe Arta Masmalaj (20% të aksioneve). Në bazë të kësaj vendimmarrjeje, më datë 15.11.2010 është lidhur edhe kontrata e shitjes së aksioneve të shoqërisë me nr. rep.3604 dhe nr.kol.3142, ku pala shitëse Gjergj Lekaj i ka shitur palës blerëse Brunilda Kromiçi dhe Arta Masmalaj 30% të aksioneve që disponon në shoqërinë "Emanuel Gas" sh.a. Në kontratë përcaktohet se shoqëria ka një kredi në BKT sh.a. në shumën 52.000.000 lekë për të cilën aksionerët e shoqërisë kanë rënë dakord që ta shlyejnë atë, ndërsa shtetasi Gjergj Lekaj nga shitja e aksioneve do të marrë shumën prej 8.400.000 lekësh.

7. Më datë 14.5.2012, me anë të kontratës së shitjes së aksioneve "Emanuel Gas" sh.a. me nr.rep.1650 dhe nr.kol.303, pala shitëse e përbërë nga Brunilda Kromiçi dhe Arta Masmalaj, i

kanë shitur blerësit Gjergj Lekaj, aksionet pranë shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a., 100% të aksioneve. Në këtë kontratë përcaktohet shprehimisht se shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. ka një kredi në degën BKT sh.a. në Lezhë në shumën 500.000 USD e konvertuar në lekë sipas kontratës së kredisë me nr.rep.5286 dhe nr.kol.1653, datë 2.12.2010 për të cilën aksioneri i ri i shoqërisë ka rënë dakord që ta shlyejë atë. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala shitëse zhvishet nga të gjitha detyrimet e saj në raport me shoqërinë “Emanuel Gas” sh.a. dhe pala shitëse konsiderohet e likuiduar. Ndërsa, në vendimin e mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a., datë 11.5.2012 përcaktohet se me shitjen e aksioneve, Brunilda Kromiçi dhe Arta Masmalaj kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. ka me të tretët, blerësit Gjergj Lekaj.

8. Prokuroria në kërkesën e paraqitur për gjykim ka pretenduar, se i pandehuri Gjergj Lekaj ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së, për shkak se nuk ka paguar qiranë sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve; nuk ka mbajtur mbledhje të rregullt vjetore; ka ndryshuar termat e kontratës së kredisë së lidhur me BKT sh.a. në vitin 2005 pa miratimin e shoqërisë i ka dhënë hua shoqërive të treta etj., ku pa analizuar në mënyrë konkrete veprimet, por duke u bazuar kryesisht vetëm tek akti i ekspertimit ka vlerësuar se shtetasi Gjergj Lekaj, në cilësinë e drejtorit të shoqërisë ka shpërdoruar kompetencat e njohura me statut e me ligj, duke dëmtuar interesat e shoqërisë për interesa të tij.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me anë të vendimit nr. 134, datë 25.7.2013 ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Gjergj Lekaj për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me anë të vendimit nr. 68, datë 17.2.2014 ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues. Në këtë vendim Gjykata e Apelit Shkodër, ndër të tjera, ka arsyetuar se gjykata në asnjë vend nuk ka arsyetuar se cila ka qenë mospërmblidhja e rregullt e detyrës nga ana e të pandehurit dhe dëmi efektiv që i ka ardhur shoqërisë nga veprimtaria e paligjshme e të pandehurit.

10. Pasi çështja është kthyer për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka caktuar një ekspert kontabël, dhe në përfundim të ekspertimit, pasi është njohur me konkluzionet e ekspertimit (siç rezulton nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë), prokuroria në bazë të nenit 377 të KPP-së ka kërkuar kalimin e akteve pranë saj. Në bazë të kësaj kërke, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me anë të vendimit nr. 284, datë 30.6.2015 ka vendosur kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 10.7.2015 pa u ankimuar nga palët.

11. Pasi ka tërhequr aktet, organi i akuzës ka kryer disa veprime hetimore dhe kryesisht është përqendruar në kryerjen e një ekspertimi kontabël, duke e mbështetur edhe akuzën në këtë ekspertim. Gjatë gjykimit, u mor në shqyrtim akti ekspertimit vlerësues kontabël, i hartuar më datë 23.2.2016 nga eksperti kontabël Qani Kajo, i cili i është përgjigjur katër pyetjeve të bëra nga organi i akuzës, ku në hyrje të aktit shprehet se në kryerjen e ekspertimit është mbështetur në dokumente ligjor të përgjithshëm, në materiale që ndodhen në dosjen e prokurorisë, veçanërisht në aktekspertizat e mëparshme, duke u shprehur se ka mungesë totale të dokumentacionit dhe regjistrimeve kontabël, për të cilat detyrim ligjor për t'i paraqitur sipas ekspertit i ka shoqëria. Eksperti ka arritur në këto konkluzione: *1. Në total nga mosblyerja në kohë e kontratës së qirasë, për principalin, interesat bankare të llogaritura dhe efektin e inflacionit, detyrimet janë në shumën 227.984 USD.; 2. Totali i detyrimeve së bashku me interesat janë 109.882 USD; 3. Për këtë pyetje nuk disponoj të dhëna të mjaftueshme për të arritur në një përfundim dhe prandaj përgjigjen e kësaj pyetje po e bazoj vetëm në faqen 19 të aktekspertizës të Hava Muçollari; 4. Shoqëria ka detyrimin ligjor të ruajë dokumentacionin për një periudhë minimale prej 10 vjetësh...nisur nga sa më lart detyrimet debitore dhe kreditore parashkruhen vetëm pas 10 vjetësh. Në këtë rast nuk ka vend për parashkrimin e këtyre detyrimeve.*

12. Gjithashtu, në bazë të kërkesës së bërë nga i pandehuri, eksperti është pyetur edhe gjatë gjykimit, duke dhënë përgjigje me shkrim, por edhe me anë të deklarimeve bërë përpara gjykatës.

Gjatë gjykimit janë pyetur në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit Ludovik Masmalaj, Pashuk Masmalaj, Arta Masmalaj, Brunilda Kromiçi dhe Ndue Suta.

12.1 Dëshmitari Ludovik Masmalaj ka dëshmuar para gjykatës se është marrë një kredi pranë BKT sh.a. dhe është transferuar në Vlorë, te shoqëria “Kalaja” sh.a., duke shtuar se transferimi është bërë nga administratori në bashkëpunim me të gjithë ata (pra aksionerët). Gjithashtu, dëshmitari deklaroi para gjykatës se nga “Kalaja” sh.a. ka marrë interes 20%.

12.2 Dëshmitarja Arta Masmalaj ka dëshmuar se Gjergj Lekaj nuk ka paguar qiranë, nuk ka paguar kredinë, shoqëria është futur në krizë dhe se i pandehuri nuk jepte llogari për veprimet që kryente, duke mos bërë asnjëherë mbledhje.

12.3 Të njëjtat fakte ka dëshmuar edhe nga dëshmitarja Brunilda Kromiçi.

12.4 Dëshmitari Pashuk Masmalaj (*që rezultoi të jetë edhe kallëzuesi*) ka dëshmuar para gjykatës se me shtetasin Gjergj Lekaj është njohur fillimisht si shok, ky i fundit i ka propozuar ndërtimin e një objekti, pasi kanë ndërtuar objektin dëshmitari deklaroi se ka afruar aty edhe dy vajzat e tij (Brunilda dhe Arta), si dhe vëllain e tij Ludovik. Në vijim dëshmitari ka dëshmuar se i pandehuri e ka marrë objektin me qira, por e ka paguar qiranë vetëm 2–3 muaj. Sipas dëshmitarit Pashuk Masmalaj, i pandehuri në cilësinë e administratorit ka kryer veprime pa marrë mendimin e aksionerëve të tjerë, nuk ka pranuar të japë dokumentacionin e shoqërisë, një pjesë të kredisë së marrë pranë BKT sh.a. e ka transferuar te “Kevin Gas” sh.a., pra ka shpërdoruar fondet e shoqërisë, duke i përdorur për interesa vetjake, duke shtuar se kërkon që ta likujdojë totalisht për detyrimet që i pandehuri ka ndaj tij.

12.5 Dëshmitari Ndue Suta deklaroi para gjykatës se ka punuar pranë “Emanuel Gas” sh.a. si magazinier arkëtar gjatë viteve 2006–2008, ku shtetasi Gjergj Lekaj ishte administrator, ndërsa urdhrat jepeshin prej shtetasve Pashuk, Ludovik dhe Emiljano, si dhe me fondet janë marrë këta të fundit, duke shtuar se shtetasi Gjergj Lekaj nuk ka kryer asnjë veprim ndaj arkës. Sipas dëshmitarit Ndue Suta, shtetasit Pashuk Masmalaj, Ludovik Masmalaj dhe Emiljan Kromiçi kanë marrë lek *cash* nga arka, duke shtuar se i pandehuri asnjëherë nuk ka tërheq para *cash* nga arka e shoqërisë. Gjithashtu, dëshmitari ka dëshmuar se çelësat e kasafortës janë mbajtur nga shtetasi Emiljano Kromiçi dhe se ky i fundit drejtonte më tepër shoqërinë. Dëshmitari sqaroi se gjatë periudhës që ka qenë në marrëdhënie pune pranë shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. shtetasit Emiljano Kromiçi dhe Ludovik Masmalaj shkonin çdo ditë në punë.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 194, datë 19.6.2017 ka vendosur: *“Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Gjergj Lekaj për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i kompetencave” parashikuar nga neni 164 i KP-së. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit”.*

13.1 Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar: “Gjykata, konstaton se prokuroria në ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykim është përqendruar kryesisht në kallëzimin e bërë nga kallëzuesi Pashuk Masmalaj, pa hetuar vetë se p.sh., cilat janë këto ndryshime dhe nëse realisht janë kryer apo jo ndryshime të termave të kontratës së kredisë. Gjithashtu, organi i akuzës pretendoi se i pandehuri i ka kaluar shoqërisë “Kalaja” sh.a. dhe “Kevin Gas” sh.a. shumën e caktuar, duke shtuar se kjo ka ndodhur për shkak se të dyja shoqëritë janë shoqëri të të pandehurit. Prokuroria në asnjë moment nuk e provon lidhjen e mësipërme të pretenduar prej saj, pra nga provat e paraqitura nuk rezultoi që midis të pandehurit dhe shoqërive të ketë lidhje apo i pandehuri të ketë interes. Edhe në këtë rast, prokuroria pretendimet e saj i mbështet në konkluzionet e arritura nga ekspertit Qani Kajo, i cili në aktin e ekspertimit ka përcaktuar se kredia e marrë është përdorur ekonomikisht për aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë dhe një pjesë e kredisë është përdorur duke ja dhënë hua afatshkurtër ose parapagime për furnizime shoqërisë “Kalaja” sh.a. dhe hua afatshkurtër shoqërisë “Kevin Gas” sh.p.k. Sipas ekspertit totali i huas së mbetur plus interesat prej huas së dhënë shoqërisë “Kevin Gas” sh.a. është 27.830\$, nga huaja totale e dhënë në vlerën prej 199.500 \$, ku janë kthyer 181.649\$. Në lidhje me këtë pretendim, i

pandehuri dhe avokati i tij deklaruan se eksperti ka konstatuar se si kontrata e qirasë, kontrata e kredisë bankare dhe marrëdhëniet me shoqëritë tregtare të mësipërme janë bërë në formën e kërkuar nga ligji dhe me vullnetin e aksionerëve, por këta të fundit kanë vetëm një pretendim, konkretisht mosshlyerja tërësisht e detyrimeve, në një kohë që i pandehuri i ka ndërprerë marrëdhëniet me shoqërinë më datë 30.4.2010, kurse përllogaritjet e bëra nga eksperti vijnë deri në ditët e sotme, që sipas të pandehurit nuk bën sens. Sipas të pandehurit kontrata e qirasë, e kredisë bankare, si dhe dhënia hua shoqërive të tjera tregtare janë marrëdhënie juridiko-civile dhe çdo konflikt që rrjedh do rregullohet nga dispozita të veçanta të KC-së. I pandehuri deklaroi se shuma prej 398.000 \$ i është dhënë shoqërisë “Kalaja” sh.a., prej së cilës shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. ka marrë mall, pra gaz, duke shtuar se shuma i është dhënë me mirëkuptimin e të gjithë aksionerëve. Një fakt i tillë rezulton edhe nga dëshmia e shtetasit Ludovik Masmalaj, i cili dëshmoi para gjykatës që shuma i është dhënë shoqërisë “Kalaja” sh.a. nga të gjithë aksionerët, duke shtuar se nga kjo shoqëri ka marrë dhe përfituar edhe interes në 20%. Në provat e paraqitura, si dhe në aktin e ekspertimit nuk konstatohen shkelje të disiplinës financiare në marrjen e kredisë qarkulluese me qëllim përfitimin personal apo favorizimin e shoqërive të tjera ku i pandehuri të ketë interesa.

13.2 Gjykata konstaton se prokuroria akuzën e saj e bazon kryesisht vetëm tek akti i ekspertimit të kryer nga eksperti kontabël Qani Kajo, madje vetë prokuroria shprehet se arsyeja e tërheqjes së akteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka qenë pikërisht kryerja e një tjetër ekspertimi kontabël. Në lidhje me aktin e ekspertimit, gjykata fillimisht vlerëson se në bazë të nenit 152/1 të KPP-së çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Në këto kushte, gjykata çmon se akti i ekspertimit vlerësues kontabël do të merret me rezervë duke qenë se vetë eksperti në akt shprehet se jep një opinion të kufizuar, me rezerva për pyetjet e bëra nga prokurori. Madje, duke pasur parasysh se në të njëjtën situatë, pra në mungesë të dokumentacionit një eksperte tjetër e thirrur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë gjatë rigjyqimit të çështjes është shprehur se nuk mund të kthejë përgjigje. Nga tërësia e akteve, rezulton se ka qenë pikërisht rezultati i arritur prej ekspertes Albana Beqiri që ka sjellë si pasojë që organi i akuzës të kërkojë kalimin e akteve. Por, eksperti Qani Kajo pavarësisht se pranon mungesën e dokumentacionit deklaroi dhe jep përgjigje që prej vetë tij konsiderohet opinion i kufizuar dhe me rezerva, duke u shprehur në fund të ekspertimit se kallëzimi është bërë mbi baza reale dhe në kohën e duhur. Gjithashtu, eksperti në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për të përgatitur aktin e ekspertimit, shprehet se në kryerjen e ekspertimit është bazuar në ekspertimin e kryer nga ekspertja Hava Muçollari, fakt i pranuar prej vetë ekspertit edhe gjatë gjyqimit. Në lidhje me këtë fakt, gjykata konstaton se një nga arsyet e prishjes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nga Gjykata e Apelit Shkodër ka qenë pikërisht thirrja në cilësinë e ekspertes së shtetas Hava Muçollari, por edhe pse prokuroria dhe eksperti kanë pasur dijeni për këtë vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër, nuk i ka penguar ata që t’a marrin sërish për bazë ekspertimin e kryer prej kësaj eksperteje.

13.3 Nga provat e paraqitura rezulton se shtetasi Gjergj Lekaj ka qenë në cilësinë e drejtorit pranë shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. Prokuroria nuk provon që i pandehuri të ketë përfituar apo që të ketë favorizuar ndonjë shoqëri të caktuar tregtare. Gjykata në bazë të analizës së mësipërme e gjen me vend të theksojë edhe se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet që nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, t’i krijojë gjykatës bindjen “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga të pandehurit. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të KPP-së, ku thuhet shprehimisht se: “*1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor*”

të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”. Në rastin objekt gjykimi, gjykata vlerëson se pretendimet e organit të akuzës nuk janë të bazuara. Nga provat e administruara në gjykim, nuk arrihet të provohet se shtetasi Gjergj Lekaj të ketë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së, veprimet e tij mund të sjellin për këtë të fundit përgjegjësi civile kundrejt aksionerëve të shoqërisë, por kjo nuk përbën vepër penale. Ndjekja penale gjithmonë duhet të mbështetet në prova dhe jo në supozime. Duke mbajtur parasysht rrethanat e faktit dhe analizës së mësipërme, gjykata konstaton se nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte që të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohet. Gjikata vlerëson se përgjegjësia penale është individuale, konkrete dhe jo e supozuar. Nëse do pranohet teorinë se fajësia e të pandehurit provohet edhe duke u nisur vetëm nga fakti se ai mund të ketë interes ta kryejë veprën, kjo do të përbënte një precedent të rrezikshëm e në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili parashikohet në nenin 4 të KPP-së.

13.4 Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri Gjergj Lekaj, duhet të deklarohet i pafajshëm për veprën penale *“Shpërdorimi i kompetencave”*, parashikuar nga neni 164 i KP”.

14. Kundër vendimit ka ushtruar ankim prokuroria, duke kërkuar, ndryshimin e vendimit dhe deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergj Lekaj.

15. Gjikata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 110, datë 30.7.2020 ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 194, datë 19.6.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergj Lekaj për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i kompetencave” parashikuar nga neni 164 i KP-së. Dënimin e të pandehurit Gjergj Lekaj me 300.000 (treqind mijë) lekë gjobë. Gjoka duhet paguar deri më datë 31.12.2020. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit Gjergj Lekaj. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor që është 45 ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit”.*

15.1 Gjikata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “Gjikata e Apelit Shkodër pasi shqyrtoi vendimin gjyqësor në raport me provat që iu nënshtruan rivlerësimit gjatë këtij gjykimi, shqyrtoi parashtrimet e prokurorit dhe të pandehurit dhe avokatit mbrojtës arrin në përfundimin se përfundimet e gjykatës në arsyetimin e saj vijnë në kundërshtim me provat që janë shqyrtuar në gjykatën e shkallës së parë që kanë qenë pjesë e fashikullit të gjykimit. Referuar këtyre fakteve Gjykata e apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk është i bazuar në prova e në ligj. Gjikata në vendimin e saj nuk ka pasur në konsideratë faktet e rezultuara nga provat që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Përfundimi i gjykatës se nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte që të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së, nuk është i bazuar. Prokuroria në kallëzimin e saj ka evidentuar faktet që rezultojnë të provuara nga hetimi paraprak dhe hetimi gjyqësor me anë të cilave prokuroi ka evidentuar veprimet abuzive të të pandehurit Gjergj Lekaj. Prokuroria ka evidentuar faktin se i pandehuri Gjergj Lekaj ka qenë drejtori i shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. Prokurori ka evidentuar faktin se në muajin maj 2008 nga shtetasi Gjergj Lekaj duke qenë në cilësinë e drejtorit të shoqërisë ka lidhur një kontratë qiraje me nr. 4578 rep. dhe nr. 899 kol., datë 17.5.2008 me objekt “Dhënie me qira e pasurisë së paluajtshme nr. 131/34 të ndodhur në ZK 19/86, vol. 11, f. 232”, duke marrë me qira depozitat e shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. duke i përdorur për interesa personale. Prokurori ka pretenduar se i pandehuri nuk ka likuiduar detyrimet e qirasë. Këtë fakt prokurori e ka vlerësuar si abuziv. Prokurori ka evidentuar faktin e mospërmbushjes së detyrimit të rrjedhur nga kontrata e qirasë nr. 4578 rep. dhe nr. 899 kol., datë 17.5.2008, mospërmbushje detyrimi që ka filluar që nga koha kur i pandehuri ka qenë drejtor i shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a, dhe ka vijuar edhe pas shkarkimit të tij. Pretendimi i prokurorit nuk ka qenë pabazueshmëria e lidhjes së kontratës së qirasë, por mospërmbushja e detyrimit nga i pandehuri i cili nga njëra anë përbën mospërmbushje detyrimi civil, por nga ana tjetër i pandehuri ka qenë edhe drejtor i shoqërisë dhe në këtë cilësi ai kishte detyrimin që të përmbushte detyrimin. Mospërmbushja e këtij detyrimi në kohën kur ai ishte drejtor i shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. përbën abuzim me detyrën. Pasi këtë mospërmbushje detyrimi ai nuk e ka raportuar siç e kishte

detyrim nga ligji për shoqëritë tregtare. Aq më tepër që vetë i pandehuri pranon mospërbushjen e detyrimit për shkak se shoqëria kishte detyrime. Për kontratën e kredisë me nr. 2582 rep. nr. 1528 kol. datë 27.12.2005, lidhur nga shoqëria me BKT prokurori ka evidentuar faktin se një pjesë e kësaj kredie është përdorur duke ja dhënë hua afatshkurtër ose parapagime për furnizime shoqërisë “Kalaja” sh.a, dhe hua afatshkurtër shoqërisë “Kevin Gas” sh.a. Kësaj shoqërie i janë dhënë nga shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. shuma 199 550 \$ dhe janë arkëtuar nga shoqëria “Kevin Gas” sh.a., shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. shuma 181 649\$. Huaja e shoqërisë “Kevin Gas” nuk është shlyer. Ai ka evidentuar faktin se kjo shoqëri është në pronësi të shtetasit Gjergj Lekaj. Ai është shprehur se kjo kredi është dhënë edhe në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 neni 113 “Detyrimi i besnikërisë” dhe përgjegjësia, pika 1 shkronja “ç”. Prokurori ka evidentuar faktin se i pandehuri Gjergj Lekaj ka marrë nga shoqëria “Kalaja” sh.a. Vlorë shumën 108 000\$. Këtë shumë e ka marrë si administratori i shoqërisë “Emanuel Gas”. Ky fakt ka rezultuar në *e-mail* e shoqërisë “Kalaja” sh.a., datë 26.11.2010. Po kështu ka evidentuar faktin se nga kartela e bërë mbi bazën e dokumenteve të bankës dhe ku rezulton se ka mospërputhje të madhe midis shoqërisë në fjalë dhe shoqërisë “Emanuel Gas” diferencë e cila sipas aktit të ekspertimit rezulton në shumën 519608\$. Prokurori ka arsyetuar se nga tërësia e veprimeve dhe hetimeve procedurale mbështetur në aktin e ekspertimit kontabël se shtetasi Gjergj Lekaj në cilësinë e drejtorit të shoqërisë ka shpërdoruar kompetencat e njohura me statut e ligj, duke dëmtuar interesat e shoqërisë për interesat personale duke konsumuar elementet e veprës penale të shpërdorimit të kompetencave të parashikuara nga neni 164 i KP-së. Ai është bazuar në vlerën e pashlyer të qirasë, huaja e dhënë shoqërisë “Kevin Gas” sh.a., e cila ka rezultuar jo ekonomike, e dhënë pa vendimin e asamblesë, ose e këshillit mbikëqyrës. Shoqëria është shoqëri në pronësi të të pandehurit Gjergj Lekaj, veprime këto që bien ndesh me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 neni 63 pika 1 shkronja “a” ku thuhet: “Administratorët, anëtarët e këshillit detyrohen të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit të pranishme apo të mundshme të interesave personale me ato të shoqërisë”. Prokurori ka argumentuar se nga pyetja e dëshmitarëve Brunilda Kromiçi, Arta Masmalaj, Ludovik Masmalaj, kanë provuar se Gjergj Lekaj është caktuar drejtor i përgjithshëm i shoqërisë “Emanuel Gas”, ai nuk ka respektuar dispozitat e parashikuara në statut ku sipas nenit 13 të saj duhej të thërriste së paku një mbledhje vjetore. Për këtë shkak është shkarkuar dhe nuk ka paraqitur dokumentacion. Në lidhje me kredinë e marrë në BKT dega Lezhë nga shoqëria “Emanuel Gas” kjo është marrë nga Gjergj Lekaj i cili më pas ka ndryshuar termat e kontratës, ku aksionerët nuk kanë asnjë lloj dijenie.

15.2 Në analizë të këtyre pretendimeve Gjykata e apelit vlerëson se gjykata e faktit në vlerësimin e saj ka pasur në konsideratë ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe statusin e shoqërisë. Veprimet e të pandehurit duhej t’i vlerësonte në raport me to dhe jo të mbetej vetëm në konstatimin se prokurori nuk ka evidentuar shkeljet. Gjykata e faktit ka arritur në përfundimin e saj se nuk ka ndonjë shkelje apo shpërdorim kompetencash nga ana e të pandehurit. Për gjykatën e apelit ky përfundim nuk është i bazuar në ligj. Nga analiza e këtyre argumenteve të gjykatës së faktit, gjykata e apelit vlerëson se këto argumente nuk janë të bazuara në provat që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në ligj.

15.3 Në lidhje me kontratën e qirasë argumenti i gjykatës se për sa kohë shtetasi Gjergj Lekaj si qiramarrës nuk rezulton të jetë në cilësinë e administratorit, por të një individi apo personi nuk mund të pretendohet se mospagimi i qirasë përbën shpërdorim të kompetencave të tij, sepse siç është sqaruar më sipër subjekt i kësaj vepre është subjekti i posaçëm. Në këtë përfundim gjykata nuk ka pasur parasysh faktin se i pandehuri Gjergj Lekaj ka pasur pozitë të dyfishtë, nga njëra anë në cilësinë e personit fizik ka qenë qiramarrës, nga ana tjetër në cilësinë e drejtorit të shoqërisë ka pasur detyrimin që të kërkonte përmbushjen e detyrimeve të palëve kontraktuese me shoqërinë. Duke qenë drejtor i shoqërisë ai ka lejuar mospërbushjen e detyrimit duke i sjellë vetes përfitime. Gjykata e faktit ka gabuar kur arrin në përfundimin se nuk provohet se fakti i mbledhjeve të paorganizuara nga i pandehuri Gjergj Lekaj. Ajo nuk ka argumentuar se përse kjo shkelje nuk përbën vepër penale, megjithëse vlerëson se mosorganizimi i këtyre mbledhjeve

përbën shkak për shkarkim nga detyra. Në fakt, mosorganizimi i mbledhjeve provohet nga mungesa e procesverbaleve të mbledhjeve të cilat në bazë të ligjit ka pasur detyrim t'i ruaj i pandehuri, nga pohimet e dëshmitarëve dhe nga vetë i pandehuri. Gjykata e faktit ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se prokurori nuk ka përcaktuar se cili është dëmi apo pasoja që i ka ardhur shoqërisë nga ndryshimi i termave të kontratës. Vepra penale e parashikuar nga neni 164 i KP-së nuk kërkon si pasojë dëmin e shkaktuar shoqërisë, por përfitimin e subjektit për vete dhe shoqëritë e tjera. Gjykata në vendimin e saj duhej të shprehej nëse i pandehuri ka ndryshuar apo jo termet e kredisë pa miratimin e këshillit mbikëqyrës, duhej të argumentonte se moskryerja e këtij veprimi është veprim abuziv, nëse përbën apo jo vepër penale duhet vlerësuar në raport me faktin nëse i pandehuri ka pasur përfitimi nga ndryshimi i termave të kontratës. Përfundimi i gjykatës së faktit se prokuroria nuk provon lidhjen e të pandehurit me shoqërinë “Kevin Gas” sh.a. nuk është i bazuar.

15.4 Gjykata e faktit ka arsyetuar se i pandehuri nuk është subjekt i veprës penale. Nga analiza e nenit 164 të KP-së, gjykata e apelit ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, arrin në përfundimin se i pandehuri Gjergj Lekaj është subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së. I pandehuri ka qenë në funksionin e drejtorit të kësaj shoqërie, funksion ky që është pasqyruar edhe në ekstraktin e QKR-së. Në këtë ekstrakt nuk është pasqyruar funksioni i administratorit si organ drejtues i shoqërisë, ndaj arrihet në përfundimin se funksioni i drejtorit të shoqërisë barazohet me funksionin e administratorit. Veprimtaria e tij është rregulluar si nga ligjet e cituara më lart që rregullojnë veprimtarinë tregtare, ashtu edhe nga statuti i shoqërisë. Ky përfundim vjen në përputhje dhe në harmoni me nenin 294 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”. Funksionet e tij dhe ndalimet në ushtrimin e kësaj veprimtarie janë rregulluar në mënyrë specifike me dispozitat e këtyre ligjeve dhe janë të njëjtat si për drejtorin e drejtorisë ashtu edhe për administratorin. Gjykata e Apelit vlerëson se nuk është emri ai që e bën një shtetas subjekt të një marrëdhënie juridike civile apo penale që rregullohet me ligje të posaçme siç është rasti konkret, por është funksioni që kryen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fakti i mosndryshimit të emrit të përfaqësuesit të shoqërisë nga ana e këshillit mbikëqyrës, apo e asamblesë së ortakëve, nga drejtor në administrator, nuk e përjashton të pandehurin nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga funksioni që ai ka ushtruar në shoqërinë tregtare “Emanuel Gas” sh.a, funksion i cili rregullohet si nga ligji për shoqëritë tregtare të përmendura më sipër, ashtu edhe nga statusi i shoqërisë. Kjo analizë bën që gjykata e apelit të arrijë në përfundimin që vlerësimi i gjykatës së faktit se *i pandehuri Gjergj Lekaj ka qenë në cilësinë e drejtorit pranë shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a.* është subjekt i posaçëm i veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së. Vepra penale “Shpërdorimi i kompetencave” është parashikuar si e tillë që në momentin e hartimit dhe të hyrjes në fuqi të KP-së, pra në vitin 1995 dhe nga ajo kohë, kjo dispozitë nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nuk bën fjalë për drejtorët, çka do të thotë se funksioni i drejtorit është i njëjtë me funksionin e administratorit të shoqërisë për sa u përket kompetencave. Por nga ana tjetër në bazë të nenit 296 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me titull “Abuzimi dhe kompetencat”, i pandehuri në cilësinë e drejtorit ka qenë subjekt procedimi penal. Ky përfundim i gjykatës së apelit vjen në përputhje edhe me kuptimin e nenit 296 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me titull “Abuzimi dhe kompetencat” i cili si subjekte të këtij ligji përmend, administratorët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose të drejtorisë. Kjo dispozitë megjithëse është dispozitë penale e parashikuar në ligjin organik, parashikon si subjekte të veprës penale administratorët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose të drejtorisë.

15.5 Gjykata e Apelit vlerëson se provohet fakti se i pandehuri Gjergj Lekaj ka kaluar fonde te “Kevin Gas” sh.a. dhe provohet lidhja ndërmjet të pandehurit Gjergj Lekaj në cilësinë e drejtorit të shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a., me shoqërinë “Kevin Gas” sh.a. ku ai ka qenë ortak i vetëm dhe administrator i saj, dhe se kjo shoqëri ka përfituar të ardhura nga shoqëria “Emanuel Gas” sh.a., të ardhura të cilat janë kaluar nga Gjergj Lekaj nëpërmjet bankës. Nga analiza e aktit të ekspertimit ka rezultuar se për vitet 2007–2011, shoqëria “Kevin Gas” sh.a. ku i pandehuri Gjergj

Lekaj ka qenë ortak i vetëm dhe administrator, ka pasur të ardhura në shumën 433,676,181 lekë dhe fitim 11,063,243 lekë, norma e fitimit është realizuar 2.55 % ose 3 herë më shumë fitim. Shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. për 6 vjet ka realizuar 2,678,983 lekë fitim. Ndërsa shoqëria “Kevin Gas” sh.a. për 5 vjet ka realizuar 11,063,243 lekë fitim ose 3 herë më shumë. Shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. për periudhë 6-vjeçare ka realizuar 312.344.692 lekë të ardhura; 309.665.709 lekë shpenzime dhe 2.678.983 lekë fitim. Shoqëria “Kevin Gas” sh.a. për periudhë 5-vjeçare ka realizuar 433,676,181 lekë të ardhura; 422,612,938 lekë shpenzime dhe 11,063,243 lekë fitim. Nga këto të dhëna rezulton se fitimet e shoqërisë “Kevin Gas” sh.a. janë disa herë më të larta se ato të shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. Ky fakt është një argument më shumë se i pandehuri në ushtrimin e veprimtarisë së tij ka realizuar përfitime për vete, megjithëse ishte drejtori i shoqërisë “Emanuel Gas.” Ky përfundim i aktit të ekspertimit që i referohet dokumentacionit bankar provon përfitimin e të pandehurit nga veprimet në kundërshtim me ligjin dhe statutin me qëllim përfitimin për vete dhe shoqërinë “Kevin Gas” sh.a. ku ai është ortak i vetëm dhe administrator i saj. Nga kjo analizë rezulton e provuar se i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe statutin, me qëllim përfitimi për vete dhe shoqërinë e tij ku ai ishte ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë.

15.6 I pandehuri me veprimet e veta ka vepruar në kundërshtim me interesin më të mirë të shoqërisë duke marrë nga llogaria e shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. shuma të konsiderueshme, duke i përdorur për interesat e tij në shoqërinë “Kevin Gas” sh.a., në vend që të përdorëshin nga shoqëria “Emanuel Gas” ku ai ishte drejtor, funksion ky i barabartë me funksionin e administratorit të shoqërisë. Pretendimi i mosbërjes së mbledhjeve provohet edhe nga mungesa e protokolleve të mbledhjeve, për mbajtjen e të cilave përgjegjës ka qenë i pandehuri në cilësinë e drejtorit të shoqërisë. Mungesa e këtij dokumentacioni së bashku me deklaratimet e dëshmitarëve e provojnë këtë fakt. Janë të gjitha këto fakte të provuara të cilat e çojnë gjykatën e apelit të krijojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm bindjen se i pandehuri ka konsumuar veprën penale të shpërdorimit të kompetencave. Duke qenë në detyrën e drejtorit ai ka kaluar shuma në favor të tij, ka tërhequr vlera monetare për vete, vlera të cilat janë përfshirë në llogarinë e tij. Përfundimi i gjykatës se ndryshim i termave të kontratës së kredisë bankare, pa miratimin e shoqërisë, vë në diskutim ndryshimin e termave të kredisë. Ky përfundim nuk është i bazuar, vetë shkresa e bankës BKT e provon këtë fakt. Ndryshimi i termave të kredisë duhet bërë me miratimin e këshillit mbikëqyrës. Pasi kontrata e kredisë është lidhur ndërmjet gjithë ortakëve dhe ndryshimi i saj mund të bëhet vetëm me një kontratë të re.

15.7 Gjykata e apelit vlerëson se gjykata e faktit ka vepruar gabim kur nuk ka analizuar asnjë përfundim të aktit të ekspertimit, i cili në përmbajtjen e tij pasqyron edhe fakte që duhej të interpretoheshin nga gjykata. Në arsyetimin e saj për aktin e ekspertimit, gjykata megjithëse shprehet se ka rezerva rreth aktit, ajo nuk merr në konsideratë asnjë përfundim të këtij akti i cili ka arritur në përfundime të caktuara referuar akteve që kanë qenë pjesë e fashikullit të hetimit siç janë pasqyrat e llogarive bankare të bankës BKT për shoqëritë “Emanuel Gas” sh.a., “Kevin Gas” sh.a. dhe “Kalaja” sh.a., përfundimet e ekspertit në analizë të këtyre pasqyrave nuk ka përse të mos merren në konsideratë, për aq kohë sa ato i referohen dokumente bankare ku pasqyrohen lëvizjet dhe qarkullimi i kredive. Pasiguria e ekspertit në hartimin e aktit të ekspertimit qëndron në ekspertimin e dokumentacionit kontabël që disponon shoqëria “Emanuel Gas”, i cili ka mangësi ose mungon. Ruajtja e këtij dokumentacioni sipas ligjit për shoqëritë tregtare ka qenë përgjegjësi e të pandehurit Gjergj Lekaj në cilësinë e drejtorit të kësaj shoqërie. Objekt i ekspertimit janë edhe pretendimet e ngritura në kallëzim, ndaj nuk ka se si eksperti në hartimin e aktit të ekspertimit të mos ketë në konsideratë edhe pretendimet e kallëzuesit për vlerësim, pasi në fund të fundit janë pretendimet e tij të ngritura në kallëzim ato që kanë iniciuar procedimin penal objekt shqyrtimi. Interpretime juridike eksperti nuk duhet të bëjë, për këtë pjesë ato nuk duhen marrë në konsideratë nga gjykata në dhënien e verdiktit të saj, por kjo nuk do të thotë se për këtë shkak të mos merren në konsideratë përfundimet e aktit të ekspertimit. Gjykata në vendimin e saj nuk i ka rrëzuar poshtë gjithë përfundimet e aktit. Gjykata ka detyrimin ligjor të interpretonte faktet e

pasqyruara në këtë akt, dhe mbi bazën e këtij interpretimi dhe analize të hidhte poshtë përfundimet e akti të ekspertimit.

15.8 Për këtë shkak gjykata e apelit përsëriti shqyrtimin gjyqësor dhe rivlersoi përfundimet e aktit të ekspertimit të ekspertit Qani Kaja. Referimi apo shprehja e opinionit për aktin e ekspertimit të ekspertes Hava Muçollari nuk e bën aktin e ekspertit Qani Kajo të pavlefshëm për sa u përket përfundimeve që ai ka arritur duke u referuar në llogaritë bankare të cilat janë prova me fuqi të plotë provuese. Përfundimi i gjykatës së faktit në asnjë moment nga ana e organit të akuzës nuk provohet dashja direkte dhe aq më pak qëllimi specifik, pra përfitimi i vetë të pandehurit apo favorizimi i një shoqërie ku ka apo mund të ketë interesa i pandehuri dhe se prokuroria nuk provon që i pandehuri të ketë përfituar apo që të ketë favorizuar ndonjë shoqëri të caktuar tregtare, nuk është i bazuar. Për sa i përket dashjes direkte të të pandehurit dhe me qëllim të posaçëm për të përfituar apo për të favorizuar një shoqëri ku ka interesa subjekti i veprës penale, për gjykatën e apelit ky përfundim nuk është i bazuar. Arsyetimi i mësipërm rrëzon këtë përfundim të gjykatës së faktit. Gjatë kohës që ai ka qenë drejtor i shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a., ai ka themeluar një shoqëri tjetër shoqërinë “Kevin Gas” sh.a. ku ka qenë ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë, së cilës pa dijeni të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Emanuel Gas sh.a. i ka kaluar shuma të konsiderueshme monetare në dollarë në favor të shoqërisë “Kevin Gas” sh.a., ku ai ka qenë ortak dhe administrator i saj. Ai ka tërhequr për llogari të tij, shuma nga shoqëria “Kalaja” sh.a. pa i kontabilizuar në llogarinë e shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. ku ai ishte drejtor. Këto shuma kanë kaluar në favor të pandehurit çka do të thotë se ai ka përfituar nga këto shuma. Referuar këtij arsyetimi gjykata e apelit arrin në përfundimin se fajësia e të pandehurit Gjergj Lekaj është e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndaj ai duhet deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP-së. I pandehuri duke shfrytëzuar kompetencën e tij si drejtor i shoqërisë me qëllim përfitimi ka abuzuar me këtë kompetencë duke favorizuar veten dhe shoqërinë “Kevin Gas” sh.a. në të cilën ai ka qenë ortak i vetëm dhe administrator. Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit gjykata ka parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës, faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e këtyre veprimeve të kundërligjshme, ka parasysh rrezikshmërinë shoqërore të pandehurit dhe moshën e tij. Gjykata e apelit vlerëson se referuar dispozitave të KP-së, neni 47 e vijues të tij dënimi me gjobë realizon qëllimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të ligjit.

15.9 Gjykata e apelit vlerëson se nuk qëndron pretendimi i ngritur nga mbrojtja se në gjykatën e apelit nga palët nuk mund të parashtrihen në seancë pretendime të ndryshme nga ato të parashtruara në ankim, çka thuhet shprehimisht në nenin 426/a, 5 të KPP-së. Rreth pretendimit se gjykata e apelit ka vendosur përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor në kundërshtim me nenin 427 të KPP-së, gjykata e apelit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Gjykata e Apelit Shkodër duke vlerësuar se në gjendjen që janë aktet nuk mund të vendoste për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit Gjergj Lekaj, në bazë të nenit 427 të KPP-së vendosi përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur ripyetjen e ekspertit Qani Kajo. Ky vendim i gjykatës është në përputhje me pikën 3 të kësaj dispozite e parashikon të drejtën e gjykatës për të vendosur kryesisht për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Kjo përsëritje kushtëzohet edhe nga fakti se me vendimin e gjykatës së shkallës së parë i pandehuri Gjergj Lekaj ishte deklaruar i pafajshëm. Gjykata e faktit në vendimin e saj kishte evidentuar rezultatet e provave, por nuk kishte bërë një analizë të tyre që për Gjykatën e Apelit të ishte bindëse për pafajësinë e të pandehurit. Në vendimin e saj gjykata e apelit vlerësoi të bëjë një përsëritje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor duke thirrur për të ripyetur ekspertin Qani Kajo në mënyrë që të sqaronte së pari thelbin e pretendimeve për faktet e deklaruara nga prokurori si veprime që përbëjnë elemente të veprës penale të shpërdorimit të kompetencave parashikuar nga neni 164 i KP-së, të sqarojë raportet financiare ndërmjet shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. me shoqërinë “Kalaja” sh.a. Neni 427, pika 4, e KPP-së, parashikon se “4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e

apelit vlerëson se në interpretimin e kuptimit të termit “përsërit shqyrtimin gjyqësor.”, të vjen në ndihmë neni 427 i KPP-së, me titull “Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor” i cili parashikon si terma “Rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë”, “Marrjen e provave të reja”, “Përsërit shqyrtimin gjyqësor”, të drejtën e disponimit të gjykatës “Provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty”. Nga përmbajtja e këtyre termave në raport me këtë dispozitë rezulton se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor mund të bëhet: 1. Me “rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë”; 2. Me “marrjen e provave të reja”; 3- Me ndalimin e gjykatës së apelit për deklarimin fajtor të të pandehurit vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor; 4. Me të drejtën e disponimit të gjykatës për “Provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty”. Nga analiza e këtyre termave rezulton se ligjvënësi nuk bën fjalë për “përsëritje tërësisht të shqyrtimit gjyqësor”, dhe aq më tepër për një detyrim të tillë ndaj gjykatës. Vetë parashikimi rimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë, marrja e provave të reja, do të thotë se shqyrtimi gjyqësor mund të përsëritet pjesërisht ose në mënyrë të plotë. Përsëritja e hetimit gjyqësor në mënyrë të plotë do të thotë hetim gjyqësor nga e para. Kjo dispozitë nuk e përjashton dhe as nuk e ndalon përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Përkundrazi vetë parashikimi i rishqyrtimit të provave të marrë në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, marrja e provave të reja, apo atyre që kanë dalë pas shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, në thelb në vetvete është formë e përsëritjes së pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Pyetja e ekspertit Qani Kajo ishte rishqyrtimi i provës të marrë nga gjykata e shkallës së parë, dhe nuk ishte një provë e re. Gjykata vlerësonte se rishqyrtimi i kësaj prove ishte i domosdoshëm për të evidentuar raportin e shoqërisë “Emanuel Gas” me veprimet e të pandehurit Gjergj Lekaj në cilësinë e drejtorit të shoqërisë, dhe raportin e këtij të fundit me shoqëritë e tjera. Avokati në prapësimet e tij referohet në nenin 427/1 të KPP-së.

15.10 Në nenin 427/1 të KPP-së bëhet fjalë për rastin kur njëra palë kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë. Pra nuk bëhet fjalë për rimarrjen e të gjitha provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë. Pra nuk ndodhemi para një detyrimi për të rimarrë të gjitha provat që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë. Rimarrja e disa provave që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë nuk e cenon hetimin gjyqësor, dhe as nuk është veprim në kundërshtim me këtë dispozitë, për aq kohë sa kjo dispozitë nuk shprehet në mënyrë taksative për të gjitha provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë (kolegjit penal) bën fjalë për gjykimin si shkallë e parë në gjykatën e apelit, vetëm në rast se gjykata e apelit konkludon se aplikimi i gjykimit të shkurtuar është bërë në kundërshtim me ligjin, gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës dhe e gjykon nga e para. Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se ankuesi kundër vendimit të një gjykate më të ulët në një gjykatë më të lartë kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata mund të vendosë sipas diskrecionit të vet në qoftë se çmon se në gjendjen që janë provat, çështja nuk mund të zgjidhet. Kjo do të thotë se ankuesi këto kërkesa mund t'i parashtrijë në aktin e ankimit. Mosparaqitja e këtyre kërtimeve në këtë akt nuk passjell mospranimin e ankimit. Në të drejtën procedurale në veçanti, sidomos në rastet kur disponohet për kufizime të të drejtave të palëve në proces, kufizimi i tyre parashikohet në mënyrë taksative në ligj. KPP-ja nuk parashikon në mënyrë adekuate momentin procedural të disponimit të gjykatës për përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Praktika gjyqësore në gjykatën e apelit ka dy momente të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, përpara shqyrtimit të ankimeve në kërkesat paraprake, dhe pas dëgjimit dhe shqyrtimit të ankimeve. Gjykata e apelit vlerëson se nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se i pandehuri Gjergj Lekaj është deklaruar i pafajshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, dhe gjersa në këtë shkallë gjykimi nuk u procedua, sipas rregullimit ligjor, me “përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor”, proceduralisht konkludohet lehtësisht se, gjykata e apelit nuk mund të deklarojë fajtor të gjykuarën Gjergj Lekaj mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, apo me përsëritjen pjesërisht të

shqyrtimit gjyqësor. Ky pretendim nuk qëndron për faktin se KPP-ja parashikon të drejtën e gjykatës që t'i nënshtrojë në gjykatën e apelit rivlerësimin apo rishqyrtimin e provave që gjykata e shkallës së parë ka marrë dhe ka shqyrtuar. Kjo do të thotë se nëse provat e marra në gjykimin e shkallës së parë i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit, atëherë këto prova vlerësohen jo mbi bazën e vlerësimit që ka bërë gjykata e shkallës së parë, por mbi bazën e përfundimeve që gjykata e apelit arrin nga shqyrtimi i këtyre provave në gjykimin në gjykatën e apelit. Pra provat nuk janë marrë të mirëqena nga gjykata e faktit, por ato i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, dhe nga ky shqyrtim gjykata që rishqyrton këto prova mund të dalë në përfundime të kundërta nga ato të arritura nga gjykata e shkallës së parë, duke i vlerësuar ndryshe nga sa i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë. Nëse kjo dispozitë do të interpretohet ndryshe, atëherë bie qëllimi i ligjvënësit që ka disponuar që gjykata e apelit mund të vendosë rishqyrtimin e provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Gjykata e apelit nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj një vlerësimi të gabuar të provave, me arsyetimin se ato janë shqyrtuar një herë në gjykatën e shkallës së parë. Kjo i humbet sensin dhe qëllimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.

16. Kundër vendimit nr. 110, datë 30.7.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka ushtruar rekurs i gjykuari Gjergj Lekaj, duke kërkuar, prishjen e vendimit nr. 110, datë 30.7.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 194, datë 19.6.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, janë parashtruar këto shkaqe:

- Në ankimin e paraqitur nga prokurori i çështjes, datë 23.6.2017, nuk është kërkuar rimarrje të provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë dhe as marrja e provave të reja, si dhe nuk është ushtruar e drejta, pesë ditë para seancës, sipas ligjit, nenit 415/2 të KPP-së, për plotësimin e ankimit apo të shtimit të arsyeve të tjera që lidheshin me ankimin, me pasojë mospranimin e kërkesave të palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, në kuptim të dispozitës procedurale, përkatësisht nenit 427/1 të KPP-së. Në seancën gjyqësore të datës 1.7.2019, prokurori i apelit krahas paraqitjes së apelit/arsyeve për ndryshimin e vendimit penal nr. 194/2017, njëherazi kërkoj përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, administrimin e provave shkresore, rreth 61 fatura tatimore shitjeje. I gjykuari/pandehuri Gjergj Lekaj, kundërshtoi parashtrimet në ankim të organit të prokurorisë e njëherazi kërkoj mospranimin e kërkesës për përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor me argumentin se, a) vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është i bazuar në ligj e prova, nuk ekzistojnë shkaqe për ndryshimin e tij. b) apeli/ankimi i prokurorit, nuk është në formën e kërkuar nga ligji, me pasojë mospranimin, në vështirësi të nenit 412 e 420/1, "c" të KPP-së, por nuk parashtron asnjë argument ligjor, pikat e vendimit që kundërshtohen, shkaqet e ankimit, dhe se nuk parashtrohet asnjë argument juridik se në cilën pikë të vendimit ka gabuar gjykata e shkallës së parë, si kërkesë e domosdoshme, caktuar në nenin 412 të KPP-së, ankimi është përsëritje e kërkesës për gjykim dhe të konkluzioneve përfundimtare në shkallë të parë, c) mospranimin e kërkesës për përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, sepse nuk është bërë në përputhje me kriteret detyruese të caktuara në normën procedurale, nenin 427/1 të KPP-së.

- Gjykata e apelit, në seancën e datës 1.7.2019, pasi dëgjoi palët në lidhje me diskutimin rreth ankimit/apelit të prokurorit, u tërhoq në dhomën e këshillimit për marrje vendimi, e cila pasi u kthye, kryesisht vendosi: të përsërisë pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, duke thirrur për t'u pyetur në seancë gjyqësore ekspertin Qani Kajo, duke mos u shprehur për kërkesën e prokurorit. I pandehuri Gjergj Lekaj, kundërshtoi pyetjen e ekspertit Qani Kajo, për arsye se: i) Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë nuk e ka vlerësuar aktin e ekspertimit me vlerën e provës, të aftë për të ndihmuar gjykatën për të arritur në përfundime të drejta në përputhje me ligjin; ii) nuk ka arsye që Gjykata e Apelit të ripyeshë ekspertin kur akti i ekspertimit, datë 23.2.2016, në gjykatën e faktit është konsideruar i pavlefshëm, dhe, si i tillë nuk mund të bëhet i vlefshëm me ripyetje në këtë shkallë gjykimi. Gjykata rrëzoi kërkesën.

- Në seancën gjyqësore datë 10.2.2020, eksperti Qani Kajo, iu përgjigj pyetjeve të shtruar nga gjykata e prokurorit. I pandehuri, Gjergj Lekaj, absolutisht nuk ka qenë dakord me përgjigjet.

Kundërshtitë i paraqiti me shkrim, datë 10.2.2020, duke kërkuar mospranimin e tyre, për arsye se: a) janë të njëanshme; b) shtrembërohet realiteti; c) janë të pasakta etj., nisur dhe nga konkluzioni përfundimtar i ekspertit Qani Kajo se “sipas mendimit tim është e pamundur të bëjmë ekspertizë për vitet 2006–2011”.

- Në vijim, në seancën e datës 24.2.2020, mbi kërkesën e prokurorit, u thirr për ripyetje kallëzuesi, shtetasi Pashuk Masmalaj, në seancën e datës 5.3.2020 dhe në seancën e datës 8.6.2020, u procedua me leximin e dëshmisë së Brunilda Kromiçit, sipas nenit 369 të KPP-së.

- Më datë 5.6.2020, Gjergj Lekaj paraqiti kërkesë në gjykatë për administrimin e provës shkresore, caktimin e një grupi ekspertësh kontabël për një zgjidhje të drejtë, objektive e në përputhje me ligjin. Kërkesa u rrëzua nga Gjykata me vendimin e ndërmjetëm datë 2.7.2020, për shkak se “nuk është kërkuar përjashtimi i ekspertit në momentin e përgjigjes, por nuk keni qenë dakord me përgjigjet”.

- Në seancën e datës 9.7.2020, prokurori i apelit parashtrori konkluzionet, dhe në përfundim, kërkoj: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit Gjergj Lekaj për veprën penale të “Shpërdorimit të kompetencave” të parashikuar nga neni 164 i KP-së, dhe dënimin e tij me 300 000 (treqind mijë) lekë gjobë.” Në seancën e datës 22.7.2020, Gjergj Lekaj në diskutimin përfundimtar paraqiti gjerësisht kundërshtitë ndaj konkluzioneve të prokurorit që janë të njëjta me ato të kallëzuesit, si nga pikëpamja e parashtrimit të rrethanave ashtu dhe nga referimi në ligj, madje duke mos respektuar parimin esencial kushtetues të ligjit favorizues (neni 3, KP), se shtrembëron jo pa qëllim të vërtetën duke sinkronizuar veprimet me ekspertin Qani Kajo etj., duke kërkuar përfundimisht mospranimin e ankimit e lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, si vendim i drejtë, i bazuar në ligj e prova.

- Vendimi i gjykatës së apelit është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit. Mbështetur në materialet që ndodhen në dosjen penale, dispozitat ligjore procedurale e materiale të ligjit penal dhe referuar pjesës përshkruese arsyetuese të vendimit voluminoz prej 69 fletësh (që bie dukshëm në sy në pjesën “II. Arsyetim ligjor i fajësisë së të pandehurit Gjergj Lekaj”, përsëritje e ripërsëritje e shprehjeve standarde, për të krijuar idenë e një vendimi të arsyetuar), arrihet lehtësisht në konkluzionin se vendimi i gjykatës së apelit, është në zbatimin e gabuar të ligjit penal, me pasojë prishjen e tij.

- Vendimi i gjykatës së apelit është rezultat i shkeljeve të ligjit procedural penal, nenit 426/a, 5 të KPP-së, palët nuk mund të parashtrojnë në seancë shkaqe tej atyre të ngritura në apel. Në rastin konkret në ankimin e prokurorit, datë 23.6.2017, nuk mishërohet asnjë pikë e kundërshtimit të vendimit penal, si dhe nuk trajtohet asnjë shkak ligjor për të ndryshuar vendimin, por kërkesa ankimore është një përsëritje e kërkesës për gjykim dhe të pretendimeve të shtruara në gjykatën e faktit. Në apel prokurori është lejuar nga gjykata për të ngritur arsye të tjera, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, madje pa pasur parasysh respektimin e zbatimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal më të favorshëm, që është me karakter human e demokratik.

- Vendimi është marrë, gjithashtu, me shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në dispozitën procedurale, përkatësisht nenin 427/1 të KPP-së, që bën fjalë për “Përsëritje të shqyrtimit gjyqësor”, në të cilin në mënyrë eksplicite parashikohet: “1. Kur një palë në aktin e apelit ose plotësimin e tij, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor.”. Dispozita është e qartë dhe e prerë e nuk lë shteg për keqinterpretim, është detyruese e jo fakultative, sipas së cilës gjykata në apel përsërit shqyrtimin gjyqësor vetëm kur pala e ka parashtruar në ankim ose me plotësim të ankimit në vështrim të nenit 415/2 të KPP-së, sipas të cilit: “2. Ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, arsye të tjera që lidhen me ankimin.”.

- Në rastin konkret në gjykim, prokurori nuk ka kërkuar as në ankim dhe as me plotësim të ankimit, sipas ligjit procedural, rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin në gjykatën e shkallës së parë ose marrjen e provave të reja. Ndërsa gjykata e apelit, në kundërshtim me këto kritere të parashikuara shprehimisht në ligjin procedural, gjatë gjykimit e lejoi prokurorin të ripyeste në seancë kallëzuesin/dëshmitarin Pashuk Masmalaj e të lexonte dëshminë e Brunilda Kromiçit dhënë para gjykatës së faktit, datë 2.2.2017, si dhe paraqitjen e 61 faturave shitjeje të shoqërisë “Global-Gas” sh.a. për shoqërinë “Emanuel Gas”.

- Gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit është bërë në kundërshtim me normën procedurale të përcaktuar qartësisht, nenin 427 të KPP-së. Me vendimin e ndërmjetëm, datë 1.7.2019, gjykata vendosi “përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor”, me ripyetjen e ekspertit Qani Kajo (ndonëse në vazhdim pranoi kërkesat e prokurorit të cituara më lartë), veprim që bie ndesh kritereve të përcaktuara rigorozisht në dispozitën e mësipërme, për faktin se dispozita ligjore parashikon shprehimisht “Përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor” dhe kurrësi nuk lejon përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kontekst, gjykata, jo vetëm nuk ka zbatuar detyrimin ligjor, të “përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor”, po nuk mori parasysh pretendimet e të gjykuarit, është kontradiktore, pse jo e paqartë, kur kundërshton pretendimet e të gjykuarit/rekuruesit me arsyetimin se “Rreth pretendimit se gjykata e apelit ka vendosur përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor në kundërshtim me nenin 427 të KPP-së, gjykata e apelit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Gjikata e Apelit Shkodër duke vlerësuar se në gjendjen që janë aktet nuk mund të vendoste për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit Gjergj Lekaj, në bazë të nenit 427 të KPP-së vendosi përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur ripyetjen e ekspertit Qani Kajo. Ky vendim i gjykatës është në përputhje me pikën 3 të kësaj dispozite e parashikon të drejtën e gjykatës për të vendosur kryesisht për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

- Prej nga del: i) kontradiksioni e paqartësia rezulton në shprehjen për “përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur ripyetjen e ekspertit Qani Kajo.”. Çka do të thotë se “përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, nuk është kur pyetet vetëm një person përkatësisht “ripyetjen e ekspertit Qani Kajo”, pra shqyrtimin e një prove; ii) në pjesën arsyetuese të vendimit jo një herë shprehet se “Në vendimin e saj gjykata e apelit vlerësoj të bëjë një përsëritje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor”; dhe iii) si mund të konsiderohet “përsëritje të shqyrtimit gjyqësor, në një kohë që në gjykatën e shkallës së parë sipas vendimit të kësaj gjykate, faqe 3, rezulton se janë shqyrtuar 15 prova shkresore e me dëshmitarë, kurse gjykata e apelit vendos të ripyesë ekspertin Qani Kajo. Në këtë kuadër, gjykata është absolutisht në zbatim të gabuar të ligjit kur arsyeton se “Nga analiza e këtyre termave rezulton se ligjvënësi nuk bën fjalë për përsëritje tërësisht të shqyrtimit gjyqësor”, dhe aq më tepër për një detyrim të tillë ndaj gjykatës.

- Me këtë rast theksoj faktin se, është kjo arsyeja që për realizimin e një procesi të rregullt ligjor, ligjvënësi ka zëvendësuar fjalë në pikën 1 të dispozitës, nenit 427 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, nga “vendos përsëritjen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor”, ka zëvendësuar shprehimisht me fjalët “përsërit shqyrtimin gjyqësor”. Kjo është esenciale dhe duhej të zbatohet detyrimisht nga gjykata e apelit se i shërben procesit të rregullt ligjor, përderisa gjykata e apelit, pa shqyrtuar të gjitha provat e lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë Lezhë, absolutisht duke paragjykuar çështjen, duke cenuar parimin e paanësisë dhe duke i dhënë një prove vlerë paracaktuese, në kundërshtim me kriteret e caktuara në nenin 152 të KPP-së.

- Vendimi i gjykatës është haptazi në kundërshtim me kriteret e caktuara në normën procedurale, nenin 427/4 të KPP-së, ku thuhet: “4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.”. Sikurse del, ligji procedural është taksativ sipas të cilit kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, prandaj dhe ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe në asnjë mënyrë të veprohet me përsëritje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor.

- Pavarësisht nga ky veprim antiligjor i gjykatës në procedim, gjykata ka zbatuar gabim ligjin për deklarimin fajtor të gjykuar/rekursuesin vetëm “mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë”, çka rezulton qartësisht në pjesën arsyetuese të vendimit, kapitulli II “Arsyetim ligjor i fajësisë së të pandehurit Gjergj Lekaj”, faqet 47–63 të vendimit.

- Pra, referuar në tërësi pjesës arsyetuese të vendimit të gjykatës së apelit rezulton objektivisht qartë se vendimi i dhënë prej saj, me anën e të cilit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së faktit e ka deklaruar fajtor të gjykuar/rekursuesin për veprën penale të shpërdorimit të kompetencave, parashikuar nga neni 164 KP, nuk është rezultat i rishqyrtimit të vlerësimit në tërësi i provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë apo të marrjes së provave të reja, por është vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, çka përbën shkak për prishje të vendimit të apelit për zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal.

- Vendimi është i pabazuar në ligjin material. Mbështetur në materialet që ndodhen në dosjen gjyqësore penale, analiza, shqyrtimi, verifikimi dhe vlerësimi i tyre në korrelacion të dispozitave ligjore, neneve 149 e 152/1 të KPP-së në lidhje me ligjin material, nenin 164 të KP-së, rezulton objektivisht qartë se deduksioni i nxjerr nga gjykata nuk është rezultat i analizës e vlerësimit të rrethanave që lidhen me veprën penale të shpërdorimit të kompetencave, por janë deduksione teorike, hamendësi të pathemelta të deklaruara nga kallëzuesi, të përpunuar në sinkron me ekspertin dhe të miratuara nga gjykata. Në pjesën përshkruese e arsyetuese të vendimit nuk gjendet i përshkruar mekanizmi i veprës penale të shpërdorimit të kompetencave, parashikuar nga neni 164 i KP-së, ku të analizohen elementet e figurës së krimit, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Në këtë kuadër gjykata nuk ka pasur parasysh se krimi i shpërdorimit të kompetencave, sipas së drejtës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për funksionimin normal të shoqërisë tregtare, sigurimin e interesave të saj të ligjshme, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale, e kufizuar kjo në një veprim të caktuar që lidhet me fondet e me subjektin e posaçëm, që në kuptim të nenit 164 të KP-së, nuk do të thotë që shkelja e dispozitave të ligjit nr. 7638/1992, “Për shoqëritë tregtare” (akuza i referohet gabim ligjit nr. 9901/2008, që nuk ka qenë në fuqi), në bazë të të cilit është themeluar e funksionuar shoqëria “Emanuel Gas” sh.a. përbën veprën penale të shpërdorimit të kompetencave, sepse jo çdo shkelje ligjore përbën vepër penale, por vetëm ato shkelje, që parashikon ligji material.

- Nga sa sipër, arrihet në përfundimin se, vendimi i gjykatës së apelit është i padrejtë, i pabazuar në ligj, madje në zbatim të gabuar të ligjit penal, me pasojë prishjen e tij, çka është në kompetencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që të vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në referim të nenit 441 të KPP-së.

II. Nevoja për njësim të praktikës gjyqësore dhe procedura e gjykimit njësoje

17. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), ka planifikuar gjykimin e kësaj çështje në dhomë këshillimi sipas parashikimit të nenit 436/a, të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “KPP”), duke u njoftuar palët, në përputhje me nenin 436, paragrafët 2, 3 të KPP-së.

18. Gjatë gjykimit në dhomën e këshillimit, Kolegji, pasi shqyrtoi dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, shkaqet e ngritura në rekurs, shqyrtoi vendimet e gjykatave, duke konstatuar se në rekurs janë ngritur çështje, trajtimi dhe zgjidhja e të cilave do t'i shërbejë njësimi të praktikës gjyqësore, duke vërejtur se për çështjet që janë ngritur pretendime si shkak rekursi, ka praktika gjyqësore të ndryshme dhe interpretime të ndryshme të ligjit procedural, vendosi nisjen e procedurës së njësimi të praktikës gjyqësore në përputhje me parashikimet e nenit 438 të KPP-së, si dhe zgjidhjes së drejtë të çështjes konkrete, objekt shqyrtimi.

19. Kështu, evidentohet se, në rekursin e paraqitur nga i gjykuari, rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, paraqiten pretendime për shkelje procedurale gjatë gjykimit të çështjes pranë gjykatës së apelit, në zbatimin e nenit 427 të KPP-së “përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, dhe në veçanti për

zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, në lidhje me detyrimin e gjykatës së apelit për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, e në pamundësinë që kjo gjykatë të vendosë për deklarimin fajtor vetëm mbi vlerësimin ndryshe të provave të marra në gjykimin e shkallës së parë. Gjithashtu konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit ka trajtuar disa nga çështjet që lidhen me zbatimin e paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së, që lidhen me interpretimin e termit “Përsëritje e shqyrtimit gjyqësor”, masën e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, kuptimin e vlerësimit të gabuar të provës e mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykimin në apel pa kërkesë të prokurorit.

20. Kolegji konstatoi, se për çështje të zbatimit të nenit 427/4 të KPP-së ka praktika të ndryshme nga ana e gjykatave të apeleve, si dhe kuptime të ndryshme në lidhje me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkretisht në lidhje me zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, nëse përmbajtja e këtij rregullimi e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor tërësisht apo pjesërisht, nëse vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori, e se cilat prova mund të merren gjatë gjyimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, si dhe në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjyimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar.

21. Kolegji në zbatim të parashikimeve të nenit 438 paragrafi 1 të KPP-së, duke konstatuar se ekziston nevoja për njësim të praktikës gjyqësore për çështjet e evidentuara në këtë gjykim dhe në analizë të praktikës gjyqësore të deritanishme të interpretimit gjyqësor e zbatimit të kësaj norme të re procedurale, vendosi nisjen e procedurës së gjyimit për të njësuar praktikën gjyqësore për çështje të zbatimit të nenit 427/4 të KPP-së.

22. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi të njësojë praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 427/4 të KPP-së, pas ndryshimeve ligjore që ka pësuar kjo dispozitë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, duke shtruar për njësim çështjet si vijon:

1. Zbatimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, a e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor (tërësisht apo pjesërisht)?

1.1 Vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, a kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori?

2. Cilat prova mund të merren gjatë gjyimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së?

3. Në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjyimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar?

23. Sa më sipër, Kolegji vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 438 të KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021. Në këto kushte, u formua trupa gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjyqësore, çështjeve të shtruara për njësim, duke u lënë palëve afatin prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyruan çështjet e shtruara për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

24. Gjykimi njësuës u zhvillua në seancë gjyqësore, në prani të palëve e në debat gjyqësor. Palët në proces paraqitën përgjigjet e tyre mbi pyetjet e shtruara për njësim nga ku:

Prokuroria e Përgjithshme ka dhënë këto përgjigje mbi çështjet e shtruara për njësim:

- Gjykata e apelit nuk është e detyruar që në çdo rast që ankimohet vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për pafajësi dhe ankimi ka në themel goditjen e pafajësisë, të bëjë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e apelit, në zbatim të pikës 4 të nenit 427 të KPP-së ka detyrimin të përsëris shqyrtimin gjyqësor sa herë që ajo gjykon se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që ka

dhënë pafajësi mund të jetë i cënueshëm në lidhje me pafajësinë. Kjo mund të ndodhë kur gjatë vlerësimit paraprak që gjykata e apelit i bën dosjes/çështjes, ngre çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga Gjykata e Shkallës së Parë, çështje të cilat janë ngritur dhe në ankimin e prokurorit, të cilat me një vlerësim tjetër mund të çojnë në fajësi.

- Në gjykimin e vendimit të pafajësisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit mund të vendosë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kur në apelin e prokurorit ngrihen çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, të cilat me një vlerësim tjetër mund të çojnë në dhënien e fajësisë. Vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nuk kushtëzohet domosdoshmërisht me kërkesën e prokurorit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Në këto raste, gjykata e apelit mund të vendosë kryesisht për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

- Sa herë që gjykata e apelit vendos të përsërisë shqyrtimin gjyqësor sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, do të ushtrojë të gjitha tagrat që ushtron gjykata e shkallës së parë, duke filluar gjykimin nga e para, sikur gjykimi në shkallë të parë të mos kishte ndodhur. Është në diskrecionin e gjykatës së apelit të përcaktojë provat që duhet të marrë si gjykatë e shkallës së parë. Por, provat që ajo vendos të mos i marrë, nuk mund të bëhen pjesë e vendimit gjyqësor.

- Edhe në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit kur vlerëson së vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë prova, duke i debatuar ato dhe duke i dhënë mundësi të pandehurit të diskutojë mbi to, duke marrë prova të reja. Nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqësor i ripërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar e është proceduar me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rast të vendimit të fajësisë nga gjykata e apelit.

Mbrojtja e rekursuesit ka dhënë këto përgjigje për çështjet e shtruar për njësim:

- Në rastet kur apelohej vendimi i pafajësisë, gjykata e apelit kryesisht nuk mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor tërësisht kurse pjesërisht absolutisht jo, pasi ka detyrimin ligjor të respektojë e zbatojë parimet kushtetuese, si parimin e prezumimit të pafajësisë; parimin e provueshmërisë së veprës penale dhe parimin e humanizmit, si organ që realizon dhënien e drejtësisë.

- Gjatë gjykimit në apel mund të merren prova, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, vetëm nëse në aktin e apelit kërkohet rimarrja e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose prova të reja nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 427 të KPP-së “2. Për provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty gjykata vendos sipas rastit, marrjen ose jo të tyre”.

- Kur çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, në gjendjen që janë aktet në fashikullin e hetimeve paraprake, dhe i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, nuk duhet të zbatohet parashikimi i paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, pasi efektet e gjykimit të shkurtuar janë për ekonomi gjyqësore dhe pa qenë e nevojshme marrja e provave të tjera e nënshtrimit të shqyrtimit gjyqësor. Në të kundërt, duhet të cenohet vendimi i ndërmjetëm i miratimit të gjykimit të shkurtuar dhe mandej të përsëritet shqyrtimi gjyqësor me lejim të marrjes së provave të reja, por që është me pasoje mospërfitimi i të pandehurit nga gjykimi i shkurtuar, sepse ka humbur efektet dhe kuptimin e tij. Përfitimi nga gjykimi i shkurtuar duhet vetëm nëse në apel, pas marrjes së provave të reja, i pandehuri i pranon ato dhe kërkon të procedohet me gjykim të shkurtuar.

III. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

25. Kolegji thekson se mosrëndimi i pozitës së të pandehurit së bashku me parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën e mbrojtjes, aksesin në gjykim e të drejtën për t'u dëgjuar e marrë provat e kërkuara, barazia e armëve në procesin gjyqësor penal, dhe e drejta e ankimit janë elementet thelbësorë të procesit të drejtë gjyqësor në kuptim të nenit 30, 31, 42, 43 të Kushtetutës¹ dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat

¹ Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

e Njeriut (në vijim “KEDNJ”) e duhet të trajtohen si kushte të domosdoshme e kumulative për garantimin e pozitës së të pandehurit në procesin gjyqësor penal. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformation in peius*) është i lidhur me garancinë e aksesit në gjykatë si element i procesit të rregullt, mbron pozitën e të pandehurit gjatë gjykimit në shkallë të dytë dhe në veçanti të pandehurit që është deklaruar i pafajshëm në shkallë të parë, e që lidhet me të drejtën e ankimit të sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës ².

26. Zbatimi i këtij parimi është një garanci për të gjykuar me qëllim që të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës. Mosrespektimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit përbën cenim të thelbit të gjykimit dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, neni 6 i saj. Respektimi i këtij parimi gjatë gjykimit garanton të drejtën e ankimit dhe përmbush të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e paanshme që garanton barazinë e armëve në proces. Jurisprudenca kushtetuese në një sërë vendimesh ka rikonfirmuar këtë rëndësi të zbatimit të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit,³ duke u shprehur se zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuar, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t’iu drejtuar me ankim gjykatës. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 22.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformation in peius*) si një parim i përgjithshëm normativ është rrjedhojë e drejtpërdrejt e parimit *ne eat index ultra petita partium*, një parim dispozitiv i një rregulli të tillë sipas së cilit gjyqtari nuk mund të disponojë më shumë se sa palët kërkojnë e se gjyqtari duhet të shqyrtojë ankimin për aq sa kërkojnë palët, dhe e parimit *tantum devolutum quantum appellatum* sipas së cilit gjykata e shkallës së dytë e shqyrton ankimin vetëm për sa është paraqitur në ankim.

28. Në dispozitat tona procedurale që parashikojë ankimin në apel, janë sanksionuar këto parime që garantojnë paanësisë e gjykatës në rastin vetëm të ankimit të të pandehurit⁴, por me mundësinë që gjykata e apelit të shqyrtojë ankimin edhe mbi motive të tjera, të cilat ngrihen kryesisht nga gjykata⁵ ose nga palët, por që mund të prekin edhe palët e tjera kur nuk lidhen me motive ngushtësisht personale⁶. Në funksion të garantimit të pozitës së të pandehurit e së drejtës për t’u mbrojtur e paraqitur prova në gjykimin në shkallë të dytë, Kodi parashikon mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, nëpërmjet rimarrjes së provave të lejuara gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, ose marrjen e provave të reja nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor me kërkesë të palëve apo edhe kryesisht nga gjykata e apelit⁷.

29. Neni 427/4 i KPP-së konfirmon parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit

² Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështjet civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

³ Vendimi nr. 3/2003 dhe vendimi nr. 46 datë 11.6.2024 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 20 i tij.

⁴ Neni 425/3 i KPP-së “Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë masë sigurimi më të rëndë, t’i japë pafajësisë një shkak më të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë”

⁵ Neni 425/1 i KPP-së “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon të bashkëtepandehurve që nuk kanë bërë apel.

⁶ Neni 416/1 i KPP-së “Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë”.

⁷ Neni 427, paragrafët 1, 2, 3 “Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, i ndryshuar me ligjet nr. 35/2017 datë 30.3.2017 dhe ligjin nr. 41/2021 datë 23.3.2021.

(*reformation in pejus*), duke mbrojtur pozitën e të pandehurit të deklaruar të pafajshëm gjatë gjykimit në shkallë të parë e kushtëzuar gjykatën e apelit për ndryshimin e këtij vendimi, duke sanksionuar rregullin se kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund të deklarojë fajtor të pandehurin vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, e duke u detyruar që në këtë rast të përsërisë shqyrtimin gjyqësor.

30. Zbatimi e përmbushja i këtij parimi është i lidhur me atë të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e paanshme, si element i rëndësishëm i procesit gjyqësor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.

31. E drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe e drejta për t'u dëgjuar në gjykimin në apel sanksionohet nga parimet e përgjithshme të së drejtës së ankimit. E drejta e ankimit i është njohur të pandehurit, prokurorit, viktimës akuzuese, paditësit civil dhe të paditurit civil. Kështu, neni 410 i KPP-së parashikon të drejtën e të pandehurit për të bërë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, ndërsa neni 425 i KPP-së, parashikon se gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Jurisprudenca kushtetuese e ka trajtuar të drejtën e ankimit, duke theksuar se, për sa i përket së drejtës së ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kjo e drejtë është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar personit në procedim të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë⁸.

32. Pikërisht me këtë fazë të shqyrtimit të ankimit në apel është i lidhur dhe zbatimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformation in peius*) në mënyrë të veçantë ofron garancinë juridike për pozitën e të pandehurit ndaj vendimit të pafajësisë. Shfajësimi i të akuzuarit nga akuzat gjatë një gjykimi objektiv, të plotë e të paanshëm është pasojë e zbatimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. Neni 30 i Kushtetutës ka përcaktuar se "*Kushdo qubet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*", materializuar e sanksionuar në nenin 4 të KPP-së.

33. Parimi i prezumimit të pafajësisë nuk mund të zbatohet i veçuar nga ai i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes penale mbi ankimin e palëve. Nevoja për harmonizimin e këtyre parimeve është marrë parasysh në ndryshimet e bëra në KPP në vitin 2017⁹, duke synuar përmirësimin e pozitës së të pandehurit gjatë hetimit e gjykimit të procedimit penal. Vendimi i pafajësisë është një nga format e disponimit që gjykata e shkallës së parë mund të japë në përfundim të gjykimit sipas parashikimeve të nenit 388 të KPP-së¹⁰. Vendimi i pafajësisë garanton zbatimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si një nga parimet themelore të procedimit, si dhe atë të paanshmërisë së gjykatës. Gjykimi me paanshmëri e një çështje gjyqësore penale kërkon që zgjidhja përfundimtare e çështjes në gjykim, të jetë rrjedhojë e analizës tërësore

⁸ Vendimi nr. 38, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese.

⁹ Ligji nr. 35/2017, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë".

¹⁰ "Gjykata merr vendim pafajësie kur: a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale; c) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet; d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet; e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qenien e tyre."

dhe përfundimtare të çështjes, bazuar në provat e shqyrtuara në ligj dhe në bindjen e brendshme që krijon gjyqtari pas kësaj analize.

34. Motivimi i vendimit të pafajësisë nënkupton detyrimin e gjykatës për të arsyetuar vendimin sipas nenit 112 të KPP-së¹¹, me të gjitha elementet esenciale të vendimit të kërkuar nga neni 383 i KPP-së, ku në mënyrë të veçantë atë që parashikon shkronja “ç” e këtij neni, provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta. Vendimi i pafajësisë garanton pozitën e paanshme të gjykimit, konfirmon detyrimin e barrës së provës nga organi i akuzës por dhe përmbush të drejtën e akuzës e të viktimës për të njohur arsyet e moskonfirmimit të akuzave të ngritura në drejtim të të pandehurit në atë proces. Ashtu sikurse e drejta e prokurorit për të kërkuar konfirmimin e akuzës, e ankuar rrëzimin e saj përfaqëson interesin publik të procedimit penal e qëllimin e ushtrimit të ndjekjes penale.

35. Ushtrimi i së drejtës së ankimit nga ana e prokurorit ose viktimës akuzuese ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar me dhënien e pafajësisë për të pandehurin, arsyet e dhënies së këtij vendimi përcaktojnë kufijtë e gjykimit rishikues në apel, si dhe procedurën gjyqësore që duhet të ndjekë gjykata e apelit në rast se kërkohet ndryshimi *in peius* i pozitës së të pandehurit në këtë shkallë gjykimi. Këto parime gjejnë zbatim në çdo shkallë të gjykimit. Gjykimi në apel është një garanci për kontrollin gjyqësor të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e mundësinë e rishqyrtimit të pretendimeve të të pandehurit, kjo nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 427 të KPP-së.

36. Përmbajtja e nenit 427 të KPP-së ka pësuar ndryshime, që nga koha e miratimit të KPP-së (ligji nr. 7905, datë 21.3.1995). Neni 427 i KPP-së i titulluar “Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, në momentin e miratimit të kësaj dispozite dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, ka pasur këtë përmbajtje: “1. Kur një palë kërkon rimarrjen e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se një gjë e tillë është e nevojshme, vendos përsëritjen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor. 2. Për provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty, gjykata vendos, sipas rastit, marrjen ose jo të tyre. 3. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme. 4. Gjikata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. 5. Për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm, procedohet menjëherë dhe kur kjo nuk është e mundur, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se dhjetë ditë.”

37. Me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017, neni 427 i KPP-së pësoi ndryshime dhe tashmë kjo dispozitë parashikon se “1. Kur një palë në aktin e apelit, ose plotësimin e tij, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor. 2. Për provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty, gjykata vendos, sipas rastit, marrjen ose jo të tyre. 3. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme. 4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor. 5. Për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm, procedohet menjëherë dhe kur kjo nuk është e mundur, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se dhjetë ditë”. Me ndryshimet e ligjit nr. 41/2021 datë 23.3.2021, paragrafi i parë i nenit 427 pësoi ndryshim duke u hequr togfjalëshin “ose plotësimin e tij” e duke lënë vetëm shprehjen “Kur një palë në aktin e apelit”.

38. Ndërhyrja dhe ndryshimi në thelb i përmbajtjes së paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së, u kushtëzua nga detyrimi i respektimit të standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”), ku në disa vendime të saj ka sanksionuar detyrimin e gjykatës së apelit për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, kur vendimi i shkallës së parë që ka

¹¹ Vendimi dhe urdhri arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm.

deklaruar të pafajshëm të pandehurin, ndryshon në apel *in peius*, pra përkeqëson pozitën e të pandehurit.¹²

39. Prandaj dhe interpretimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së duhet bërë mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së, mbi nenin 6 të KEDNJ-së në aspektin penal, jurisprudencë e cila ka ndikuar në krijimin e një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues. GJEDNJ-ja në këtë jurisprudencë ka arsyetuar në mënyrë vazhduese se, në të gjitha rastet kur gjykata e apelit ka juridiksion rishikues fakti sikurse në sistemin tonë juridik e procedural penal dhe ato shqyrtojnë çështje të fajësisë apo pafajësisë në procesin penal, për hir të respektimit të nenit 6 të KEDNJ-së dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor, ato nuk mund të konkludojnë dhe të vendosin mbi këto çështje pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave, në rastet kur ato janë vendimtare për të konkluduar mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit (*vendimi i GJEDNJ, Lorefice v. Italy*).

40. Jurisprudenca e GJEDNJ-ja ka vënë theksin te zbatimi i parimit të gjykimit të drejtë në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit. Në çështjen *Lorefice v. Italy*, GJEDNJ-ja shprehet: “Gjykata e apelit nuk përsëriti marrjen e provave por u kufizua në shqyrtimin e deklaratave sipas procesverbalit të regjistrimit të tyre, anulimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe fajësimi i të pandehurve në këtë mënyrë sjell shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së”. Si rregull, kur një gjykatë apeli anulon një vendim pafajësie të dhënë në shkallë të parë, ajo duhet të marrë masa pozitive për të siguruar mundësinë që i akuzuari të dëgjohet¹³. Si alternativë, gjykata e apelit duhet të kufizohet në shfuqizimin e vendimit të pafajësisë të gjykatës më të ulët dhe rikthimin e çështjes për rigjykim¹⁴. Në çështjen *Ignat kundër Rumanisë*¹⁵, bëhet një trajtim në lidhje me një mosmarrëveshje midis gjykatave të shkallës së parë dhe të shkallës së fundit në lidhje me mënyrën e vlerësimit të rëndësisë së provave me dëshmitarë në dritën e provave dokumentare, të cilat nuk përfshinin çështje të vërtetësisë dhe besueshmërisë së dëshmitarëve si të tillë. Kjo nënkupton nevojën për të pyetur dëshmitarët. (*Dan kundër Republikës së Moldavisë (nr. 2, 2020)*).

41. Në çështjen *Dan kundër Republikës së Moldavisë*¹⁶, GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi dënimi i ardhur si pasojë e gjykimit në apel, ishte vendosur pa rimarrë ato prova deklarative, të konsideruara thelbësore. Vlerësimi thjesht i këtyre provave, u quajt nga kjo gjykatë, si absolutisht e pavlefshme për të garantuar një proces të rregullt ligjor, duke konsideruar kompleksitetin dhe delikatesën e gjykimit mbi bazueshmërinë e këtyre provave, që bëhet i mundur nga garancia e oralitetit që karakterizon procesin penal akuzator. Sipas Gjykatës Evropiane edhe në gjykimin e çështjes prej gjykatës së apelit, kjo e fundit që mban përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve duhet që të jetë në gjendje të dëgjojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarët në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së tyre, për sa kohë që ky vlerësim përbën një detyrim kompleks, i cili normalisht nuk mund të konsiderohet i realizuar me një lexim të thjeshtë të deklaratimeve të tyre.

42. Praktika gjyqësore e gjykatës për këtë çështje bën një dallim midis dy situatave: nga njëra anë, ku një gjykatë apeli, e cila anulon një vendim pafajësie pa dëgjuar vetë provat deklarative mbi të cilat bazohej lirimi, jo vetëm që kishte juridiksion për të shqyrtuar pikat faktike dhe të ligjit, por në fakt vazhdoi me një vlerësim të ri të fakteve; dhe, nga ana tjetër, situatat në të cilat gjykata e apelit vetëm nuk u pajtua me gjykatën më të ulët për interpretimin e ligjit dhe/ose zbatimin e tij ndaj fakteve të vërtetuara, edhe nëse ajo kishte gjithashtu juridiksion në lidhje me faktet. Në çështjen *Igual Coll kundër Spanjës*¹⁷, gjykata konsideroi se gjykata e apelit nuk kishte dhënë thjesht

¹² GJEDNJ, *Dan kundër Moldavisë*, aplikimi nr. 8999/07, vendimi i datës 5.10.2011; *Hannu kundër Rumanisë*, aplikimi nr. 10890/04, vendimi i datës 4.9.2013, *Di Martino dhe Molinari v. Italy*” nr. 16459/15 datë 25 mars 2021.

¹³ Vendimet e GJEDNJ-së, *Botten kundër Norvegjisë*, 1996, § 53; *Dänilă kundër Rumanisë*, 2007, § 41; *Gómez Olmeda kundër Spanjës*, 2016, § 32.

¹⁴ GJEDNJ, vendimi *Július Dór Sigurpórsson kundër Islandës*, 2019, § 38.

¹⁵ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Ignat kundër Rumanisë*, 2021, §§ 56-57.

¹⁶ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Dan kundër Republikës së Moldavisë (nr. 2)*, 2020).

¹⁷ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Igual Coll kundër Spanjës*, 2008, § 36.

një interpretim të ndryshëm ligjor ose nuk kishte bërë një zbatim tjetër të ligjit për faktet e vërtetuara tashmë në shkallën e parë, por kishte kryer një vlerësim të ri të fakteve përtej konsideratave thjesht ligjore.¹⁸

43. Në mënyrë të ngjashme, në *Marcos Barrios kundër Spanjës*¹⁹, gjykata u shpreh se gjykata e apelit ishte shprehur për një çështje fakti, domethënë besueshmërinë e një dëshmitari, duke modifikuar kështu faktet e vërtetuara në shkallë të parë dhe duke marrë një qëndrim të ri mbi faktet që ishin vendimtare për përcaktimin e fajit të ankuesit²⁰, gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, me arsyetimin se aspektet të cilat gjykata e apelit ishte bazuar për të dënuar kërkuesin kishin pasur një karakter kryesisht ligjor dhe vendimi i saj kishte deklaruar shprehimisht se nuk i takon asaj të bënte një vlerësim të ri të provave; përkundrazi, ajo kishte miratuar vetëm një interpretim ligjor të ndryshëm nga ai i gjykatës më të ulët (*Lamatic kundër Rumanisë*, 2020). Në mënyrë të ngjashme, në çështjen *Ignat kundër Rumanisë*, 2021, §§ 47–59, ku gjykatat e shkallës së parë dhe të shkallës së fundit nuk u pajtuan në lidhje me mënyrën e vlerësimit të provave dokumentare të disponueshme, gjykata nuk konsideroi se gjykata e shkallës së fundit detyrohej për të dëgjuar drejtpërdrejt dëshmitë e dëshmitarëve. Megjithatë, siç shpjegohet nga gjykata në *Suuripää kundër Finlandës*²¹, duhet të merret parasysh se faktet dhe interpretimi ligjor mund të ndërthuren në një masë sa të jetë e vështirë të ndahen të dy nga njëri-tjetri.

44. Në çështjen *di Martino dhe Molinari kundër Italisë*²², GJEDNJ-ja ka bërë vlerësimin e zbatimit të nenit 603 të KPP-së italian, mbi gjykimin e shkurtuar, nën frymën e zbatimit në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja thekson se kur një gjykatë apeli thirret për të shqyrtuar një çështje në fakt dhe në ligj, fajësinë ose pafajësinë në tërësi, nuk mund të vendosë objektivisht për këto çështje pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave apo dëshmive të paraqitura nga vetë i akuzuari që pretendon se nuk e ka kryer veprën penale. Vlerësimi i fajësisë apo i pafajësisë duhet të bëhet duke i dëgjuar drejtpërdrejt dëshmitarët (marrë provat) e duke vlerësuar besueshmërinë e tyre. Vlerësimi i besueshmërisë është detyrë komplekse e cila nuk mund të realizohet thjesht duke lexuar përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve siç ka vepruar gjykata në rastin në shqyrtim sipas procesverbalit të seancës... ankuesit u gjykuan sipas procedurës së gjykimin të shkurtuar duke u liruar nga akuzat. Gjikata e apelit e ndryshoi vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe i shpalli kërkuesit fajtorë pasi kishte dhënë një interpretim të ri të të gjitha provave, duke përfshirë deklaratat e të gjithë dëshmitarëve, duke i konsideruar të mjaftueshme për të vendosur për dënimin.

45. Ka qenë pikërisht kjo frymë e këtij trajtimi parimor nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, që u reflektua në legjislacionin procedural penal shqiptar në nivel norme ligjore, në nenin 427/4, me ndryshimin e pësuar në pikën 4 të nenit 427, në vitin 2017. Kjo dispozitë në këtë pjesë parashikon:

“4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.”

46. Kolegji në nevojën e gjykimin njësoj ka konstatuar se nga ana e gjykatave të apelit ka pasur interpretime të ndryshme në lidhje me natyrën e detyrimit procedural të kësaj gjykate në funksion të riçeljes së shqyrtimit gjyqësor, nëse ky detyrim është absolut, nëse riçelja i referohet shqyrtimit gjyqësor në tërësinë e tij apo provave që çmohen prej gjykatës, e në vijim mënyrës së zbatimit të kësaj dispozite. Kjo në mënyrë të veçantë në zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP-

¹⁸ Vendimet e GJEDNJ-së, *Spînu kundër Rumanisë*, 2008, §§ 55-59; *Andreescu kundër Rumanisë*, 2010, §§ 65–70; *Almenara Alvarez kundër Spanjës*, 2011.

¹⁹ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Marcos Barrios kundër Spanjës*, 2010, §§ 40–41.

²⁰ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Hernández kundër Spanjës*, 2010, §§ 33, 34.

²¹ GJEDNJ, vendimi mbi *Suuripää kundër Finlandës*, 2010, § 44.

²² GJEDNJ, çështja *Di Martino dhe Molinari kundër Italisë*, nr. 15931 dhe 16459/15, datë 25 mars 2021.

së, si në rastet kur gjykimi është zhvilluar në ritin procedural të gjykimit të zakonshëm ashtu edhe në rastet kur gjykimi në shkallë të parë është konceptuar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar.

47. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në praktikën e tij mbi çështje të zbatimit të nenit 427 të KPP-së, e ka vënë theksin tek arsyetja e normës së re të krijuar me ndryshimet procedurale të vitit 2017, në nevojën e respektimit të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Në vendimin nr. 00-2023-1735(285), datë 31.10.2023, KPGJL thekson se rishqyrtimi gjyqësor në apel, në funksion të rimarrjes së provave të karakterit deklarues, mbi bazën e të cilave është vendosur pafajësia e të pandehurit në përfundim të gjykimit të shkurtuar në shkallë të parë, konsiderohet absolutisht i domosdoshëm në kushtet kur dyshimi lidhur me besueshmërinë e tyre, si në gjykimin e zakonshëm, ashtu edhe në gjykimin e shkurtuar mund të tejkalohet vetëm nëpërmjet aplikimit të marrjes së provës, në mënyrë të drejtpërdrejtë në prezencë të kontradiktoritetit të palëve, para një gjykate të paanshme.

48. Në vendimin nr. 00-2023-2007(331), datë 5.12.2023, KPGJL-ja çmon se, vlerësimi i kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e apelit, në rast të deklarimit të pafajshëm të të pandehurit gjatë gjykimit në shkallë të parë, duhet bërë nisur nga kriteri se cila provë nga ato që parashikon KPP-ja është e nevojshme të merret gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, që nuk është marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë e që duke u vlerësuar me të tjerat ndryshon vlerësimin ndaj të provuarit të akuzës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm duke respektuar pozitën procedurale të të pandehurit. Parashikimi i këtij neni (*paragrafi 4 i nenit 427 të KPP-së*), është i zbatueshëm jo vetëm në rastin e shqyrtimit në apel të një çështje penale të përfunduar me vendim pafajësie përgjatë gjykimit të zakonshëm, por edhe në rastin e procedimit me ritin e gjykimit të shkurtuar. Procedura e gjykimit të shkurtuar nuk e pengon gjykatën e apelit në zbatimin e kësaj garancie për të pandehurin, pasi prevalon garancia për dhënien e një vendimi fajësie mbi prova të shqyrtuara sipas parimit të marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykatat.

49. Në vendimin nr. 657(175), datë 21.6.2022, KPGJL-ja vlerëson se kur procedimet ndaj të pandehurit kanë filluar në kohë dhe për çështje të ndryshme, por me të njëjtën akuzë, është në të drejtën e tij që pretendimet t'i parashtojë para prokurorit/gjykatës për bashkimin e çështjeve, me kusht që çështja të jetë në të njëjtën gjendje/shkallë gjykimi. Në rast se nuk është bërë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, gjykata e apelit, kur vlerëson se vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë, mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor të plotë, duke marrë prova të reja dhe jo të vendosë vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë.

50. Në vendimin nr. 110, datë 30.7.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër, vendim i çështjes që është kaluar për njësim të praktikës, Gjykata e Apelit ka bërë këtë interpretim gjyqësor në lidhje me detyrimin për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor gjatë gjykimit në apel sipas nenit 427/4 të KPP-së, se ligjvënësi nuk bën fjalë për "*përsëritje tërësisht të shqyrtimit gjyqësor*", dhe aq më tepër për një detyrim të tillë ndaj gjykatës, dhe se vetë parashikimi rimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë, marrja e provave të reja, do të thotë se shqyrtimi gjyqësor mund të përsëritet pjesërisht ose në mënyrë të plotë. Gjykata e Apelit e ka interpretuar këtë normë sipas logjikës që nëse provat e marra në gjykimin e shkallës së parë i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit, atëherë këto prova vlerësohen jo mbi bazën e vlerësimit që ka bërë gjykata e shkallës së parë, por mbi bazën e përfundimeve që gjykata e apelit arrin nga shqyrtimi i këtyre provave në gjykimin në Gjykatën e Apelit, pra provat nuk janë marrë të mirëqena nga gjykata e faktit, por ato i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, dhe nga ky shqyrtim gjykata që rishqyrton këto prova mund të dalë në përfundime të kundërta nga ato të arritura nga gjykata e shkallës së parë, duke i vlerësuar ndryshe nga sa i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, nëse kjo dispozitë do të interpretohet ndryshe, atëherë bie qëllimi i ligjvënësit i cili ka disponuar që gjykata e apelit mund të vendosë rishqyrtimin e provave të marra në gjykimin në shkallë të parë dhe se gjykata e apelit nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj një

vlerësimi të gabuar të provave, me arsyetimin se ato janë shqyrtuar një herë në gjykatën e shkallës së parë, pasi kjo humbet sensin dhe qëllimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.

51. Kolegji në ushtrim të funksionit të tij kushtetues për njësimin e praktikës gjyqësore, ka sjellë në vëmendje se ka qëndrime të ndryshme mbi mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite procedurale nga ana e gjykatave të apelit, për rrjedhojë nevojitet mbajtja e një qëndrimi njësuës për garantimin e njëtrajtësisë së mënyrës së zbatimit të ligjit, në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor, në gjykimin penal pranë gjykatave rishikuese të apelit, sa herë implikohet zbatueshmëria e nenit 427 (4) të KPP-së. Në këtë këndvështrim merr rëndësi pozicioni dhe roli i Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, e cila sipas nenit 141 të Kushtetutës (*ndryshuar me ligjin nr.76/2016*), ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta.

52. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore njësuëse²³. Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të të njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja konkludon se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtëm të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedural që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; *së treti*, nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave²⁴.

53. Jurisprudenca kushtetuese ka trajtuar nga pikëpamja e kushtetueshmërisë normën nëpërmjet kontrollit incidental të kushtetueshmërisë së saj nga gjyqtari. Me vendimin nr. 6, datë 15.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesën e Gjykatës së Apelit Vlorë, për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të pikës 4, të nenit 427, të KPP-së. Në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, në kuptim të përmbajtjes së kësaj dispozite, kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimin në shkallë të parë. Në këtë vështrim, nga përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar rezulton se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon *apriori* në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimin, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP-së, në lidhje me llojin e vendimmarrjes²⁵. Nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP-së, gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se rregulli procedural i parashikuar nga neni

²³ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Lupaș and Others v. Romania*, ap.nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006XV.

²⁴ GJEDNJ, vendimi mbi çështjen *Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40.

²⁵ Vendimi nr. 6, datë 15.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 19–21 të vendimit.

427, pika 4, i KPP-së, nuk kufizon hapësirën e nevojshme, të dhënë nga ligji, që gjykata referuese ka për zgjidhjen e çështjes konkrete.

54. Në konfirmim të të njëjtit qëndrim, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 29, datë 12.2.2021, shprehet se pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve të gjykatës referuese, në thelb ato kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 427, pika 4, të KPP-së, të ndryshuar. Siç ka theksuar edhe Mbledhja e Gjyqtarëve në vendimin nr. 6, datë 15.1.2021, në kushtet kur ndodhemi para një dispozite të re, e cila, siç rezulton edhe nga kërkesa në shqyrtim, paraqet probleme të interpretimit dhe zbatimit të saj, është detyrë dhe kompetencë e Gjykatës së Lartë që në përputhje me funksionin e saj njësoj, të investohet për interpretimin e kësaj dispozite, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Po ashtu, Kolegji rritet rëndësinë e rolit të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, e cila, në kushtet kur ndodhemi para një dispozite të re ligjore, në përputhje me funksionin e saj kushtetues, duhet të investohet për t'i dhënë kuptimin e duhur zbatimit të nenit 427, pika 4, të KPP-së, për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

55. Në vështrim, e interpretim krahasimor, Kolegji vlerëson se është e nevojshme të bazohet edhe në jurisprudencën dhe praktikën gjyqësore të vendit të legjislacionit procedural burimor tonin, atë procedural italian. Jurisprudenca dhe praktika gjyqësore italiane në lidhje me rishqyrtimin gjyqësor në gjykatën e apelit (*ndryshim vendim pafajësie të gjykatës së shkallës së parë*) ka reflektuar e ndjekur interpretimin jurisprudencial të GJEDNJ-së, në lidhje me respektimin e këtij parimi, kryesisht në rastet e përbashkëta të legjislacionit italian me kontrollin e GJEDNJ-së.

56. Si pasojë e këtij ballafaqimi, legjislacioni italian u përshtat në nenin 603 të KPP-së, në këtë mënyrë²⁶ “Përsëritje e shqyrtimit gjyqësor” neni 603/3-bis “*Në rastin e ankimit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë për arsye që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave deklarative*”, gjyqtari pa cenuar dispozitat e paragrafëve 1 deri në 3, urdhëron përsëritjen e seancës vetëm në rastet e provave deklarative të marra në seancë gjatë gjyqimit të shkallës së parë ose pas përfshirjes së provave të vendosura në procedurë të shkurtuar në bazë të neneve 438, paragrafi 5,²⁸ dhe 441, paragrafi 5(6).²⁹“

57. Siç del nga përmbajtja e kësaj norme, parashikimi ynë ligjor, neni 427/4 i KPP-së, nuk është i njëjtë me normën analoge, por *ratio* e saj është e përbashkët dhe buron nga i njëjti detyrim, për të përqasur legjislacionin tonë në përputhje me standardin e jurisprudencës e GJEDNJ-së.

58. Keqinterpretimet dhe kuptimin e ngushtë të normës në rastin e interpretimeve gjyqësore të bëra nga gjykatat tona, e ka kushtëzuar pikërisht formulimi i saj jo i plotë e jo sipas kuptimit që këtij parimi i ka dhënë jurisprudenca e GJEDNJ-së apo praktika gjyqësore e gjykatave të vendeve nga të cilat ne kemi marrë këtë normë juridike. Prandaj interpretimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, duhet bërë mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së, mbi nenin 6 të KEDNJ-së në aspektin penal, jurisprudencë e cila ka ndikuar në krijimin e një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues, si dhe mbi praktikën e interpretimit krahasues me legjislacionin e vendeve të tjera, nga të cilat kemi marrë si model këtë rregullim procedural.

59. Në këtë këndvështrim, Kolegji rritet rëndësinë e rolit të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, e cila, në kushtet kur ndodhemi para një dispozite të re ligjore, në përputhje me funksionin e saj kushtetues, duhet të investohet për t'i dhënë kuptimin e duhur zbatimit të nenit 427, pika 4, të

²⁶ Neni 603 i KPP-së italian (ligji nr. 447, datë 22.9.1988 (*azhurnuar më datë 17.7.2024*), paragrafi i zëvendësuar me nenin 34/1, shkronja “i” nr. 1 i dekretit legjislativ 10 tetor 2022, nr. 150, ligji Cartabia.

²⁷ Dëshmia deklarative ka qenë gjithmonë mjeti provues më i përdorur për rindërtimin e fakteve, aq sa konsiderohet si “shtylla” e çdo sistemi provues në Itali.

²⁸ Gjyqtari urdhëron gjykimin e shkurtuar nëse, duke marrë parasysh dokumentet tashmë të fituara dhe të përdorura, rishqyrtimi gjyqësor i kërkuar është i nevojshëm për qëllimet e vendimit dhe gjykimi i shkurtuar në çdo rast arrin ekonomi procedurale, në lidhje me seancën. Në këtë rast prokurori mund të kërkojë pranimin e provave të kundërta.

²⁹ Kur gjyqtari mendon se nuk mund të vendosë duke pasur parasysh gjendjen e dokumenteve, ai merr përsipër, edhe sipas detyrës zyrtare, elementet e nevojshëm për qëllimet e vendimit. Në këtë rast, zbatueshmëria e nenit 423(5) mbetet e paprekur.

KPP-së, për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Këtë thekson dhe Gjykata Kushtetuese³⁰, e cila është shprehur se në kushtet kur ndodhemi para një dispozite të re, e cila, siç rezulton edhe nga kërkesa në shqyrtim, paraqet probleme të interpretimit dhe zbatimit të saj, është detyrë dhe kompetencë e Gjykatës së Lartë, që në përputhje me funksionin e saj njësues të investohet për interpretimin e kësaj dispozite, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme.

i. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

1. Zbatimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, a e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohe vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor (tërësisht apo pjesërisht)?

60. Mbi kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, GJEDNJ-ja, në mënyrë të përsëritur është shprehur se dënimi i një të pandehuri në gjykimin në shkallë të dytë, kur ky i fundit ka marrë pafajësinë në shkallë të parë, nuk mund të bëhet pa u respektuar nga ana e gjykatës së apelit parimi i pandërmjetësisë në marrjen e provave të nevojshme për një vlerësim objektiv³¹.

61. Normimi procedural i paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së, në reflektim të frymës së jurisprudencës së GJEDNJ-së, u referohet parimeve të përgjithshme mbi të cilat funksionon gjykimi penal në të dy shkallët e gjykimit, në shkallë të parë dhe në apel, natyrën e gjykimit në fakt ku përfshihet dhe gjykimi në apel, dhe mundësinë që gjykata të ketë hapësirën e nevojshme për vlerësim objektiv e me paanësi, në bazë të bindjes së saj të brendshme të të gjitha pretendimeve e provave të nevojshme. *Ratio legis* e normës është ajo që procesi i ankimit shihet nga ligjvënësi si një natyrë “kontrolluese”, duke kuptuar plotësimin e marrjes së provave gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe garanci për vendimin e pafajësisë së dhënë gjatë gjykimit në këtë shkallë.

62. Gjykimi në shkallë të dytë, në dallim nga gjykimi në shkallë të parë, kryesisht zhvillohet mbi ato akte që janë administruar dhe i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë. Ky gjykim ka për qëllim të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prandaj si rregull ai kontrollon mënyrën se si janë vlerësuar provat dhe se si është interpretuar e zbatuar ligji në shkallë të parë. Gjykimi në apel ka një funksion kontrollues mbi vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke shqyrtuar pretendimet e ankuesve mbi gabimet në fakt apo në ligj, në lidhje me vendimin e apeluar.

63. Rregullat procedurale që ndiqen në shkallë të parë, janë të zbatueshme në apel, për aq sa ato mund të përputhen me natyrën e gjykimit në apel, objekt shqyrtimi i së cilës është vendimi i apeluar. Në këtë vështrim, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel shfaqet si një përjashtim, i lidhur me rastet kur gjyqtari në apel vlerëson se hetimi gjyqësor në shkallë të parë ka të meta që lidhen me procesin e të provuarit. Gjatë gjykimit në apel, gjykata mund të marrë prova të reja ose t’ia nënshtrorë debatit gjyqësor provat e marra në gjykimin në shkallë të parë, duke përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke riçelur pjesërisht ose plotësisht shqyrtimin gjyqësor në shkallë të dytë. Vetë dispozita që parashikon këtë rregull titullohet “*Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor*” dhe ka si qëllim të normojë mënyrën sesi mund të përsëritet shqyrtimi gjyqësor gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

64. Dispozita përkatëse e cila parashikon përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel është neni 427 i KPP-së, ndërsa ajo që lidhet specifikisht me detyrimin për përsëritjen e këtij shqyrtimi në rast se i pandehuri është deklaruar i pafajshëm në gjykimin në shkallë të parë është pika 4 e tij, ndryshuar në vitin 2017.

65. Kolegji evidenton faktin se, neni 427 i KPP-së është dispozita analoge e nenit 603 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë (në vijim “KPPI”). Neni 603 i KPPI-së, përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017 (*realizuar me ligjin nr. 103/2017, duke u shtruar paragrafi 3-bis*),³²

³⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 15.1.2021.

³¹ Vendimet e GJEDNJ-së *Ekebatani kundër Suedisë*, 26 maj 1988, paragrafi 32, *Costantinescu kundër Rumanisë*, nr. 28871/95, paragrafi 55, 27 qershor 2000, *Dondarini kundër San-Marinos*, nr. 50545/99, paragrafi 27.

³² Neni 603, KPP italian (ligji nr. 447, datë 22.9.1988 (*azhurnuar më datë 17.7.2024*), përsëritje e shqyrtimit gjyqësor “3-bis. Në rastin e ankimit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë për arsye që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave deklarative, gjyqtari pa cenuar dispozitat e paragrafëve 1 deri në 3, urdhëron përsëritjen e seancës vetëm në

parashikonte përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në tre situata: a) kur një palë kërkonte rimarrjen e provave të administruara në gjykimin në shkallë të parë ose marrjen e provave të reja dhe kjo gjë çmohej e nevojshme; b) kur një gjë e tillë vendosej kryesisht nga ana e gjykatës; c) kur i pandehuri është gjykuar në mungesë në shkallë të parë për shkak se nuk ka pasur dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet dhe kjo të kishte ndodhur jo për faj të tij. Pas ndryshimeve që pësoi dispozita me ligjin nr. 103/2017, ky paragraf parashikon se: “*Në rastin e apelimit të bërë nga ana e prokurorit kundër vendimit të pafajësisë për motive që lidhen me vlerësimin e provave deklarative, gjyqtari vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor*”. Ky ndryshim i nenit 603 të KPP-së italian, duke shtuar paragrafin 3-bis, u diktua si pasojë e zhvillimeve në jurisprudencën e GJEDNJ-së. KPP-ja e Republikës së Shqipërisë, ndjek të njëjtin model me atë të KPP-së italian, e megjithatë konstatohet se përmbajtja e nenit 427/4 të KPP-së nuk ndoqi të njëjtin model me dispozitën analoge, duke mos përfshirë në mënyrë të shprehur se nevoja e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor lidhet me vlerësimin e provave deklarative. Por qëllimi i normës sonë është i njëjtë me atë të legjislacionit procedural burimor, pasi është bërë mbi të njëjtat arsye, pikërisht si rezultat i detyrimit të shtetit shqiptar, për të përshtatur legjislacionin e brendshëm me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja. Prandaj dhe në këtë rast të interpretimit të kësaj norme, ajo duhet bërë dhe mbi metodën e interpretimit krahasues, me qëllim nxjerrjen e qëllimit e kuptimit të saj.

66. Pika 4 e nenit 427 të KPP-së është bërë objekt kontrolli kushtetues, përmes kontrollit incidental, për shkak të paqartësisë mbi mënyrën e zbatimit të kësaj norme procedurale në mënyrë pajtuese me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Me *vendimin nr. 6, datë 15.1.2021*, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesën, për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të pikës 4, të nenit 427, të KPP-së, ku, ndër të tjera, gjykata referuese ka argumentuar se *cenohet parimi i paanshmërisë së gjykatës pasi përmbajtja e kësaj dispozite ligjore detyron gjykatën të dalë tej kufijve të shqyrtimit gjyqësor që përcaktohen në shkaqet e ankimit të palëve, pasi gjykata e apelit sa herë që i pandehuri është deklaruar i pafajshëm duhet që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, edhe nëse do të bindet se vendimi i ankimit është i gabuar për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material. Qoftë kur çështja është gjykuar sipas rritit të gjykimit të zakonshëm ose atij të shkurtuar, pavarësisht se bindja e gjykatës së apelit për zgjidhje të gabuar të çështjes nga gjykata më e ulët mund të krijohet e plotë mbi po të njëjtat kritere, rrethana dhe prova, ajo është e detyruar ta përsërisë hetimin gjyqësor*.

67. Gjikata Kushtetuese, ndër të tjera, ka vlerësuar se:³³ “*Në këtë vështrim, nga përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar rezulton se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP-së në lidhje me llojin e vendimmarrjes. Nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP-së, gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuptim, gjykata referuese nuk ka arsyetuar se në çfarë mënyre cenohen parimet kushtetuese, si ai i pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës ose i barazisë para ligjit. Gjithashtu, ajo nuk ka arritur të argumentojë se nga zbatimi i dispozitës së kundërshtuar të pandehurit i mohohen ose cenohen të drejtat që i garantohen atij në procesin penal përfshirë edhe mosrëndimin e pozitës së të pandehurit, si edhe garancitë që i ofrohen nga gjykimi i shkurtuar*”.

68. Nisur nga ky interpretim i bërë nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji në praktikën e tij gjyqësore, lidhur me mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite, në vendimin nr. 00-2021-898, datë

rastet e provave deklarative të marra në seancë gjatë gjykimit të shkallës së parë ose pas përfshirjes së provave të vendosura në procedurë të shkurtuar në bazë të neneve 438, paragrafi 5, dhe 441, paragrafi 5(6).”

³³ Vendimi nr. 6, datë 15.1.2021 dhe vendimi nr. 29, datë 12.2.2021 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

25.11.2021, ka vlerësuar se fjalja e fundit e pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, *nuk detyron gjykatën e apelit që në çdo rast të apelimt nga ana e prokurorit të vendimit të pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të shqyrtojë apelin dhe të disponojë me vendim mbi të. Riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste mbetet sërish kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit.*

69. Kolegji është mbështetur kryesisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe asaj Kushtetuese. Kolegji ka theksuar se rol ka edhe natyra e provave të administruara në funksion të provueshmërisë së pafajësisë së të pandehurit. Kështu mund të ketë raste që procesi gjyqësor të jetë zhvilluar vetëm me material provues shkresor. Në këto raste nuk ka kuptim dhe asnjë dobi juridike për asnjë nga palët dhe për gjykatën që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se mund të ketë raste në të cilat vendimi i pafajësisë është bazuar në prova me dëshmitarë dhe se dëshmitarët mund të kenë ndërruar jetë apo nuk gjenden në gjykimin në apel. Në këto raste kuptohet se është e pamundur objektivisht të përsëritet shqyrtimi gjyqësor për të shqyrtuar apelin e prokurorit, kundër vendimit të pafajësisë së gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu mund të ketë raste kur pyetja e një dëshmitari në gjykimin në apel mund të çojë në cenimin potencial të së drejtës së tij kushtetuese dhe konventore për t'u mos vetinkriminuar. Në këto raste sërish përsëritja e shqyrtimit gjyqësor mund të rezultojë kushtetutshmërisht dhe ligjërish të pamundur për t'u realizuar efektivisht në gjykimin në apel.

70. Kolegji ka çmuar se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t'u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave të gjalla. Kjo do të thotë se kjo mënyrë e të proceduarit në gjykimin rishikues në apel do të jetë e nevojshme që të realizohet vetëm kur fajësia e autorit dhe ekzistenca e faktit penal provohet apo nuk provohet në fashikullin e gjykimit nga materiali provues që ka natyrën e provës së gjallë, konkretisht për dëshminë, deklaratimet e bashkëtepandehurve, ballafaqimet, pyetjet apo ripyetjet e drejtpërdrejta të ekspertit (*vendimi i KPGJL nr. 00-2021-404 (2) datë 19.3.2021*).

71. Në vendimin nr. 00-2023-2007 (331), datë 5.12.2023, Kolegji risjell në vëmendje se shqyrtimi gjyqësor varet nga natyra e provës që kërkohet të merret, kështu Kolegji çmon se, vlerësimi i kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e apelit, në rast të deklaratimit të pafajshëm të të pandehurit gjatë gjykimit në shkallë të parë, duhet bërë nisur nga kriteri se cila provë nga ato që parashikon KPP-ja është e nevojshme të merret gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, që nuk është marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë e që duke u vlerësuar me të tjerat ndryshon vlerësimin ndaj të provuarit të akuzës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke respektuar pozitën procedurale të të pandehurit.

72. Në vendimin nr. 00-2023-173 (285), datë 31.10.2023, Kolegji ka vlerësuar se paragrafi i katërt i nenit 427 i KPP-së, pavarësisht mënyrës së formulimit, kujdesit të pakët të treguar në këtë rast prej legjislatorit në funksion të evidentimit të thelbit të saj, shkakut konkret të rinovimit të detyrueshëm të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, të identifikuar në marrjen e provës së karakterit deklarativ dhe jo të të gjitha llojeve të provave, nën dritën e konkluzioneve të GJEDNJ-së, ka vlerësuar se *“rinovimi”* i shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Gjykatën e Apelit, në funksion të rimarrjes së provave të karakterit deklarues, sipas përcaktimit të paragrafit të katërt të nenit 427 të KPP-së, mbi bazën e të cilave është vendosur nga gjykata e shkallës së parë pafajësia e të pandehurit konsiderohet absolutisht i domosdoshëm, pavarësisht faktit që deklarimi i pafajësisë, sikurse në rastin konkret është realizuar nga gjykata e shkallës së parë në përfundim të gjykimit të zhvilluar me ritin procedural të *“gjykimit të shkurtuar”*.

73. Ndërsa në vendimin nr. 00-2022-657, datë 21.6.2022, Kolegji ka vlerësuar se, Gjykata e Apelit në rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke marrë prova të reja e duke dëgjuar dhe dëshmitarë, e se nuk mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke realizuar një vlerësim formal të ndryshëm të provave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm me shkakun e vendosjes së përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, pa rivlerësuar një provë duke e rimarrë atë apo me mungesën e pranimit të një prove të re. Qëndrim i ngjashëm mbahet edhe në

vendimin nr. 00-2023-1078 (191), datë 30.6.2023, ku Kolegji ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk mund të deklarojë fajtor të pandehurin e deklaruar si të pafajshëm nga gjykata penale e juridiksionit fillestar mbi bazën e të njëjtave fakte dhe prova, duke garantuar në këtë rast respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.

74. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali në çështjen *Dasgupta*³⁴ arsyetojnë se perceptimi i drejtpërdrejtë i provës është një parakusht në thelb i argumentimit e një vlerësimi logjik, racional e të plotë. Prezumimi i pafajësisë dhe dyshimi i arsyeshëm imponojnë vlerësim të provave sipas llojit të tyre në funksion të vendimit përfundimtar për të sanksionuar një vendim dënimi të sigurt ose rënien e dyshimit të arsyeshëm me pasojë lirim nga akuza. Pasojat janë të ngjashme në rastin e detyrimit për arsyetim, i cili në rastin e ndryshimit të vendimit të pafajësisë zbatohet ndryshe. Gjyqtari i apelit është i detyruar të argumentojë për besueshmërinë e vlerësimit të ndryshëm, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, për shkak të të metave logjike apo paaftësisë provuese që kanë zhvlehtësuar qëndrueshmërinë e përhershme të vendimit të parë, për rrëzimin e dënimit duke e rikonstruktuar në mënyrë alternative faktin e provuar, mbi bazën e një vlerësimi thelbësor. Për më tepër këto duhet të jenë argumentime që nuk janë vetëm abstrakte në *rerum natura*, por besueshmëria e të cilave në rastin konkret është e fokusuar në gjetjet procedurale të marra në konsistencën e tyre objektive. Prandaj është e nevojshme që dyshimi i arsyeshëm t'i përgjigjet jo vetëm kriterëve me racionalitet të brendshëm, por të jetë në gjendje të argumentohet me arsye të verifikueshme në të njëjtën mënyrë si materiali provues i marrë në gjykim.³⁵

75. Sipas dispozitave tona procedurale, roli i gjykatës së apelit është ai kontrollues në raport me vendimmarrjen e gjykatave të shkallës së parë dhe ky kontroll lidhet si me zbatimin e drejtë të normave procedurale, në lidhje me respektimin e garancive procedurale, me hetimin gjyqësor, me mënyrën e administrimit dhe vlerësimit të provave, ashtu edhe me zbatimin e drejtë të ligjit material, në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të procedimit penal, fajësinë e të pandehurit, si dhe cilësimin juridik të veprës penale, apo pafajësinë e tij, gjithnjë bazuar në analizën e provave të marra dhe administruara në gjykim. Ky shqyrtim duhet të bazohet brenda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP-së. Gjykimi në apel ruan tiparet e gjykimit në fakt e të shqyrtimit në themel të pretendimeve të palëve duke u mbështetur në materialin procedural e provues të marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë.

76. Vetë neni 427 i KPP-së, është titulluar “Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor” dhe parashikon “rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë” “marrjen e provave të reja”, “përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor”, të drejtën e disponimit të gjykatës “provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty”. Nga përmbajtja e këtyre termave në raport me këtë dispozitë rezulton se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor mund të bëhet: (i) me “rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë”; (ii) me “marrjen e provave të reja”; (iii) me ndalimin e Gjykatës së Apelit për deklarimin fajtor të të pandehurit vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor; (iv) me të drejtën e disponimit të gjykatës për “provat që zbulohen pas gjykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty”.

77. Nga analiza e këtyre termave rezulton se ligjvënësi nuk bën fjalë për “përsëritje tërësisht të shqyrtimit gjyqësor” dhe aq më tepër për një detyrim të tillë ndaj gjykatës. Vetë parashikimi i rimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë, marrja e provave të reja, do të thotë se shqyrtimi gjyqësor mund të përsëritet pjesërisht ose në mënyrë të plotë. Përsëritja e hetimit gjyqësor në mënyrë të plotë do të thotë hetim gjyqësor nga e para. Kjo dispozitë nuk e përjashton dhe as nuk e ndalon përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Përkundrazi vetë parashikimi i rishqyrtimit të provave të marra në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së

³⁴ Vendimi i Gjykatës së Kasacionit në Itali mbi çështjen *Dasgupta*, seksioni 5, nr. 42443 i 7 qershorit 2016.

³⁵ Vendimi i Gjykatës së Kasacionit, Seksionet e Bashkuara Penale, 21 dhjetor 2017, nr. 14800.

parë, marrja e provave të reja, apo atyre që kanë dalë pas shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, në thelb në vetvete është formë e përsëritjes së pjesshme të shqyrtimit gjyqësor.

78. Në nenin 427/1 të KPP-së bëhet fjalë për rastin kur njëra palë kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë. Pra nuk bëhet fjalë për rimarrjen e të gjitha provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë e nuk ndodhemi përpara një detyrimi për të rimarrë të gjitha provat që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë. Rimarrja e disa provave që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë nuk e cenon hetimin gjyqësor, dhe as nuk është veprim në kundërshtim me këtë dispozitë për aq kohë që kjo dispozitë nuk shprehet në mënyrë taksative për të gjitha provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se, nëse ankuesi kundër vendimit të një gjykate më të ulët në një gjykatë më të lartë, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata mund të vendosë sipas diskrecionit të vet në qoftë se çmon se në gjendjen që janë provat çështja nuk mund të zgjidhet.

79. Ndryshe është rasti i shkronjës “ç” të nenit 425 të KPP-së, parashikim ligjor ky i cili detyron gjykatën e apelit, që në rast kualifikimi ndryshe dhe më të rëndë të veprës penale, të riçelë shqyrtimin gjyqësor dhe të zbatojë procedurën e posaçme të parashikuar në nenin 375 të KPP-së. Përmbajtja e dispozitës rezulton se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP-së, në lidhje me llojin e vendimmarrjes.

80. Nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP-së, gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Deklarimi i fajësisë së të pandehurit apo individualizimi i veprave dhe dënimeve penale janë në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, gjatë shqyrtimit të çështjes cakton llojin dhe masën e dënimit.

81. Kolegji vlerëson se të njëjtin standard që ka përdorur Gjykata Kushtetuese³⁶, për interpretimin e përputhshmërisë kushtetuese të normës, kur ka arsyetuar se *nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP-së, gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor*, duhet të përdorin edhe gjykatat e zakonshme kur bëjnë interpretimin gjyqësor të përmbajtjes së dispozitës, kur diskutohet për detyrimin apo jo që gjykata e apelit ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor apriori nëse kërkohet, e nëse ky shqyrtim duhet të jetë i plotë apo i pjesshëm.

82. Kolegji vlerëson se në kontekst të interpretimit të paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së, duhet të përdorim të njëjtën logjikë, se qëllimi i fjalisë së fundit të pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, nuk ka qenë që ta detyrojë gjykatën e apelit që në çdo rast të apelimin nga ana e prokurorit të vendimit të pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të shqyrtojë apelin dhe të disponojë me vendim mbi të. Edhe duke mbajtur parasysh mundësinë e vendimmarrjes së gjykatës së apelit në gjykimin e zakonshëm, në atë që parashikon neni 428 i KPP-së, konkludohet se vendimmarrjet e gjykatës së apelit në procesin penal, janë të tilla që përjashtojnë apriori përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në çdo rast. Në këtë kuptim vlerësohet dhe arrihet në konkluzionin se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste mbetet sërish kompetencë diskrecionale

³⁶ Vendimi nr. 6, datë 15.1.2021, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

e gjykatës së apelit, edhe sipas rregullimit të ri, pas ndryshimit të nenit 427 të KPP-së, në vitin 2017.

83. Kolegji vlerëson se, pika 4 e nenit 427 të KPP-së, nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të zbatohet në atë mënyrë që të konkludohet se në çdo rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë në gjykimin në apel do të duhet të realizohet detyrimisht një përsëritje e plotë e shqyrtimit gjyqësor. Masa e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor rast pas rasti do të duhet të vlerësohet nga ana e gjykatës rishikuese të faktit që është gjykata e apelit. Mund të ketë raste kur ndryshimi i vendimit të pafajësisë vjen jo si pasojë e faktit apo të provave në fashikullin e gjykimit të formësuar në shkallë të parë, por për shkaqe ekskluzivisht ligjore dhe çështje të interpretimit ligjor të instituteve të ndryshme penale, materiale dhe procedurale. Në këto raste nuk është e nevojshme që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor për të përcaktuar ekzistencën apo jo të faktit penal. Mund të ketë raste që procesi gjyqësor të jetë zhvilluar vetëm me material provues shkresor, apo thënë ndryshe të vetmet materiale provuese të përdorura në gjykim për të provuar ekzistencën e faktit dhe fajësinë e autorit të jenë provat e ngrira dhe dokumentare. Në këto raste nuk ka nevojë për asnjë nga palët dhe për gjykatën që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së.

84. Kolegji sjell në vëmendje se nuk do të ketë nevojë që të zbatohet pika 4 e nenit 427 të KPP-së atëherë kur dëshmitari që prokuroria kërkon të dëgjohet dhe të administrohet si provë nuk vlerësohet nga gjykata se ka rëndësi në përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit. Kjo do të thotë se nëse dëshmitari ka dhënë dëshmi indirekte, ka dhënë në dëshmi vlerësimet subjektive të tij, opinione apo edhe kur të dhënat nga dëshmia rrëzohen nga provat e tjera të administruara në fashikullin e gjykimit apo të hetimit, atëherë nuk ka arsye që gjykata e apelit të zbatojë detyrimisht pikën 4 të nenit 427 të KPP-së. Marrja e kësaj prove në gjykimin në apel në këto raste nuk do të kishte rëndësi mbi faktet e çështjes dhe mbi rrethanat tashmë të provuara në gjykim. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se, pika 4 e nenit 427 të KPP-së nuk do të zbatohet në rastet kur dëshmia apo prova e re nuk ka rëndësi provuese në faktet dhe rrethanat e çështjes dhe kur vlerësohet nga gjykata se nuk është e rëndësishme në raport me provat e tjera të administruara.

85. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë. Në çdo rast gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke specifikuar provën konkrete që kërkohet të merret nga gjykata e apelit dhe të verifikohet në debat gjyqësor.

86. Kriteri i marrjes së vendimit duhet të interpretohet në kuptimin që prova e kërkuar për t'u marrë ose që duhet të merret të jetë vendimtare, e do të konsiderohet e tillë kur ka të bëjë me një element i cili, në bazë të vendimit të shkallës së parë, ka përcaktuar ose madje ka kontribuar vetëm në përcaktimin e një rezultati i cili, nëse hiqet nga tërësia e materialit provues, mund të dalë potencialisht i aftë për të ndikuar në rezultatin e vendimit të ankimuar. Provat vendimtare verbale përbëjnë gjithashtu prova që megjithëse gjykohen nga gjyqtari i shkallës së parë me pak ose aspak vlerë, të jenë të rëndësishme për ankuesin, vetëm ose bashkë me prova të tjera, që ndikojnë në vendimmarrje.

87. Gjykata e apelit në marrjen e vendimit të ndërmjetëm për përsëritjen e shqyrtimit vlerëson këtë kërkim si pjesë e apelimit dhe argumenton nëse plotësohen kushtet për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duke u nisur nga shqyrtimi i pretendimit për vlerësim të gabuar të provës/provave dhe nëse kjo është e rëndësishme e vendimtare për disponimin përfundimtar të kësaj gjykatë. Ndryshimi i vendimit të pafajësisë bëhet vetëm mbi bazën e një arsytimi të qartë, të plotë që shpjegon në mënyrë specifike paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishme të vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Kjo kalon përmes një verifikimi të thellë analizues e kritik në kohë dhe që rezulton në një arsytim të ndryshëm, të plotë dhe më bindës, i cili, duke u mbivendosur në përgjithësi me arsyet e vendimit të shkallës së parë,

bazohet në rezultatet e ndryshme të arritura dhe vlerën më të madhe ose të ndryshme që i jepet secilit element prove që është pjesë e procesit të të provuarit.

88. Detyrimi i gjyqtarit të apelit për të proceduar qoftë edhe kryesisht, me rimarrjen e provave bëhet kur është e nevojshme një vlerësim i ndryshëm i besueshmërisë së një prove që konsiderohet e rëndësishme dhe përcaktuese për qëllimin e vendimit të ndryshëm nga ai i pafajësisë. Fizionomia e provës vendimtare i referohet idesë se vendimi i gjyqtarit të apelit të bazohet në një vlerësim të ndryshëm të provës që ka nevojë të dëgjohet, në mënyrë verbale e të drejtpërdrejtë në gjykim, merret drejtpërdrejt, të diskutohet, të kundërshtohet, kjo edhe në mundësinë që kjo provë e marrë në këtë mënyrë të konfirmojë dhe pafajësinë. Kjo nënkupton atë që GJEDNJ-ja vë në dukje³⁷ se qëllimi i rivlerësimit të provave në raport me provën vendimtare të rivlerësuar është një mekanizëm i mundshëm kompensues me garanci të tjera procedurale të përshtatshme, të garantuar në çdo rast nga gjykimi i drejtë. Po në këtë çështje, GJEDNJ-ja ka përdorur konceptin e provës vendimtare në kuptimin e nevojës për t'u dëgjuar. Në përmbajtje të nenit 427 të KPP-së, nuk përmendet lloji i provave, e ligji ynë nuk bën diferencë mes natyrës së provave. Në këtë kontekst interpretimi, duhet bërë dallimi me natyrën e ndryshme të një kategorie provash që emërtohen si prova të gjalla apo deklarative, natyrë që lidhet me fizionominë e drejtpërdrejtë të provës si e tillë ose me karakterin deklarativ të saj që vjen nga një burim tjetër i provës. Këtu mund të citojmë dallimin që praktika gjyqësore italiane ka bërë në çështjen *Dasgupta*,³⁸ në konceptin e provës deklarative në mes të dëshmitarit dhe ekspertit apo konsulentit teknik. Natyra e deklaratave të ekspertëve dhe konsulentëve teknik do t'i bënte ato të ngjashme me burimin e dëshmisë dhe rrjedhimisht me konceptin e provës deklarative.

89. Në gjykimin e çështjes prej gjykatës së apelit, kjo e fundit që mban përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve, duhet që të jetë në gjendje të dëgjojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarët në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së tyre, për sa kohë që ky vlerësim përbën një detyrim kompleks, i cili normalisht nuk mund të konsiderohet i realizuar me një lexim të thjeshtë të deklaratimeve të tyre.

90. Sa i përket masës së përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, nga sa më lart u arsyetua, arrihet në konkluzionin se në parim riçelja e shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së, është një përsëritje e pjesshme në raport me provën që duhet marrë. Është e pjesshme normalisht, sepse nevoja për përsëritje dhe rimarrje të provave lidhet ekskluzivisht vetëm me ato prova të cilat janë vendimtare për ndryshimin e vlerësimit dhe që janë formësuar në gjykim si të tilla, natyra e të cilave do të trajtohet më poshtë në pikat e tjera të këtij vendimi. Por gjykata e Apelit nuk ka pengesë ligjore që të bëjë një përsëritje tërësore të shqyrtimit gjyqësor nëse e vlerëson të nevojshme se për arritjen e një vendimi ndryshe nga shkalla e parë, shqyrtimi gjyqësor duhet përsëritur në tërësi.

91. Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, referuar interpretimit sistematik dhe teleologjik të nenit 427/4 të KPP-së, e qëllimit të krijimit të kësaj norme, me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja, si dhe jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit të Italisë dhe përmbajtjes homologe të dispozitës, neni 603 (3) të KPP-së italian në interpretim krahasues, Kolegji arrin në konkluzionin se ankimi ndaj vendimit të pafajësisë, sipas nenit 427/4 të KPP-së nuk ngarkon gjykatën e apelit me detyrimin absolut të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor sa herë paraqitet ankimi nga prokuroria ndaj vendimit të pafajësisë ose në çdo rast kur kërkohet përsëritja në ankimin e prokurorit. Është në vlerësimin e gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP-së, në lidhje me llojin e vendimarrjes.

³⁷ GJEDNJ, *Dan kundër Moldavisë*, seksioni III, 5 korrik 2011.

³⁸ Vendimi nr. 27620 datë 28.4.2016 i Gjykatës së Kasacionit në Itali, vendim mbi çështjen *Dasgupta*.

Gjykata e apelit nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

92. Nisur dhe nga interpretimi që jurisprudenca kushtetuese i ka bërë kufijve të pavarësisë së gjykatës në gjykimin në apel, riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste është kompetencë diskrecionare e gjykatës së apelit, e cila përsërit shqyrtimin gjyqësor në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave. Rrjedhimisht, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është e pjesshme në raport me nevojën e marrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë të provave nga gjykata e apelit, dhe që duhet të verifikohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

93. Si konkluzion logjik i arsyetimit të mësipërm, Kolegji arrin në përfundimin se parashikimi i nenit 427, pika 4, i KPP-së, nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, vetëm nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke u specifikuar prova konkrete e kërkuar, marrja e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit, verifikimi i saj në debat gjyqësor e kontradiktoritet, e nëse argumenton se kjo provë është vendimtare në vlerësimin në raport me provat e tjera.

94. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, **në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Parashikimi i nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë.

ii. Në lidhje me nënçështjen e pyetjes së parë të shtruar për njësim:

1.1 Vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, a kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori ?

95. Në nenin 425/1 të KPP-së, i ndryshuar, nën titullin “Kufijtë e shqyrtimit të çështjes”, parashikohet se “1. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëpandehurve që nuk kanë bërë apel”. Në nenin 427 të KPP-së, i ndryshuar, nën titullin “Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, në pikat 1 dhe 3 parashikohet: “1. Kur një palë në aktin e apelit, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor. 3. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme...”

96. Apeli është një mjet i zakonshëm ankimi përmes të cilit, gjykata e apelit si një gjykatë ligji dhe fakti, shqyrton vendimin e gjykatës së shkallës së parë, brenda shkaqeve të parashtruara nga palët në ankim. Gjykata e apelit është konceptuar si një instancë kontrolluese dhe rishikuese të vendimarrjeve të shkallës së parë, brenda shkaqeve që kanë aktivizuar juridiksionin e saj rishikues, me përjashtim të rastit kur gjykata e apelit shfaq autoritetin e saj si gjykatë ligji duke u aktivizuar *ex officio* për çështje të ligjit (të tilla si pavlefshmëria/papërdorshmëria e provave).

97. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, karakterizohen nga zbatimi i parimit “*tantum devolutum quantum appellatum*”, duke u kuptuar se *në rishikim disponohet për atë që kërkohej*. Kjo do të thotë se brenda funksionit natyral të saj, gjykata e apelit si gjykatë ligji dhe fakti, shqyrton apelin e paraqitur në respektim të shkaqeve të ngritura në ankim. Apeluesi duhet të ketë evidentuar qartë në apelin e tij shkaqet për të cilat po kundërshtohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Ky parim nuk vepron në ato raste kur ligji ka garantuar rolin aktiv të gjykatës së apelit, në drejtim të sigurimit të procesit të rregullt ligjor, kur ajo duhet të aktivizohet kryesisht si një gjykatë ligji rishikuese e nivelit të dytë.

98. Në përputhje me parashikimet ligjore për kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes pranë gjykatës së apelit (neni 425/1 i KPP-së), për të parashtruar një kërkim për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, ky kërkim duhet evidentuar në aktin e apelit. Sipas pikës 1 të nenit 427 të KPP-së, ligjvënësi ka parashikuar se kur në aktin e apelit është kërkuar marrja e provave të reja ose rimarrja e provave të lejuara në shkallë të marrë, gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor nëse vlerëson se në gjendjen që janë aktet nuk mund të vijojë shqyrtimi në themel i shkaqeve të ankimit. Sipas pikës 3, të nenit 427 të KPP-së, është sanksionuar detyrimi i gjykatës së apelit për të disponuar kryesisht për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur ajo e çmon të domosdoshme. Kjo do të thotë se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor sipas pikës 1 të nenit 427 të KPP-së duhet të jetë pjesë e shkaqeve të ankimit të prokurorit, por gjykata e apelit brenda tagrave të dhëna në ligj, nuk është e kushtëzuar nga apeli i prokurorit në lidhje me vendimarrjen për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, sa herë që ajo e çmon të domosdoshme riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, për të shqyrtuar themeltësinë e shkaqeve të ankimit dhe çmuarjes së çështjeve ligjore që vihen në diskutim kryesisht pranë saj. Qëllimi i ndryshimit të bërë me ligjin nr. 41 datë 23.3.2021,³⁹ në paragrafin e parë të këtij neni me heqjen e togfjalëshit “ose plotësimin e tij”, ka qenë pikërisht vënia e theksit se kërkesa për përsëritjen shqyrtimit gjyqësor duke rimarrë provat e lejuara në gjykimin në shkallë të parë ose duke rimarrë prova të reja, duhet bërë në aktin e ankimit duke i dhënë rëndësi pikërisht këtij momenti e këtij akti të rëndësishëm të ushtrimit të së drejtës për t’u ankuar.

99. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP-së parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve. Palët e kanë të drejtën për të parashtruar një kërkim për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e ky kërkim duhet evidentuar në aktin e apelit. Ndryshe nga pikat 1 dhe 3 të nenit 427 të KPP-së, ku parashikohet si rregulli po ashtu edhe përjashtimi, në interpretimin e paragrafit 4 të nenit 427, KPP, çështja e diskutueshme është ajo nëse përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur apelohe vendimi i pafajësisë, duhet apo jo të kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori.

100. Qëndrimi i Kolegjit Penal për këtë çështje të së drejtës ka qenë konstant. Në vendimin nr. 00-2022-657, datë 21.60.2022, Kolegji ka vlerësuar: “97. Si rregull prokurori duhet të ankimojë vendimin e ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar së bashku me vendimin përfundimtar, pasi në shqyrtimin e ankimit gjykatat e apelit duhet t’u përmbahen atyre të paraqitura në ankimin e prokurorit, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë kufizimeve ligjore të parashikuara për procedurën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë të gjykimit. Mbi bazën e interpretimit sistematik të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 427 të KPP-së, si dhe nenit 426/a paragrafi i gjashtë i KPP-së, rezulton se në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendimi pafajësie, nuk mund të kërkohe fajësia e të pandehurit, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimin në shkallë të parë, dhe se për të provuar fajësinë duhet të kërkohe nga pala ankimuese, jo në seancë gjyqësore, por në kërkesën ankimore apo plotësimin e saj, sipas nenit 415/2 të KPP-së, marrja e provave të reja apo rimarrja e provave të shqyrtuara në shkallën e parë të gjykimin. 98. Në mënyrë përjashtimore ligjvënësi në paragrafin e tretë të nenit 427 të KPP-së, ka lejuar mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe kryesisht nga gjykata e apelit, pa kërkesë të palëve. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP-së, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm, si dhe në kundërshtim me rregullat procedurale të zbatueshme për gjykimin e shkurtuar”.

101. I njëjti qëndrim mbahet edhe në vendimin nr. 00-2023-1078, datë 30.6.2023 të Kolegjit, ku ndër të tjera është vlerësuar se “Në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes penale në shkallën e dytë të gjykimin, në nenin 427/1 të KPP-së, është përcaktuar më konkretisht: ‘Kur një palë në aktin e apelit ose plotësimin e tij, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin

³⁹ Ligji nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 14 maj 2021.

gjyqësor. Mungesa e kërkimeve në lidhje me përsëritjen e betimit gjyqësor, në formën e rimarrjes së provave ose marrjes së provave të reja, përbën një të metë të pariparueshme as në seancë gjyqësore, me pasojë rënien e tyre në dekadencë, sipas nenit 426/a, paragrafi i gjashtë i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin përcaktohet shprehimisht se palët nuk mund të parashtojnë në seancë shkaqe tej atyre të ngritura në ankim. Si rregull prokurori duhet të ankimojë vendimin e ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar së bashku me vendimin përfundimtar pasi në shqyrtimin e ankimit gjykatat e apelit duhet t'u përmbahen atyre të paraqitura në ankimin e prokurorit, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë kufizimeve ligjore të parashikuara për procedurën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë të gjykimit. Mbi bazën e interpretimit sistematik të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 427 të KPP-së, si dhe nenit 426/a paragrafi i gjashtë i KPP-së rezulton se në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendim pafajësie, nuk mund të kërkohet fajësia e të pandehurit, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, dhe se për të provuar fajësinë duhet të kërkohet nga pala ankimuese, jo në seancë gjyqësore, por në kërkesën ankimore apo plotësimin e saj, sipas nenit 415/2 të KPP-së, marrja e provave të reja apo rimarrja e provave të shqyrtuara në shkallën e parë të gjykimit. Në mënyrë përjashtimore ligjvënësi në paragrafin e tretë të nenit 427 të KPP-së, ka lejuar mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe kryesisht nga gjykata e apelit, pa kërkesë të palëve. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP-së, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm, si dhe në kundërshtim me rregullat procedurale të zbatueshme për gjykimin e shkurtuar.”

102. Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, në vijim edhe të qëndrimeve të mëparshme, Kolegji vlerëson se paragrafi 3 i nenit 427 të KPP-së, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm. Në ndryshim nga paragrafët e mësipërm, Kolegji vlerëson se paragrafi 4 i nenit 427 nuk mund të interpretohet i lidhur me paragrafin 3 të nenit 427, pasi paragrafi 4 ndryshe nga paragrafët 1 dhe 3, parashikon rastin kur apelohej vendimi i pafajësisë. Në këtë rast, Kolegji vlerëson se, vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor do të kushtëzohet nga kërkimi i prokurorit në apel/ankim për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, por nëse gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, përveç atyre të kërkuara nga ana e prokurorit në ankim, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues.

103. Prokuroria në aktin e ankimit duhet t'u përmbahet rregullimeve të neneve 407/3, 408, 413 dhe 422 të KPP-së. Shqyrtimi i ankimit në apel kushtëzohet nga garancia e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit⁴⁰, por me mundësinë që gjykata e apelit të shqyrtojë ankimin edhe mbi motive të tjera, të cilat ngrihen kryesisht nga gjykata⁴¹ ose nga palët por që mund të prekin edhe palët e tjera kur nuk lidhen me motive ngushtësisht personale⁴². Kjo në funksion të garantimit të pozitës së të pandehurit e së drejtës për t'u mbrojtur e paraqitur prova në gjykimin në shkallë të dytë.

104. Nisur nga procedura e gjykimit të çështjes në shkallë të parë, këtu duhen evidentuar dy situata procedurale: (i) Së pari, situata kur, gjykimi në shkallë të parë është bërë me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar, në përfundim të të cilit i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. (ii) Së dyti, situata kur, gjykimi në shkallë të parë është bërë me procedurën e gjykimit të zakonshëm, në përfundim të të cilit i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. Kolegji vlerëson se,

⁴⁰ Neni 425/3 i KPP-së “Kur apelohej është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatohet masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë”.

⁴¹ Neni 425/1 i KPP-së “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon të bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel.

⁴² Neni 416/1 i KPP-së “Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë”.

në të dy rastet e cituara më sipër, është e nevojshme që, nga ana e prokurorit, në rastet kur është kërkuar prej tij përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, ose edhe nga vetë gjykata e apelit, në rastet kur, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor bëhet me iniciativën e saj (*ex officio*), duhet të arsyetohet në mënyrë shteruese fakti se, përse është e nevojshme përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, në kuptimin që, duhen marrë prova të reja që kanë dalë pas dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duhen marrë në shqyrtim prova të cilat janë refuzuar nga gjykata e shkallës së parë, apo është e nevojshme zhvillimi i debatit gjyqësor të kryqëzuar midis palëve, sipas parimit të kontradiktoritetit, ku të përcaktohet fuqia provuese dhe vërtetësia e çdo prove, pa i dhënë asnjërës prej tyre vlerë të paracaktuar.

105. Gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, vetëm nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke u specifikuar prova konkrete e kërkuar, marrja e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit, verifikimi i saj në debat gjyqësor e kontradiktoritet, e nëse argumenton se kjo provë është vendimtare në vlerësimin në raport me provat e tjera. Siç konkludoi Kolegji më sipër, me qëndrimin njësoj, parashikimi i nenit 427, pika 4, të KPP-së nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë.

106. Prandaj në ankim duhet të argumentohet pretendimi për vlerësim të gabuar të provës/provave në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë, dhe nevoja e marrjes së kësaj prove/provave gjatë gjykimit në shkallë të dytë. Gjithashtu duhet të argumentohet pse kjo provë/prova është/janë vendimtare për të provuar faktet mbi të cilat bazohet akuza në gjykimin në shkallë të dytë dhe përse është e nevojshme që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor në nevojën e dëgjimit të provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit.

107. Vlerësimi i gabuar i provave nënkupton vlerësimin e tyre në kundërshtim me parimet e vlerësimit të lirë të provave sipas nenit 152 të KPP-së⁴³ dhe kriterëve të vlerësimit të tyre. Neni 152 i KPP-së ka sanksionuar parimin e vlerësimit të lirë të provave sipas parimit se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar. Vlera si provë merret në shqyrtimin gjyqësor, atëherë kur ajo që ofrohet si e tillë nga palët shqyrtohet, verifikohet, e në fund pranohet si e tillë. Provat që janë mbledhur nga palët në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, kjo në përputhje me përmbushjen e parimit të respektimit të normave procedurale, neni 2 i KPP-së. Papërdorshmëria ngrihet mbi bazën e kërkesave të palëve por dhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procesit. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre.

108. Ky është momenti i vlerësimit të provave një nga një, në mënyrë analitike, në raport me njëra-tjetrën. Çmuarja e vlerësimit, bëhet mbi bazën e asaj çka rezulton gjatë marrjes e shqyrtimit të tyre gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Procesi i çmuarjes e vlerësimit të provave, bëhet sipas parimeve të njohura në nenin 152 të KPP-së. Parimet bazë mbi të cilat zhvillohet ky proces janë se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar, e gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Këto dy parime përbëjnë të ashtuquajturin vlerësim të lirë të provave që do të thotë se procesi i çmuarjes së provave i trajton provat në mënyrë të barabartë duke mos i dhënë asnjërës vlerë të paracaktuar. Gjithashtu ky proces i çmuarjes kryhet në bazë të bindjes së brendshme të gjyqtarit pasi ka shqyrtuar provat në tërësi.

⁴³ 1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj. 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. 3. Deklarimet e bëra nga bashkipandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

109. Neni 152 i KPP-së parashikon se “*Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveç se kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*”. Kjo do të thotë se indiciet që të mund të vlejné për të vërtetuar ekzistencën e një fakti duhet të plotësojnë tre kushte: (i) të jenë të rëndësishme që do të thotë të jenë të vlefshme në ofrimin e një të dhëne faktike, të japin një fakt që ka rëndësi për objektin e të provuarit; (ii) të jenë të sakta, që do të thotë të mos jenë evazive; (iii) të jenë në përputhje me njëra tjetrën. Njësimi i vlerës provuese të provës direkte me atë indirekte do të mund të bëhet vetëm në qoftë se ato janë pa të meta dhe në qoftë se nuk ka dyshim për përputhjen mes tyre.

110. Kuptimi i normativizmit apo ligjësimit në vlerësimin e provës nënkupton një kriter metodik që në mënyrë të saktë e kryen vetëm debati gjyqësor e kontradiktoriteti në gjykim si dhe rregullat formale në marrjen e përdorimin e plotë të një të dhëne, e aftë të arsyetojë vendimin gjyqësor. Vlen të nënvizojmë këtu normat e përcaktuara nga neni 151, mbi ndalimin e përdorimit të provave të marra në mënyrë të paligjshme, parimet e vlerësimit të lirë të provave e mbi të cilat gjyqtarët duhet të bazojnë arsyetimin e vendimit sipas nenit 380 të KPP-së, pra veç ato që janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor. Vlerësimi i provës nga gjyqtari bëhet mbi bazën e arsyetimit, vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara⁴⁴ dhe KPP-ja ka parashikuar si element esencial të vendimit në nenin 383 (1) “ç”, të provave mbi të cilat bazohet vendimi si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta. Kriteret e përgjithshme në vlerësimin e provës janë kriteret metodike kërkojnë domosdoshmërisht respektimin e rregullave formale të mënyrës si janë marrë.

111. Në vlerësimin e provave, ligji ynë procedural në mënyrë të veçantë ka sanksionuar disa kriteret: (i) neni 152/2 i KPP-së që parashikon se ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveç kur janë relevante, të sakta e të përputhshme mes tyre; (ii) paragrafi 3 i nenit 152 të KPP-së që përcakton se deklaratimet e bashkëtëpandehurit apo të pandehurit në procedim të lidhur vlerësohen *në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë*; (iii) neni 153/3 i KPP-së, dëshmitari pyetet për fakte të caktuara dhe nuk mund të dëshmojë për çfarë flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale me përjashtim të rasteve kur ata nuk mund të ndahen nga dëshmia; (iv) neni 154 KPP mbi vlerën e dëshmisë mbi fakte të mësuara nga persona të tjerë; (v) neni 192/5 i KPP-së vendimet e formës së prerë mund të merren me qëllim të provës lidhur me ekzistencën e faktit; (vi) neni 362/3 i KPP-së, deklaratimet në fazën e hetimit paraprak mund të vlerësohen si provë nëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre; (vii) neni 369/3 i KPP-së se leximet e lejueshme mund të vlerësohen duke u lidhur me provat e tjera; (viii) *leximi sipas nenit 370 i KPP-së të deklarimeve të të pandehurit*.

112. Vlerësimi i provës së deklarimeve të të pandehurit, pohimit, mohimit, deponimit ka një karakteristikë të veçantë. Kjo provë duhet vlerësuar me kujdes sipas rastit nëse është pohimi i të pandehurit ose përgjigja e pyetjeve të tij, deklarimi i të pandehurit i kundërshtuar. Kjo do të thotë që mungesa e besueshmërisë plotësohet me elemente të pavarur të aftë të përforcojnë faktin si pasojë e *ratios* – arsyes. Sigurisht që kriteret e vlerësimit janë të ndryshme nëse kemi deklarime të vullnetshme të pandehurit apo përgjigje të pyetjeve të të pandehurit, deklarime të bashkëtëpandehurit apo pohime të të pandehurit. Vetëm debati mbi provën e një natyre të tillë, kontradiktoriteti, kontrolli i kryqëzuar mund të nxjerrë si rezultat vlerësimin e saktë të provës.

113. Marrja në pyetje e dëshmitarëve është një nga aspektet më tipike dhe karakteristike të gjykimit akuzues, e gjykimi penal ka karakteristika të përqendruara në formimin e provave që zhvillohen sipas asaj që është fiziologjia e sistemit, në debat, në kontradiktoritet e nëpërmjet kontrollit të kryqëzuar e vetëm në këtë mënyrë arrihet krijimi i një vlerësimi të saktë për vlerën e kësaj prove e një vërtetim objektiv i faktit për vërtetimin e të cilit shërben si provë.

114. Prokurori duhet të kundërshtojë në ankim rrëzimin e akuzave duke pretenduar se nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë është bërë një vlerësim i gabuar i provave të cilat nëse do ishin

⁴⁴ Neni 142/1 i Kushtetutës “Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara”.

vlerësuar në kontradiktoritet e debat gjyqësor do të sillnin një rezultat tjetër duke u konsideruar të tilla vetëm provat e gjalla ose deklarative, prova të cilat kanë nevojë për verifikim gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, në kontradiktoritet, në debat gjyqësor sipas “kontrollit të kryqëzuar” të provave siç janë pyetja e dëshmitarëve, ballafaqimi, pyetja e të pandehurit, dëshmia dhe pyetja e ekspertit etj.

115. Standardi i të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm sjell si nevojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor me disa nga llojet e provave për të cilat ka nevojë verifikimi për një vlerësim ndryshe që mund të sjellë konfirmimin e pafajësisë ose të akuzës e të fajësisë së rrëzuar në shkallë të parë. Kjo është në përputhje me parimin e marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nga gjyqtari i apelit, duke pasur gjithnjë referim në nenin 6 paragrafi 3, shkronja “d” e KEDNJ-së, dhe mënyrën e interpretimit nga GJEDNJ-ja.

116. Gjyqtari i apelit vijon me marrjen e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë përpara se të arrijë në konkluzionin se është siguruar vlera e provës që mbështet fajësinë e të pandehurit, mbi ato prova që janë konsideruar vendimtare në vendimin e pafajësisë në shkallë të parë. Kjo frymë interpretimi me qëllim respektimin e *reformation in pejus* është zhvilluar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së duke fituar një rëndësi të veçantë në vendimin *Dan kundër Moldavisë*⁴⁵ por edhe më herët⁴⁶, se konfirmimi i përgjegjësisë në gjykimin në apel, i të akuzuarit që ka marrë pafajësi gjatë gjykimit në shkallë të parë duhet të bëhet në një mënyrë që të ofrojë më shumë garanci për të akuzuarin.

117. Detyrimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor ekziston vetëm nëse gjyqtari synon të ndryshojë gjykimin mbi bindjen e brendshme mbi provën që është konsideruar vendimtare në vendimin e gjyqtarit në shkallë të parë. Pranimi i provave të reja të kërkuara në ankim, është i kushtëzuar nga dy momente me rëndësi: *së pari*, kërkitimi i provave të reja duhet të argumentohet në raport me verifikimin e provave të marra gjatë ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, duke vënë në dukje rëndësinë e tyre në raport me vërtetësinë e provës së marrë dhe objektit të provuarit. *Së dyti*, prova e re që kërkohet duhet të jetë vendimtare dhe thelbësore për procesin e të provuarit, nuk duhet të jetë një provë e kërkuar më herët e për të cilën gjykata ka disponuar duke e përfshirë ose jo në fashikullin e gjykimit.

118. Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se, në rastin e apelit të vendimit të pafajësisë, prokurori në aktin e apelit duhet të kërkojë marrjen e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e apelit, kur pretendon se vlerësimi ndryshe i tyre gjatë gjykimit në shkallë të dytë, mund të çojë në një rezultat tjetër që mund të konfirmojë faktet e përgjegjësinë penale të pretenduar. Prokurori duhet t’i përmendë në mënyrë të shprehur këto prova në aktin e ankimit, duke i cituar shprehimisht ato.

119. Vendimarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga kërkitimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, pasi vendimarrja për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duhet të bëhet mbi këtë kërkim. Megjithatë kjo nuk e pengon gjykatën e apelit, e cila kur e çmon të domosdoshme, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues, mund të marrë prova të tjera përveç atyre të kërkuara nga ana e prokurorit.

120. Sa më sipër, **lidhur me nënçështjen e pyetjes së parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin nënësues se:**

Vendimarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga kërkitimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës

⁴⁵ Vendimi i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, i datës 5.11.2011.

⁴⁶ Çështja *Bricmont kundër Belgjikës*, 7.7.1989, çështja *Constănescu kundër Rumanisë*, 27.6.2000, çështja *Destrehem kundër Francës* 18.5.2004, çështja *Garda Ruiz kundër Spanjës*, 21.1.2006, çështja *Manolachi kundër Rumanisë*, 5.3.2013, çështja *Flura kundër Rumanisë* 4.9.2013.

së parë, por kur gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues.

iii. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

2. *Cilat prova mund të merren gjatë gjykimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP-së?*

121. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor përcaktojnë dhe llojin e provave që mund të merren. GJEDNJ-ja lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, në mënyrë të përsëritur është shprehur se dënimi i një të pandehuri në gjykimin në shkallë të dytë, kur ky i fundit ka marrë pafajësinë në shkallë të parë, nuk mund të bëhet pa u respektuar nga ana e gjykatës së apelit parimi i marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë për disa nga llojet e provave. Në disa vendime të saj, GJEDNJ-ja⁴⁷ shprehet se *“Kur një gjykatë apeli i kërket të gjykojë një çështje në fakt dhe në ligj dhe të vlerësojë në tërësi problemin e fajësisë ose pafajësisë, ajo nuk mund, në respekt të standardeve të procesit të rregullt ligjor, të vendosë për këto probleme pa një analizë direkte të dëshmive të dhëna si nga i pandehuri, që pretendon se nuk e ka kryer veprën penale ashtu edhe nga dëshmitarët e pyetur përgjatë procesit dhe dëshmive të të cilëve ai synon t’u japë një interpretim të ndryshëm. Gjykata thekson se ata që kanë përgjegjësinë për të vendosur fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit duhet, si parim, të dëgjojnë drejtpërdrejt dëshmitë dhe të vlerësojnë besueshmërinë e tyre. Vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një detyrë komplekse, që, normalisht, nuk mund të përmbushet thjesht duke lexuar përmbajtjen e deklaratave të këtij të fundit siç është fiksuar në procesverbalin e seancës. Sidoqoftë, gjykata ka nënvizuar se, megjithëse gjykata e cila dënon për herë të parë një të pandehur është e nevojshme që të vlerësojë drejtpërdrejt provat mbi të cilat mbështet vendimin e saj, ky nuk është një rregull automatik që do ta bënte një proces të parregullt për të vetmen arsye se gjykata në fjalë nuk dëgjoji të gjithë dëshmitarët e përmendur në vendimin e saj, besueshmërinë e të cilëve duhej të vlerësohte. Në fakt, duhet të merret gjithashtu parasysh vlera provuese e dëshmive në fjalë.”*⁴⁸

122. Nga jurisprudenca e mësipërme e GJEDNJ-së rezulton se detyrimi konventor i vendit tonë, për respektimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor në gjykimin në apel, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj kur duhet të vendosë për herë të parë për dënimin e të pandehurit, ka të bëjë vetëm me provat verbale, të cilat kanë qenë përcaktuese në deklarimin e tij të pafajshëm.

123. Në marrjen e provave gjykata, si rregull, udhëhiqet nga parimi i pandërmjetësisë. Sipas këtij parimi gjykata e merr dijeninë për faktet dhe rrethanat drejtpërdrejt nga burimi i tyre. Nëse ky parim është rregull për gjykimin në shkallë të parë, ai kthehet në përjashtim për sa i përket gjykimit në apel. Gjykimi në apel përgjithësisht bazohet në provat e formuara dhe të grumbulluara në gjykimin në shkallë të parë. Megjithatë, në raste të caktuara, kur gjykata e apelit duhet të ripërcaktojë vlefshmërinë dhe fuqinë e tyre provuese, ajo përsërit shqyrtimin gjyqësor, duke i rimarrë këto prova.

124. Provat verbale, në dallim nga ato shkresore, formësohen gjatë gjykimit. Për të parat vërtetësia dhe fuqia e tyre provuese testohet gjatë debatit gjyqësor, ndërsa të dytat i kanë të paracaktuara këto dy karakteristika. Për këtë shkak, vlerësimi i provave shkresore mund të bëhet në çdo fazë dhe shkallë të procedimit dhe kjo nuk varet nga nënshtrimi i tyre ndaj debatit gjyqësor. Të vetmet prova të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe që përcaktimi i vërtetësisë e fuqisë së tyre provuese varet nga faktorë të ndryshëm objektivë dhe subjektivë, janë provat e gjalla, ose provat verbale. Këto të fundit, duke qenë relative nga natyra, kanë një peshë e cila mund të ndryshojë, jo vetëm nga kalimi i kohës, por edhe nga njëri vlerësues tek tjetri. Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet gjithashtu se jo çdo provë verbale ka të njëjtën peshë në gjykim,

⁴⁷ Shih vendimet e GJEDNJ-së *Ekbatani kundër Suedisë*, 26 maj 1988, paragrafi 32, *Costantinescu kundër Rumanisë*, nr. 28871/95, paragrafi 55, 27 qershor 2000, *Dondarini kundër San-Marinos*, nr. 50545/99, paragrafi 27, 6 korrik 2004, dhe *Igual Coll kundër Spanjës*, nr. 37496/04, paragrafi 27, 10 mars 2009, shih vendimin e GJEDNJ-së *Lorefice kundër Italisë*, nr. 63446/13, datë 29 qershor 2017, paragrafi 36.

⁴⁸ Shih vendimet e GJEDNJ-së, *Dan kundër Moldavisë*, 8999/07, 5 korrik 2011, paragrafi 33, dhe *Lorefice kundër Italisë*, nr. 63446/13, datë 29 qershor 2017, paragrafi 43.

pra është njësoj përcaktuese për fajësinë e të pandehurit. Detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në apel vlen vetëm për ato prova verbale të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e fajësisë së të pandehurit. Kjo është shprehur mjaft qartë jo vetëm në jurisprudencën e sipërcituar të GJEDNJ-së, por edhe në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara Penale, të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.⁴⁹

125. Qëllimi i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor është që t'i japë mundësinë të pandehurit që të mbrohet e të debatojë mbi provat të cilat në gjykimin në shkallë të dytë mund të marrin një vlerësim tjetër. Gjykimi penal ka karakteristika të përqendruara në formimin e provës që zhvillohet në debat, në kontradiktoritet, nëpërmjet kontrollit të kryqëzuar, adaptim ky i sistemit akuzator atij të *common law* – *adversary system of adjudication*. GJEDNJ-ja ka elaboruar detyrimin e gjykatës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, duke u kufizuar kryesisht në provat verbale (prova me dëshmitarë) (GJEDNJ “*Dan kundër Moldavisë*”, aplikimi nr. 8999/07, vendimi i datës 5.10.2011; “*Hannu kundër Rumanisë*”, aplikimi nr. 10890/04, vendimi i datës 4.9.2013).

126. Nga interpretimi literal i nenit 427/4 të KPP-së, rezulton se gjykata e apelit detyrohet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo situatë, në të cilën i pandehuri deklarohet fajtor për herë të parë nga gjykata e apelit, pa bërë dallim midis llojeve të provave. Neni 427/4 nuk parashikon në mënyrë të shprehur kufijtë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, lidhur me llojet e provave, për të cilat gjykata e apelit është e detyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Në dallim nga parashikimi i legjislationit italian, që sanksionon në mënyrë të shprehur përsëritjen e shqyrtimit për provat verbale, legjislatori ynë nuk ka specifikuar prova konkrete. Dispozita ka parashikuar në mënyrë taksative përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, në çdo situatë, në të cilën mund të deklarohet për herë të parë fajtor i pandehuri, duke mos bërë një dallim midis llojeve të provave. Mungesa e këtij specifikimi mund të konsiderohet një *ometim* legjislativ. Standardi jurisprudencial i GJEDNJ-së në lidhje me ndryshimin e vendimit të pafajësisë nga gjykata e apelit është elaboruar në çështjen *Dan kundër Moldavisë*, si rrjedhojë e të cilit erdhën edhe ndryshimet në nenin 427/4 të KPP-së në vitin 2017. Në këtë çështje, GJEDNJ-ja vlerësoi se, nëse gjykata e apelit është gjykatë që shqyrton faktet dhe ligjin dhe duhet të bëjë një vlerësim të plotë të çështjes për të konkluduar, nëse i pandehuri është apo jo fajtor, në këndvështrim të procesit të rregullt, kjo çështje nuk mund të vendoset pa një vlerësim të drejtpërdrejtë apo direkt të provave.

127. GJEDNJ-ja konsideron se, autoritetet që kanë përgjegjësinë për të vendosur fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit duhet në parim, të jenë në gjendje të dëgjojnë vetë dëshmitarët dhe të vlerësojnë besueshmërinë e tyre. Vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një detyrë komplekse që zakonisht nuk mund të arrihet thjesht me leximin e fjalëve të tij të regjistruara. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka çmuar se, mënyra e zbatimit të nenit 6 në proceset para gjykatës së apelit, varet nga karakteristikat e veçanta të procedimit ku është përfshirë – duhet të merret në konsideratë tërësia e procedurave ligjore të ndjekura në sistemin e brendshëm ligjor dhe roli që ka gjykata e apelit në të.

128. Në këtë rast, Gjikata konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi dënimi i ardhur si pasojë e gjykimit në apel, ishte vendosur pa rimarrë ato prova deklarative, të çmuara si thelbësore. Vlerësimi thjesht i këtyre provave, u çmua nga kjo gjykatë, si absolutisht e pavlefshme në kuadër të garantimit të procesit të rregullt ligjor, duke konsideruar kompleksitetin dhe delikatesën e gjykimit mbi bazueshmërinë e këtyre provave, që bëhet i mundur nga garancia e oralitetit që karakterizon procesin penal akuzator. Në këtë kontekst vlerësohet se marrja e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nënkupton shqyrtimin e tyre në procedurë gjyqësore në debat, kontradiktoritet e mundësinë e kundërshtive e jo vetëm duke i administruar ato.

129. Në çështjen *Chiper kundër Rumanisë*, pretendimi themelor ishte se Gjikata e Lartë ka ndryshuar vendimin e pafajësisë (dhënë nga apeli), pa marrë prova të drejtpërdrejta, veçanërisht provat me dëshmitarë, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se *megjithëse është e nevojshme që gjykata që dënon një të*

⁴⁹ Vendimi nr. 25124/2023 i Gjykatës së Kasacionit në Itali.

akuzuar për herë të parë të vlerësojë drejtpërdrejt provat mbi të cilat ajo mbështet vendimin e saj, ky nuk është një rregull automatik që do ta bënte një gjykim të padrejtë për të vetmen arsye që gjykata në fjalë nuk i dëgjoi të gjithë dëshmitarët e përmendur në aktgjykimin e tij dhe besueshmërinë e të cilëve duhej ta vlerësonte. Është gjithashtu e nevojshme të merret parasysh vlera provuese e dëshmive në fjalë. (shih paragrafin 63 i vendimit Chiper kundër Rumanisë, 2017).

130. GJEDNJ-ja ka konfirmuar parimet e vendosura në çështjen Dan kundër Moldavisë, duke vlerësuar se në procedurat për aplikimin e nenit 6 të Konventës, duhet të merret në konsideratë i gjithë procesi i zhvilluar në sistemin e brendshëm juridik dhe roli i luajtur nga gjyqtari i apelit. Kur një gjyqtar i apelit (*sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit*) shqyrton çështje të faktit dhe ligjit, duke shqyrtuar çështjen e përgjithshme të fajësisë ose pafajësisë të pandehurit, gjyqtari nuk mund, për arsye të drejtësisë së gjykimit, të vendosë për çështje të tilla pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të burimeve të provave. Në rastin konkret, GJEDNJ-ja ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë pasi dëgjoi dëshmitarin në seancë ka deklaruar të pafajshëm ankuesin, pasi konsideroi se dëshmia e këtij dëshmitari nuk ishte e besueshme. Gjykata e apelit ndryshoi vendimin e pafajësisë duke vlerësuar se dëshmitë ishin të besueshme, të sakta dhe të vërtetuara nga elementë të ndryshëm. Gjykata e apelit nuk e kufizoi veten në një vlerësim të ri të elementeve me një natyrë thjesht juridike, por dha një vendim për një çështje faktike, përkatësisht besueshmërinë e dëshmive duke modifikuar kështu faktet e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja theksoi se autoriteti që ka përgjegjësinë për të vendosur për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit, në parim duhet të dëgjojë dëshmitarët personalisht dhe të vlerësojë besueshmërinë e tyre (*Lorefice kundër Italisë, 2017*).

131. Vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një veprimtari komplekse që, normalisht, nuk mund të kryhet thjesht duke lexuar përmbajtjen e deklaratave të këtij të fundit, siç raportohet në procesverbalin e seancave dëgjimore në shkallë të parë. Është karakteristike e sistemit tonë procedural që ka zgjedhur modelin akuzator të gjykimit penal, bazuar në marrjen e provës në gjykim, e në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e konkretisht të pyetjes së dëshmitarit, pyetjes së bashkëtepandehurit, të pandehurit në një procedim të lidhur ose bashkëipandehuri në të njëjtin procedim. Kjo bazohet në vlerësimin e provave deklarative të konsideruara vendimtare në gjykimin në shkallë të parë. Ky është dhe parashikimi analog në KPP italian, ku në nenin 603 të KPP-së italian ndryshuar me ligjin nr. 23/2017, me këtë përmbajtje: “Në rast apeli të paraqitur nga prokurori, kundër një vendimi pafajësie për motive lidhur me vlerësimin e provës deklarative, gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor”, që nënkupton se “*riformatio in pejus*” (reformimi për keq i vendimit të pafajësisë) duhej t’u referohej rasteve kur kërkesa e prokurorit kundër një vendimi pafajësie bazohet në motive që lidhen me vlerësimin e provave deklarative si dëshmitari, bashkëtepandehurit, të pandehurit në një procedim të lidhur ose bashkëipandehuri në të njëjtin procedim. Pra, “*riformatio in pejus*” nga gjykata më e lartë, lidhet detyrimisht me ekzistencën e dy rrethanave: së pari, me kërkesën e prokurorit për vlerësim të gabuar të provave dhe së dyti, ky vlerësim i gabuar t’i referohej jo çdo lloj prove (*siç mund të jenë edhe provat materiale apo dokumentet*), por provave deklarative (dëshmisë, deklarimeve të të pandehurit, ballafaqimeve etj.) kur ato vlerësohen si vendimtare ose thelbësore për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

132. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në çështjen *Di Martino dhe Molinari v. Italy*, vlerësimi ose çmuarja mbi besueshmërinë e një dëshmitari, është një detyrë komplekse që përgjithësisht nuk mund të kryhet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të fjalëve të shkruara e se detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor dhe formësimin e drejtpërdrejtë të provave në gjykimin rishikues nuk mundet të kuptohet si një rregull automatik, që do ta bënte procesin gjyqësor në këtë shkallë gjykimi të parregullt. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se duhet të mbahet parasysh vlera provuese e dëshmitarëve, natyra dhe lloji i provës dhe ekzistenca e elementeve garantues dhe kompensues të së drejtës së mbrojtjes, të afta për të mundësuar procesin e rregullt në tërësi.⁵⁰ Në vendimin nr.

⁵⁰ GJEDNJ, *Dan kundër Moldavisë*, aplikimi nr. 8999/07, vendimi i datës 5.10.2011; *Hannu kundër Rumanisë*, aplikimi

27620, datë 7.7.2016, të Kolegjeve të Bashkuara Penale, të Gjykatës Supreme të Kasacionit Italian, është vlerësuar se gjyqtari i apelit nuk mund të ndryshojë një vendim pafajësie pa urdhëruar paraprakisht, qoftë edhe kryesisht, në zbatim të nenit 603, paragrafi 3, i KPP-së, dëgjimin e dëshmitarëve, deklaratimet e të cilëve kishin qenë përcaktues (*paragrafi 28*). Në vendimin në fjalë, Gjykata e Kasacionit ka afirmuar që ky parim gjen njësoj zbatim edhe në gjykimin e shkurtuar, gjykim në të cilin pafajësia është mbështetur te dëshmitë që kanë qenë konsideruar si përcaktuese në gjykimin në shkallë të parë dhe besueshmëria e të cilave është vënë në dyshim në apel. Në çështjen penale nr. 3007/2021, Gjykata e Kasacionit ka vlerësuar se gjyqtarët që prishin vendimin e pafajësisë së shkallës së parë kanë detyrimin të japin një arsyetim të fortë dhe të tregojnë në mënyrë specifike paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishme të vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Kjo kalon përmes një verifikimi të thellë kritik në kohë dhe që rezulton në një arsyetim të ndryshëm, të plotë dhe më bindës, i cili, duke u mbivendosur në përgjithësi me arsyet e vendimit të shkallës së parë, merr parasysh rezultatet e ndryshme të arritura dhe vlerën më të madhe ose të ndryshme që i jepet secilit element prove që është pjesë e procesit të hetimit. Dënimi përfundimtar duhet të ketë forcë më të madhe bindëse, që të eliminojë çdo dyshim të arsyeshëm për përgjegjësinë e të akuzuarit në rast të prishjes së vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Ndërsa në çështjen penale nr. 25124/2023, është vlerësuar se në rast dënimi në apel për prishje të vendimit të pafajësisë në shkallë të parë, duhet të hidhen poshtë të gjitha arsyet e parashtruara në mbështetje të vendimit të lirit të shkallës së parë *“duke treguar në mënyrë të përpiktë paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumentave më të rëndësishme të përfshira në të”*. Standardi i ndjekur mbështetet në parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pa i dhënë më parë mundësinë të mbrohet, duke riçelur hetimin gjyqësor për dëshmitë kyçe mbi të cilat ishte mbështetur gjykata e shkallës së parë në dhënien e pafajësisë.

133. Megjithëse parashikimi në paragrafin 4 të nenit 427 të KPP-së, nuk është *mot a mot* i njëjti përcaktim si në KPP-në italian në lidhje me motivet që lidhen me vlerësimin e provave deklarative, qëllimi i normës sonë është i njëjtë me atë të legjislacionit procedural burimor pasi është bërë mbi të njëjtat arsye, pikërisht si rezultat i detyrimit të shtetit shqiptar për të përshtatur legjislacionin e brendshëm me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja. Prandaj dhe në këtë rast Kolegji vlerëson se duhet bërë interpretimi gjyqësor dhe ai krahasues i normës me qëllim nxjerrjen e kuptimit të saj, interpretim që duhet bërë mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së, mbi nenin 6 të KEDNJ-së në aspektin penal, jurisprudencë e cila ka ndikuar në krijimin e një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues. GJEDNJ-ja në këtë jurisprudencë ka arsyetuar në mënyrë vazhduese se, në të gjitha rastet kur gjykata e apelit ka juridiksion rishikues fakti sikurse në sistemin tonë juridik e procedural penal, dhe ato shqyrtojnë çështje të fajësisë apo pafajësisë në procesin penal, për hir të respektimit të nenit 6 të KEDNJ-së dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor, ato nuk mund të konkludojnë dhe të vendosin mbi këto çështje pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave, duke nënkuptuar këtu provat e gjalla, në rastet kur ato janë vendimtare për të konkluduar mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

134. Në marrjen e provave gjykata udhëhiqet nga parimi i pandërmjetësisë, ose i marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas së cilit gjykata e merr dijeninë për faktet dhe rrethanat drejtpërdrejt nga burimi i tyre. Nëse ky parim është rregull për gjykimin në shkallë të parë, ai kthehet në përjashtim për sa i përket gjykimit në apel. Detyrimi i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 427 të KPP-së, për gjykatën e apelit ka të bëjë me ripërcaktimin e vlefshmërisë dhe fuqisë provuese të provave gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në shkallë të dytë.

135. Aktet shkresore, procesverbalet ruajnë përmbajtjen dhe fuqinë provuese në gjykimin në fakt e vlerësimi ndryshe i tyre nuk kushtëzohet nga procedura e marrjes së tyre si provë që është e njëjtë si në gjykimin e shkurtuar ashtu dhe atë të zakonshëm. Ndërsa provat e tilla si, dëshmitë, deklaratimet e bashkëtpandehurve, ballafaqimet, pyetjet dhe ripyetjet e ekspertit, mund të

ndryshojnë referuar procedurës së gjykimit apo mënyrës së marrjes së tyre. Ato për nga natyra mund të ndryshojnë jo vetëm me kalimin e kohës por edhe nga momenti procedural i procedimit e shkalla e gjykimit, prandaj konsiderohen si prova të gjalla nga momenti që janë fiksuar në procesverbalet e shkruara në momentin e parë. Fuqia provuese e tyre ndikohet nga faktorët objektivë dhe subjektivë. Prandaj dhe detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në apel vlen vetëm për prova të tilla të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e fajësisë së të pandehurit.

136. Praktika gjyqësore italiane e ka theksuar këtë në disa vendime edhe para ndryshimeve të nenit 603, paragrafi 3-bis të KPPI-së, e në këtë mënyrë praktika gjyqësore ka imponuar ndryshimin e përshtatjen e dispozitës me gjendjen që është sot. Kështu përmendim vendimin nr. 27620 datë 7.7.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali⁵¹ ku arsyetohet se gjyqtari i apelit nuk mund të ndryshojë vendimin e shkallës së parë pa urdhëruar paraprakisht qoftë dhe kryesisht në zbatim të nenit 603, paragrafi 3 të KPP-së dëgjimin e dëshmitarëve, deklaratimet e të cilëve kishin qenë përcaktuese. Detyrimi i gjyqtarit të apelit për të proceduar qoftë edhe kryesisht, me rimarrjen e provave bëhet kur është e nevojshme një vlerësim i ndryshëm i besueshmërisë së një deklarami që konsiderohet e rëndësishme dhe përcaktuese për qëllimin e vendimit të pafajësisë. Fizionomia e provës vendimtare përqendrohet në idenë se vendimi i gjyqtarit të apelit bazohet në një vlerësim të ndryshëm të provës që ka nevojë të dëgjohet në mënyrë verbale e të drejtpërdrejtë në gjykim, merret drejtpërdrejt, të diskutohet, të kundërshtohet, kjo edhe në mundësinë që kjo provë e marrë në këtë mënyrë të konfirmojë dhe pafajësinë.

137. Kjo nënkupton atë që GJEDNJ-ja vë në dukje⁵² se qëllimi i rivlerësimit të përgjithshëm të provave në raport me provën vendimtare të rivlerësuar është një mekanizëm i mundshëm kompensues me garanci të tjera procedurale të përshtatshme, të garantuar në çdo rast nga gjykimi i drejtë. Po në këtë çështje, GJEDNJ-ja ka përdorur konceptin e provës vendimtare në kuptimin e nevojës për t'u dëgjuar⁵³.

138. Në përmbajtje të nenit 427 nuk përmendet lloji i provave e ligji ynë nuk bën diferencë mes natyrës së provave. Në këtë kontekst interpretimi, Kolegji duhet të dallojë natyrën e ndryshme të një kategorie provash që emërtohen si prova të gjalla apo deklarative, natyrë që lidhet me fizionominë e drejtpërdrejtë të provës si e tillë ose me karakterin deklarativ të saj që vjen nga një burim tjetër i provës. Këtu mund të citojmë dallimin që praktika gjyqësore italiane ka bërë në çështjen *Dasgupta*,⁵⁴ në konceptin e provës deklarative në mes të dëshmitarit dhe ekspertit apo konsulentit teknik. Natyra e deklaratave të ekspertëve dhe konsulentëve teknikë do t'i bënte ato të ngjashme me burimin e dëshmisë dhe rrjedhimisht me konceptin e provës deklarative.

139. Në gjykimin e çështjes prej gjykatës së apelit, kjo e fundit që mban përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve duhet që të jetë në gjendje të dëgjojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarët në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së tyre, për sa kohë që ky vlerësim përbën një detyrim kompleks, i cili normalisht nuk mund të konsiderohet i realizuar me një lexim të thjeshtë të deklaratimeve të tyre. Në kuptim të aftësisë së provës për të ofruar të dhëna e besueshmëri mbi faktin e pretenduar, deklarami në formë të shkruar e të lexuar nuk ofron të njëjtën saktësi si dëgjimi i provës në mënyrë të drejtpërdrejtë prandaj dhe vlerësimi mund të jetë i ndryshëm pikërisht për shkak të mënyrës së marrjes së provës.

140. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara që përbëjnë objekt prove sipas paragrafit të parë të nenit 153 të KPP-së dhe vetëm debati, kontrolli i kryqëzuar mund të ekzaminojë dëshminë në tërësi, verifikimin e fakteve që jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndarjen kur ato kanë lidhje me

⁵¹ Vendimi nr. 27620, datë 7 korrik 2016, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, paragrafi 28.

⁵² GJEDNJ, *Dan kundër Moldavisë*, seksioni III, 5 korrik 2011.

⁵³ Vendimi i GJEDNJ-së *Loreface kundër Italisë*, nr. 63446/13, datë 29 qershor 2017, paragrafi 36.

⁵⁴ Vendimi nr. 27620, datë 28.4.2016, i Gjykatës së Kasacionit në Itali, vendim mbi çështjen *Dasgupta*.

qëndrimin moral të të pandehurit, ndarje e dëshmisë mbi atë që flitet nga dëshmia mbi faktet e përcaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, referimin te personi nga ku e ka mësuar faktin. Pyetja e dëshmitarit ka si komponent të vlefshmërisë së saj aktin solemn të betimit për të dëshmuar të vërtetën⁵⁵, ndalimin e pyetjeve që ndikojnë në paanësinë nga pala që ka kërkuar pyetjen duke mos përjashtuar tashmë mundësinë e pyetjeve sugjeruese nga pala tjetër, në favor të sigurimit të kontrollit të mirëfilltë e dhënies së të gjitha mundësive për të debatuar mbi provën⁵⁶. Pyetja e të pandehurit dhe e palëve private, parashikuar nga nenet 166 vijues të KPP-së, ballafaqimi sipas nenit 169 të KPP-së, pyetja e ekspertit, janë gjithashtu prova të karakterit të gjallë e konsiderohen në grupin e provave deklarative.

141. Për sa u përket të dhënave që përftohen nga “prova e gjallë” dëshmia në seancë gjyqësore, dhe vlerësimin e saj si provë, legjislacioni ynë procedural sanksionin të njëjtin kuptim e vlerësim të provës “logjike”. Neni 153, paragrafi 3 i KPP-së: “Objekti dhe kufijtë e dëshmisë” parashikon se “Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara. Ai nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet”. Neni 154 i KPP-së “Dëshmia indirekte” parashikon “Kur dëshmitari, për njohjen e fakteve u referohet personave të tjerë, gjykata, me kërkesën e palës ose kryesisht urdhëron që këta të thirren për të dëshmuar. Mosrespektimi i dispozitës së paragrafit 1 i bën të papërdorshme thëniet mbi faktet, të cilat dëshmitari i ka mësuar nga persona të tjerë, me përjashtim të rasteve kur pyetja e tyre është e pamundur për shkak se kanë vdekur, janë të sëmurë rëndë ose nuk gjenden”. Ndërsa neni 362 i KPP-së “Kundërshtimi i dëshmisë” parashikon “1. Për të kundërshtuar tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.”.

142. Gjykata e Apelit kur vlerëson se vendimi i pafajësisë duhet ndryshuar ka detyrimin që të bëjë një arsyetim të fortë dhe të tregojë në mënyrë specifike paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishëm të vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Kjo kalon përmes një verifikimi të thellë analizues e kritik në kohë dhe që rezulton në një arsyetim të ndryshëm, të plotë dhe më bindës, i cili, duke u mbivendosur në përgjithësi me arsyet e vendimit të shkallës së parë, bazohet në rezultatet e ndryshme të arritura dhe vlerën më të madhe ose të ndryshme që i jepet secilit element prove që është pjesë e procesit të të provuarit.

143. Ndryshimi i vendimit të pafajësisë në apel, duhet të ketë forcë më të madhe bindëse, që të eliminojë çdo dyshim të arsyeshëm për përgjegjësinë e të akuzuarit e të konfirmojë standardin e provës tej dyshimit të arsyeshëm, në rast të prishjes së vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Gjyqtari i apelit ka detyrimin të ripërsërisë provat e gjalla apo deklarative përpara se të ndryshojë vendimin e pafajësisë të shkallës së parë, kjo si në rastin e ankimit të paraqitur nga prokurori ashtu edhe nga pala private subjekt në gjykim.

144. Kriteri i marrjes së vendimit duhet të interpretohet në kuptimin që prova që do merret nga apeli (prova e gjallë/deklarative) është vendimtare kur ka të bëjë me një element i cili, në bazë të vendimit të shkallës së parë, është vlerësuar si moskonfirmues i fakteve mbi të cilat bazohet fajësia, e nëse vlerësohet në tërësinë e materialit provues, mund të marrë një vlerë provuese për të ndikuar në rezultatin e vendimit të ankimuar. Provat vendimtare verbale përbëjnë gjithashtu prova që megjithëse gjykohen nga gjyqtari i shkallës së parë me pak ose aspak vlerë, të jenë të rëndësishme për ankuesin vetëm ose bashkë me prova të tjera që ndikojnë në vendimmarrje. Si e tillë është prova me dëshmitarë, ballafaqimi mes dëshmitarëve, pyetje e të pandehurit, pyetje e

⁵⁵ Neni 360 i KPP-së “Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit”.

⁵⁶ Ndryshimi i paragrafit 3 të nenit 361 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

bashkëtëpandehurit apo e të pandehurit në një procedim të lidhur, pyetja e ekspertit ose e palës private.

145. Gjykata e apelit duhet të argumentojë në mënyrë të përpiktë, sipas detyrimit të nenit 383 shkronja “ç”, me rregullat e përcaktuara në nenin 152 të KPP-së, paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishme mbi të cilat është dhënë vlerësimi i provës në gjykimin në shkallë të parë dhe përse gjatë marrjes së saj në gjykimin në apel kjo provë merr një vlerë tjetër. Gjykata e apelit duhet të argumentojë përse kjo provë është vendimtare për vlerën e përgjegjësisë në raport me provat e tjera.

146. Karakteristikë e sistemit procedural është zgjedhja e modelit akuzator të gjyimit penal, bazuar në marrjen e provës në gjykim e në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata. Kjo bazohet në vlerësimin e provave deklarative të konsideruara vendimtare në gjykimin në shkallë të parë. Në rastin e dëshmisë vlerësohet se kërkesa e prokurorit duhet të bazohet në mënyrë specifike në nevojën e verifikimit të besueshmërisë së dëshmitarit në kuadër të një vlerësimi të ndryshëm mbi bazën e të cilit është motivuar dhe ankimi sipas nenit 422 të KPP-së. Megjithatë, detyrimi nuk shtrihet në dëshmitë, përmbajtja e të cilave është e padiskutueshme, por në lidhje me të cilat thirret një vlerësim i ndryshëm i elementeve konfirmuese; në lidhje me dëshmi të tilla, rishqyrtimi lihet në gjykim të gjyqtarit, i cili mund ta ushtrojë atë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 425 të KPP-së.

147. Kolegji vlerëson dhe konkludon se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t’u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave “deklarative”. Kjo do të thotë se kjo mënyrë e të proceduarit në gjykimin rishikues në apel do të jetë e nevojshme që të realizohet vetëm kur fajësia/pafajësia e të pandehurit mbështetet kryesisht në provat me natyrë deklarative, të tilla si, dëshmia, deklaramet e bashkëtëpandehurve, ballafaqimet, pyetjet apo ripyetjet e drejtpërdrejta të ekspertit.

148. Në vlerësimin si më lart, Kolegji mban parasysh arsyen juridike të krijimit të një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues. Në këtë drejtim Kolegji vlerëson dhe konkludon se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t’u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave të gjalla e deklarative. Për të konkluduar në këtë mënyrë Kolegji ka në vëmendje formulimin simotër të dispozitës analoge italiane, konkretisht nenin 603, pika 3-*bis* e KPPI-së. Kjo dispozitë formulon rregullin se, në rastin e apelit të prokurorit ndaj një vendimi pafajësie për shkaqe të vlerësimit të provave deklarative, gjykata e apelit vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

149. Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se provat që mund të merren gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit duhet të jenë prova vendimtare e thelbësore për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit dhe të afta për të ndryshuar bindjen e gjyqtarit në lidhje me përmbushjen e funksionit themelor të dhënies së drejtësisë. Në kuptim të nenit 427/4 të KPP-së, si dhe praktikës së sipërcituar, Kolegji vlerëson se detyrimi i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor gjatë gjyimit të çështjes në gjykatën e apelit, lind vetëm në rastin kur pafajësia ose fajësia e të pandehurit determinohet në procesin gjyqësor penal nga shqyrtimi i provave deklarative, si dëshmitë, deklaramet e bashkëtëpandehurve, ballafaqimet, pyetjet dhe ripyetjet e ekspertit.

150. Sa më sipër, **lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Gjatë gjyimit në shkallë të dytë, në përputhje me nenin 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat deklarative që janë të nevojshme në drejtim të përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit.

iv. Në lidhje me çështjen e tretë të shtruar për njësim:

3. Në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjyimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP-së në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar ?

151. Në nenin 403 të KPP-së nën titullin “Kërkesa për gjykimin e shkurtuar” parashikohet shprehimisht: “1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi. 2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.”, ndërsa në nenin 405 pika 5, 6, 7 dhe 8 të KPP-së nën titullin “Seanca e gjykimit të shkurtuar” parashikohet shprehimisht: “5. Pasi dëgjon palët mbi kërkesat paraprake, gjykata lexon kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe pyet të pandehurin nëse i qëndron asaj. Kur i pandehuri deklaron se i qëndron kërkesës, gjykata deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe i jep fjalën prokurorit që në mënyrë të përmblëdhur të parashtrijë rezultatet e hetimeve paraprake. 6. Pasi dëgjon parashkrimin e prokurorit, në të njëjtën seancë gjykata vendos pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në të kundërtën refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. 7. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo përdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet edhe në rastet kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave, si rezultat i të cilave çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen e akteve. Në këtë rast, në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës gjykata përvakton edhe aktet absolutisht të pavlefshme apo provat e papërdorshme në gjykim. Ky rregull nuk zbatohet kur kërkohen prova lidhur me personalitetin e të pandehurit, apo gjendjen e tij personale, familjare ose ekonomike. 8. Kur gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjykata fton palët të paraqesin diskutimet përfundimtare.”

152. Gjykimi i shkurtuar mund të zhvillohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit dhe vetëm atëherë kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Tashmë jurisprudenca e konsoliduar gjyqësore është e qartë se ky rit i posaçëm gjykimi është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas ritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyrën e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget procedura normale e shqyrtimit gjyqësor. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshëm, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Si përfitim të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3, në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ai deklarohet fajtor.

153. Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit. Ky përfitim nuk duhet kurrësi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Pra, kërkesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtim gjyqësor. Kolegji çmon, gjithashtu, se në pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar gjykata është e detyruar të mbajë në konsideratë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka marrë në analizë institutin e gjykimit të shkurtuar.

154. Në vendimin nr. 4, datë 10.2.2012, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, shprehet se: “Në këndvështrimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye legjislatori për këtë lloj gjykimi ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403–406), të cilave gjyqtarët duhen t’i përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm”.

155. Gjykata Kushtetuese ka krijuar standardin jurisprudencial mbi detyrimin që ka gjykata e apelit në aplikimin e garancive procedurale të gjykimit të shkurtuar kur konstatohet se padrejtësisht është refuzuar kjo kërkesë gjatë gjykimit në shkallë të parë. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se për të garantuar një të drejtë ankimi efektive ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, gjykata e apelit duhet të jetë në gjendje që të shqyrtojë e kontrollojë në mënyrë efikase ligjshmërinë e ushtrimit të diskrecionit nga ana e gjykatës së shkallës së parë në marrjen e

vendimit, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe substanciale. Nëse gjykata e apelit, që shqyrton ankimin ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, konstaton se çështja mund të shqyrtohet në gjendjen e akteve dhe kërkesa e të pandehurit për gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë, ajo ka kompetenca të ndryshojë vendimin në lidhje me masën e dënimit, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP-së. Kjo bëhet me qëllim që të vihet në vend një e drejtë e mohuar dhe i pandehuri të përfitojë reduktimin e dënimit.

156. Në çështjen *di Martino dhe Molinari kundër Italisë* (nr. 15931 dhe 16459/15, datë 25 mars 2021), kërkesit ishin gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, duke u dënuar për një pjesë të akuzave, duke u shpallur të pafajshëm për pjesën tjetër. Ndaj vendimit të gjykatës ushtroi ankim prokuroria. Gjykata e Apelit e Napolit vendosi të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke shpallur fajtor kërkesin për të gjitha veprat penale për të cilat ishte akuzuar nga prokuroria. Vendimmarrja e gjykatës së apelit në thelb erdhi jo vetëm si rrjedhojë e vlerësimit të ndryshëm të deklaratave të disa personave të penduar gjatë hetimeve paraprake por edhe provave të tjera mbledhur gjatë hetimit. Ankuesi pretendoi në rekurs se i është cenuar pozita gjatë gjykimit në apel (*reformation in pejus*). Gjykata e Kasacionit e rrëzoi pretendimin e kërkesit duke theksuar se që në shkallë të parë, gjykimi është zhvilluar sipas rritit gjykimor të gjykimit të shkurtuar dhe se gjykata e apelit nuk kishte qasje të drejtpërdrejtë në dëshmitë pasi kjo gjykatë kishte një marrëdhënie të ndërmjetme me deklaratat. Gjykata e Kasacionit solli në vëmendje vendimin *Dan k. Moldavisë* (nr. 8999/07, 5 korrik 2011), ku GJEDNJ-ja saktësoi se gjykata e apelit përpara se të ndryshojë një vendim pafajësie, duhet të urdhërojë një dëgjim të ri të dëshmitarëve *me kushtin e dyfishtë* që dëshmia në fjalë të ishte vendimtare dhe që ishte i nevojshëm rievlerësimi i besueshmërisë së dëshmitarëve, ndërsa në rastin konkret Kasacioni mbajti qëndrimin se gjykata e apelit nuk kishte dyshuar besueshmërinë e dëshmitarit në fjalë, por thjesht kishte bërë një lexim të saktë dhe logjik të provave në dispozicion.

157. GJEDNJ-ja rikujtoi se, kur një instance apeli i kërkohej të shqyrtojë një çështje në fakt dhe në ligj dhe të vlerësojë çështjen e fajit ose të pafajësisë në tërësi, nuk mundet, për arsye të drejtësisë procedurale, t'i vendosë këto çështje pa vlerësim të drejtpërdrejtë të dëshmisë⁵⁷. Gjykata rikujton se ata që kanë përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit duhet, në parim, të dëgjojnë personalisht dëshmitarët dhe të vlerësojnë besueshmërinë e tyre. Vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një detyrë komplekse, e cila normalisht nuk mund të realizohet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të përmbajtjes së deklaratave të dëshmitarit, siç është regjistruar në procesverbalet e seancave (*Dan, cituar më lart, § 33, dhe Lorefice, cituar më lart, § 43*). Pavarësisht sa më sipër, GJEDNJ-ja thekson se megjithëse është e nevojshme që gjykata që dënon një të akuzuar për herë të parë të vlerësojë drejtpërdrejt provat mbi të cilat ajo mbështet vendimin e saj, ky nuk është një rregull automatik që do ta bënte një gjykim të padrejtë për të vetmen arsye se gjykata në fjalë nuk dëgjoi të gjithë dëshmitarët e përmendur në aktgjykimin e saj, besueshmërinë e të cilëve duhej të vlerësohej.

158. GJEDNJ-ja theksoi se krahas avantazheve të padiskutueshme të këtij riti gjykimor, gjykimi i shkurtuar shoqërohet me një dobësim të garancive procedurale që ofron ligji i brendshëm, veçanërisht në lidhje me publicitetin e procedimit, mundësinë e kërkit të provave që nuk gjenden në dosjen e prokurorisë dhe thirrjen e dëshmitarëve. Gjykata vlerësoi se me miratimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar, ankuesit, të ndihmuar nga avokatët, ranë dakord të bazojnë mbrojtjen e tyre në dokumentet e mbledhura gjatë hetimeve paraprake dhe kështu hoqën dorë pa mëdyshje nga e drejta e tyre për thirrje dëshmitarësh në gjykim. Për më tepër, kërkesit e dinin ose duhej ta dinin se në rast të shpalljes së pafajësisë në shkallë të parë, gjykata e apelit kishte kompetencën për të rigjykuar çështjen mbi bazën e provave të njëjta. Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e ankuesve për t'u gjykuar sipas procedurës së shkurtuar solli heqjen

⁵⁷ GJEDNJ, *Ekbani kundër Suedisë*, 26 maj 1988, § 32, seria A nr. 134, *Constantinescu kundër Rumanisë*, nr. 28871/95, § 55, GJEDNJ 2000 VIII, *Dondarini kundër San-Marinos*, § 27, 6 korrik 2004, dhe *Igual Coll*, nr. 04, § 27, 10 mars 2009.

dorë nga provat verbale dhe rezultoi se gjykimi u bazua në provat dokumentare të vendosura në dosje. Gjykata rikujtoi se megjithëse është e vërtetë që shtetet kontraktuese nuk janë të detyruara nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, kur ekzistojnë procedura të tilla dhe janë miratuar, parimet e gjykimit të drejtë kërkojnë që të pandehurit të mos privohen arbitrarisht nga avantazhet që i bashkëngjiten. Është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe mbrojtjen e pritshmërive legjitime të palëve ndërgjyqëse që një shtet të jetë në gjendje, në mënyrë të njëanshme, të zvogëlojë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë nga disa të drejta të qenësishme në nocionin e një gjykimi të drejtë. Në vështrim të Gjykatës, asgjë e ngjashme nuk ndodhi në çështjen në fjalë, ku ankuesit përfituan nga ulja e dënimeve si rezultat i miratimit të procedurës së shkurtuar. Për rrjedhojë, gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk mund të ankohet për cenim të së drejtës për një gjykim të drejtë, që rrjedh nga mosdëgjimi nga gjykata e apelit të dëshmitarëve dhe nuk u konstatua cenim i nenit 6 të KEDNJ-së.

159. Në praktikën gjyqësore italiane⁵⁸, Seksionet e Bashkuara kanë konkluduar se *një rekurs është i pranueshëm për shkak të moszbatimit të rregullit të gjykimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, kur vendimi i gjykatës së apelit mbi ankimin e prokurorit pobon fajësinë e të pandehurit dhe ndryshon vendimin e pafajësisë dhënë nga gjykata e shkallës së parë përmes rritit gjykimor të shkurtuar, kryen një vlerësim të ndryshëm të deklaratave që konsiderohen decizive, pa proceduar me gjykim në apel me pyetjen e personave që i kanë bërë këto deklarata*. Në këtë kontekst konkludohet përmes sentencës njësuere të Seksioneve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, se duhet të riçelet shqyrtimi gjyqësor për pyetjen e personave, deklaratat e të cilëve konsiderohen decizive për përcaktimin e fajësisë edhe pse gjykimi në shkallë të parë është përmbyllur përmes procedurave të gjykimit të shkurtuar. Rrjedhimisht sentenca njësuere e mësipërme në përmbushje të kushteve të caktuara, dikton riçeljen e shqyrtimit gjyqësor në apel *pavarësisht rritit gjykimor të ndjekur* nga gjykata e shkallës së parë, pra nuk ka dyshime nëse riçelja e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 427/4 të KPP-së, mund të aplikohet në rastet kur pafajësia në shkallë të parë është konkluduar përmes gjykimit të zakonshëm apo rritit të gjykimit të shkurtuar.

160. Në thelb të qëndrimit mbi ruajtjen e përfitimit të uljes së dënimit në gjykatën e apelit, pas përfitimit të pafajësisë me anë të gjykimit të shkurtuar në shkallë të parë, qëndron argumenti se përmes gjykimit të shkurtuar i pandehuri dakordëson “*një marrëveshje*” me autoritetin publik përmes së cilës ai pranon të heqë dorë nga disa të drejta procedurale në këmbim të uljes së dënimit përfundimtar në masën e 1/3 së tij (*eventualisht nëse do të ketë vendim dënimi*).

161. GJEDNJ-ja, në rastin *Scoppola kundër Italisë* (çështja nr. 2, viti 2009), ka trajtuar standardet jurisprudenciale në drejtim të ruajtjes së kësaj garancie procedurale edhe kur gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, është riçelur shqyrtimi gjyqësor për rimarrjen e provave të gjalla, apo provave të reja. Gjykata ka vlerësuar se një person i akuzuar për një vepër penale duhet të jetë në gjendje të presë që shteti të veprojë në mirëbesim dhe të marrë parasysh zgjedhjet procedurale të bëra nga mbrojtja, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji. Është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe mbrojtjen e besimit legjitim të personave të përfshirë në procese gjyqësore që një shtet të jetë në gjendje të zvogëlojë në mënyrë të njëanshme avantazhet që lidhen me heqjen dorë nga disa të drejta të qenësishme në konceptin e gjykimit të drejtë. Duke qenë se një heqje dorë e tillë bëhet në këmbim të avantazheve të caktuara, nuk mund të konsiderohet si e drejtë që pasi autoritetet vendëse kompetente kanë rënë dakord të miratojnë një procedurë të thjeshtuar, një element thelbësor i marrëveshjes ndërmjet shtetit dhe të pandehurit të ndryshohet në dëm të këtij të fundit pa pëlqimin e tij. Në lidhje me këtë, gjykata vëren se, megjithëse shtetet kontraktuese nuk u kërkohej nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara kur procedura të tilla ekzistojnë dhe janë miratuar, parimet e gjykimit të drejtë kërkojnë që të pandehurit nuk duhet të privohen në mënyrë arbitrare nga avantazhet që u bashkëngjiten. Në këtë kontekst sillet në vëmendje se jurisprudenca e GJEDNJ-së në vijimësi ka vlerësuar se shtetet

⁵⁸ Në vendimin e Seksioneve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr. 18620, datë 14.4.2017.

anëtare nuk ndalohen të vendosin standarde më të larta në raport me ato të vendosura nga Konventa.

162. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr. 124/2019, është trajtuar (pa)pajtueshmëria e ndryshimeve të nenit 603-3 bis të KPP-së italian me Kushtetutën e Republikës së Italisë. Gjykata referuese (*Gjykata e Apelit të Trentos*) ka ushtruar kontroll incidental ndaj nenit 603 (3) bis të KPP-së italian, nën argumentin themelor se ky parashikim ligjor cenon ritin e gjyimit të shkurtuar i cili duhet të bëhet sipas nenit 438 të KPP-së italian në gjendjen që janë aktet. Në vendimin e gjykatës referuese, ndër të tjera, argumentohet se cenohen disa parime të procesit të rregull duke u ndalur në disa aspekte: (i) kohëzgjatja e gjyimit në afate të arsyeshme; (ii) zhvillimi i gjyimit do duhet të jetë brenda pritshmërive të ligjshme që ka i pandehuri që në shkallë të parë i cili edhe në rast dënimi në apel ruan garancinë procedurale të uljes së dënimit në 1/3; (iii) parimi i barazisë ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes (i cili sipas gjykatës megjithëse nuk nënkupton domosdoshmërisht identitetin e kompetencave procedurale, duke pasur parasysh dallimet fiziologjike në role), bën të mundur që “ndryshimet e simetrisë së fuqive dhe aftësive përkatëse” duhet të kenë “një raport adekuat justifikues” dhe duhet “të përmbahet brenda kufijve të arsyeshmërisë”, ndaj krijohet një dyshim i arsyeshëm se riçelja e detyruar e shqyrtimit gjyqësor në apel, ndryshon në mënyrë të paarsyeshme simetrinë lidhur me të drejtën e të pandehurit për të përfituar në çdo rast uljen e dënimit me 1/3, me të drejtën e përfaqësuesit të prokurorisë publike për të përdorur provat e mbledhura dhe të “siguruara” në hetimet paraprake (*të cilat kanë fituar tashmë cilësinë e provave “akuzuese”*).⁵⁹

163. Në funksion të pretendimeve të mësipërme, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë, ka rrëzuar kërkesën për papajtueshmëri të normës (me Kushtetutën dhe Direktivën nr. 2012/29/UE). Në funksion të analizës së këtij vendimi është arritur (ndër të tjera) *maksima nr. 42637*, në të cilën theksohet se zgjatja e afateve procedurale si pasojë e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës së apelit justifikohet nga domosdoshmëria e kontaktit të drejtpërdrejtë mes gjyqtarit dhe dëshmitarit, *edhe në rastet kur shkalla e parë ka vepruar në procedurën e gjyimit të shkurtuar*, si një nevojë për të tejkaluar dyshimin e arsyeshëm që përcakton ndryshimin e një vendimi të dhënë me përfundime kontradiktore dhe për të *siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesit parësor të të akuzuarit që të mos dënohet padrejtësisht*. Heqja dorë vullnetarisht nga garancitë procedurale të gjyimit kontradiktor në formimin e provave, e shprehur nga i akuzuari në kërkesën e tij për vijimin e gjyimit në shkallë të parë sipas ritit gjykimor të shkurtuar, jo detyrimisht është e aplikueshme në çdo fazë të gjyimit, përfshirë dhe gjykimin në apel. Po kështu, duhet përjashtuar shkelja e parimit të barazisë së palëve, duke qenë se dispozita e kundërshtuar, parashikon përmbushjen e një detyrimi nga ana e gjyqtarit, çka nuk sjell asnjë çekuilibrim ndërmjet kompetencave procedurale të palëve dhe nuk e vendos të akuzuarin në një pozitë avantazhi arbitrar në lidhje me prokurorin publik. *Parimi i zgjatjes së arsyeshme të gjyimit duhet të balancohet me grupet e tjera të garancive kushtetuese në mënyrë që kjo “sakrificë” të mos jetë më objekt rishikimi (kur s’ka një justifikim të vlefshëm)*, ndaj vetëm rregullat procedurale që zgjasin afatin e gjyimit dhe që nuk mbështeten nga ndonjë nevojë logjike, mund të shkaktojnë shkelje të këtij parimi.⁶⁰

164. Gjykata ka theksuar se nuk krijohet asnjë premisë për të cenuar baraspeshën procedurale të palëve, pasi sikurse një gjykim në shkallë të parë është përmbyllur në rit të shkurtuar dhe pafajësi, po ashtu palët brenda kapacitetit të plotë procedural në një gjykim kontradiktor përballen me njëra-tjetrën në kushte të barabarta për kuptimin dhe besueshmërinë e provave të mbledhura gjatë hetimeve paraprake, me qëllim vërtetimin ose reformimin e aktgjyimit të pafajësisë së shpallur në shkallë të parë.

165. Lidhur me të drejtën e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor në apel, kur gjykata e shkallës së parë ka proceduar me gjykim të shkurtuar duke dhënë vendim pafajësie për të pandehurin, janë

⁵⁹ Vendimi nr. 124/2019 i Gjykatës Kushtetuese të Italisë.

⁶⁰ Vendimi nr. 124/2019 i Gjykatës Kushtetuese të Italisë.

mbajtur qëndrime dhe nga Kolegji, qëndrime të cilat konstatohet se janë në të njëjtën linjë parimore me jurisprudencën e sipërcituar. Në vendimin nr. 00-2022-657, datë 21.1.2022 nga ana e Kolegjit është përkrahur teza se *gjkimi në apel nënkupton një përsëritje të shqyrtimit gjyqësor pa u kushtëzuar nga riti i gjykimit të shkurtuar*. Gjykimi i shkurtuar është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas rritit normal të gjykimit është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyrën e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale/provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget faza normale e hetimit gjyqësor. Si përfitim të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3, në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri deklarohet fajtor. Rimarrja e provave materiale apo dokumenteve, tashmë sipas një procedure normale mund t'u japë atyre një vlerë tjetër në kushtet e kontradiktoritetit dhe debatit gjyqësor e kjo në veçanti nëse ka prova me dëshmitarë e në rast se diskutohet vlera e deklaramëve të dëshmitarëve të pyetur në fazën e hetimeve paraprake, të fiksuara në procesverbalet e pyetjes së tyre, nëse rimarrja e dëshmisë do të jetë e pamundur për shkak të vdekjes së dëshmitarit apo mosgjetyes së tij.

166. Në një rast tjetër të praktikës gjyqësore (vendimi nr. 00-2023-2007, datë 5.12.2023 të KPGJL-së), Kolegji ka konkluduar se “*Sa i përket shkaktit tjetër të rekursit atij të keqinterpretimit e moszbatimit të parashikimit të paragrafit 4 të nenit 427 të KPP-së, mbi detyrimin e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në rast të cenimit të vendimit të pafajësisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, Kolegji, sjell në vëmendje se zbatimi i parashikimit të këtij neni është i zbatueshëm jo vetëm në rastin e shqyrtimit në apel të një çështje penale të përfunduar me vendim pafajësie përgjatë gjykimit të zakonshëm, por edhe në rastin e procedimit me ritin e gjykimit të shkurtuar. Kjo, për sa kohë vet ligjvënësi, në pikën 4 të nenit 427 të KPP-së, nuk ka bërë dallimin e situatave të gjykimit në shkallë të parë me ritin e gjykimit të shkurtuar apo me gjykimin e zakonshëm. Lidhur me këtë moment, jurisprudenca e vendeve me model të ngjashëm procedural me tonin në këtë pikë, ka konkluduar se zbatimi i normës ligjore që detyron gjykatën e apelit të riçelë shqyrtimin gjyqësor në rastet e apelit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë të gjykatës së shkallës së parë, kur është proceduar në këtë shkallë gjykimi me ritin e posaçëm të gjykimit të shkurtuar, nuk përbën në vetvete shkelje të parimeve të gjykimit të drejtë”.*

167. Kolegji, në vendimin nr. 00-2023-1078, datë 30.6.2023, ka mbajtur qëndrimin mbi pranimin e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor (dhe marrjen e provave të reja), ndonëse gjykimi në shkallë të parë është përmbyllur me ritin gjykimor të shkurtuar. Kolegji ka vlerësuar se detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, edhe kur procedimi me gjykim të shkurtuar ka qenë i drejtë, nuk nënkupton cenimin e qëllimit të këtij riti të posaçëm gjykimi, por përmbylljen e detyrimit për gjykim të drejtë që në rast të rëndimit të pozitës së personit shkon drejt rritit normal që konsiston në marrjen dhe dëgjimin e drejtpërdrejtë të provave nga gjykata e apelit. Detyrimi i përcaktuar në nenin 427, pika 4 ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 datë 30.3.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në rastet kur çështja në shkallë të parë është shqyrtuar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, do të zbatohet drejt nëse do të përsëritej ky shqyrtim për marrjen e provave të reja, qoftë mbi kërkesën e prokurorit si subjekti ankues, qoftë edhe kryesisht nga gjykata e apelit, por gjithnjë pa cenuar rregullshmërinë e procesit të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë dhe për rrjedhojë, të përfitimit nga ana e të pandehurit të uljes së dënimit. Kolegji ka vlerësuar se nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqësor i ripërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rast të vendimit të fajësisë nga gjykata e apelit.

168. Verifikimi i provës vendimtare është një kusht thelbësor i saktësisë dhe plotësimit të arsytimit për vlerësimin e provave, veçanërisht kur motivimi duhet të jetë i një standardi më të lartë të argumentimit për ndryshimin e një vendimi fajësie që është ai i tej dyshimit të arsyeshëm i lidhur drejtpërdrejt me parimin e prezumimit të pafajësisë. Nga këndvështrimi i të akuzuarit, mosmarrja e provës deklarative, shmanget një kontroll efektiv të argumenteve nga debati i drejtpërdrejtë mbi provën mbi të cilën është bazuar akuza, prandaj përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme sipas paragrafit të 4 të nenit 427 të KPP-së, nëse ankimi i prokurorit bazohet

në vlerësimin e gabuar të provës që mund të merret drejtpërdrejt në gjykim e në debat gjyqësor e kontradiktoritet. Referimi është në procedurën e gjykimit të zakonshëm për provat që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë në debat gjyqësor gjatë seancës gjyqësore. Në rastin e gjykimit të shkurtuar gjyqtari i apelit duhet të zbatojë marrjen e provës deklarative në procesin e të provuarit, pasi ato janë vlerësuar vetëm në bazë të dokumenteve sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, neni 403 e vijues i KPP-së.

169. Në analizë të jurisprudencës së cituar më lart, në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se neni 427/4 i KPP-së⁶¹, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, aplikohet si në rastet kur gjykimi në shkallë të parë është bërë me gjykimin e zakonshëm ashtu edhe në rastin kur gjykimi ka vijuar me gjykimin e shkurtuar, pasi natyra e gjykimit në shkallë të parë nuk dikton vendimarrjen e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur prej saj çmohet e nevojshme riçelja e shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe përmes marrjes së provave të reja.

170. Kolegji vlerëson se kjo dispozitë është njëlloj e zbatueshme edhe në rastin e shqyrtimit në apel të një çështje penale e cila është përmbyllur me vendim pafajësie përgjatë gjykimit të zakonshëm dhe përgjatë gjykimit të shkurtuar, duke konkuduar se zbatimi i kësaj dispozite në gjykimin në apel nuk lidhet dhe nuk mund të kushtëzohet nga riti procedural me të cilin është zhvilluar gjykimi në gjykatën me juridiksion fillestar.

171. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji, në zbatim të interpretimit krahasues të legjislacionit të ngjashëm procedural penal me atë burimor, e nën lupën e verifikimit të standardit kushtetues, parimeve të procesit të rregullt ligjor e atij të sigurisë juridike, ka në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë, të mbajtur në një rast të kontestimit përmes kontrollit incidental nga gjykata *a quo* mbi zbatimin e pikës 3-*bis* të nenit 603 të KPP-së në gjykimin e shkurtuar, konkretisht simotra italiane e rregullimit ligjor të pikës 4 të nenit 427 të KPP-së shqiptar. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë ka konkluduar në këtë rast se zbatimi i normës ligjore që detyron gjykatën e apelit të riçelë shqyrtimin gjyqësor në rastet e apelit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë të gjykatës së shkallës së parë, kur është proceduar në këtë shkallë gjykimi me ritin e posaçëm të gjykimit të shkurtuar, nuk vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor dhe parimin e ekonomizimit procesual. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë ka konkluduar se riti i posaçëm i gjykimit të shkurtuar nuk mund të dëmtojë interesat publike të dhënies së drejtësisë⁶².

172. Kolegji vlerëson se në këto raste mundësia e ndryshimit të vendimit të pafajësisë dhe dhënia e një vendimi dënimi në gjykimin në apel nuk passjell humbjen e së drejtës së të pandehurit për uljen e dënimit për shkak të zbatimit të gjykimit të shkurtuar në gjykimin fillestar, pasi kjo e drejtë e tij lidhet me ligjshmërinë e dënimit sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së⁶³. Ulja e dënimit për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar është një e drejtë e të pandehurit që rrjedh prej ligjit procedural por që ka elementin material të përcaktimit të masës së dënimit dhe bën pjesë në konceptin e dënimit që duhet të formësohet dhe individualizohet në çdo rast sipas ligjit me të gjitha elementët e tij. Në këto raste gabimi i organeve shtetërore në ritin e gjykimit dhe në gjykim nuk mund të justifikojë dënimin pa ligj të të pandehurit dhe nuk mund të dëmtojë kurrësi pozitën juridike të tij (*in peius*).

173. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Kushtetuese, jurisprudencë e cila ka theksuar se përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjykata e apelit, dhe nëse kjo gjykatë vlerëson se është i pajustificueshëm refuzimi i gjykimit të shkurtuar, duhet të aplikojë dënim të reduktuar, edhe pse procedura e ndjekur nuk ka qenë ajo e gjykimit të shkurtuar⁶⁴. Jurisprudenca

⁶¹ Neni 427, paragrafi 4 i KPP-së: “4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.”.

⁶² Vendimi nr. 124, datë 20–23 mars 2019, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

⁶³ GJEDNJ, *Scoppola v. Italy no.2*, Ap. no. 10249/03, vendimi i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 17.9.2009.

⁶⁴ Vendimi nr. 21 datë 16.4.2012, i Gjykatës Kushtetuese.

kushtetuese në këtë rast duhet kuptuar në mënyrë të tillë që të detyron të konkludohet edhe në të kundërt po njëloj, që do të thotë se, edhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë ka proceduar me gjykim të shkurtuar dhe ka konkluduar në pafajësinë e të pandehurit, gjykimi rishikues sipas ritit të zakonshëm në gjykatën e apelit mbi bazën e apelit të prokurorit nuk mund dhe nuk duhet të ndikojë në përcaktimin e dënimit penal të të pandehurit, duke mos i hequr dot atij në këtë mënyrë një të tretën e dënimit penal.

174. Në çështjen “*Di Martino dhe Molinari v. Italy*”⁶⁵, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi i parë, të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja ka arsyetuar se detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor dhe formësimin e drejtpërdrejtë të provave në gjykimin rishikues nuk mundet të kuptohet si një rregull automatik, që do ta bënte procesin gjyqësor në këtë shkallë gjykimi të parregullt. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se duhet të mbahet parasysh vlera provuese e dëshmitarëve, natyra dhe lloji i provës dhe ekzistenca e elementeve garantues dhe kompensues të së drejtës së mbrojtjes, të afta për të mundësuar procesin e rregullt në tërësi⁶⁶. GJEDNJ-ja solli në vëmendje se në çdo rast duhet të mbahen parasysh se standardet e procesit të rregullt ligjor varen dhe lidhen ngushtë me llojin e procedurës së parashikuar lidhur me shkallën konkrete të gjykimit⁶⁷. GJEDNJ-ja, pasi solli në vëmendje se heqja dorë nga debati gjyqësor ka qenë vullnet i qartë eksplisit i të pandehurit dhe se ai ka pranuar vullnetarisht të gjykohej përmes provave të mbledhura gjatë hetimit nga prokurori dhe duke qenë në dijeni të tyre, solli në vëmendje se ky rast ndryshon nga rastet e tjera të jurisprudencës së saj në të cilat është konkluduar për shkeljen e nenit 6 të KEDNJ-së, ndryshimi i vendimit të pafajësisë në gjykimin në apel pa u dëgjuar në mënyrë të pandërmjetësuar dëshmitarët.⁶⁸

175. Duke sjellë në vëmendje edhe interpretimin e zgjeruar të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë, mbi detyrimin e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor edhe në rastin e gjykimit të shkurtuar, kur objekt apeli është vendimi i pafajësisë, GJEDNJ-ja solli në vëmendje në këtë jurisprudencë se shtetet mundet të sanksionojnë standarde më të larta mbrojtjeje nga sa parashikon KEDNJ-ja. GJEDNJ-ja theksoi se, pavarësisht se detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në apel kur kundërshtohet vendimi i pafajësisë nga ana e akuzës dhe ky vendim është bazuar në prova të gjalla (prova verbale) ekziston edhe kur në shkallë të parë gjykimi është zhvilluar me ritin e shkurtuar, në rastin konkret provat vendimtare për shpalljen e kërkesve fajtorë dhe dënimin e tyre nuk ishin provat verbale dhe se provat me dëshmitarë nuk bënin gjë tjetër veçse konfirmonin provat e tjera dokumentare, duke përfunduar me konsideratën se shpallja e tyre fajtor dhe më pas pas dënimi ishte produkt i interpretimit të ndryshëm të të gjitha elementeve që vinin nga burimet e provave, duke mos qenë përcaktuese thëniet e dëshmitarëve. Zbatimi i standardit të të provuarit sipas kriterit “*përtej dyshimit të arsyeshëm*” e kushtëzoi gjyqtarin e apelit që edhe në procedurën e gjykimit të shkurtuar të marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë vetë provën pavarësisht procedurës së gjykimit e mungesës së shqyrtimit gjyqësor.

176. Lidhur me aplikimin e uljes së dënimit, Kolegji vlerëson se duhet të mbahen në konsideratë standardet në jurisprudencën e GJEDNJ-së në çështjen *Scoppola kundër Italisë*⁶⁹ ku GJEDNJ-ja konsideron se neni 442, paragrafi 2 i KPP-së është një dispozitë e së drejtës materiale lidhur me kohëzgjatjen e dënimit që duhet të jepet në rast të dënimit pas gjykimit sipas procedurës përmbledhëse e bie në kuadër të fjalisë së fundit të nenit 7 paragrafi 1 të Konventës. Gjithashtu, në këtë vendim, GJEDNJ-ja analizoi nëse ndaj kërkesit Scoppola është aplikuar ligji penal favorizues, duke aplikuar dënimin më të butë, duke theksuar, ndër të tjera, se: “*Nga kjo*

⁶⁵ Vendimi i GJEDNJ-së, çështja *Di Martino dhe Molinari kundër Italisë*, Ap. no. 15931/15 dhe 16459/15, vendim i seksionit të parë të GJEDNJ-së, datë 25 mars 2021.

⁶⁶ GJEDNJ, *AlKhaajja et Tabery c. Royaume-Uni*, req. n° 26766/05 et 22228/06, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ, paragrafi 131, CEDH 2011.

⁶⁷ GJEDNJ, *Botten c. Norvège*, vendim i GJEDNJ-së datë 19 shkurt 1996, paragrafi 39.

⁶⁸ Paragrafët nr. 36 dhe 37, të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen *Di Martino dhe Molinari kundër Italisë*.

⁶⁹ “Ankimi nr. 10249/03” vendimi i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i datës 17 shtator 2009.

rrjedh se kërkuesit i është shqiptuar një dënim më i rëndë se ai i parashikuar nga ligji, i cili nga të gjitha ligjet në fuqi gjatë periudhës ndërmjet kryerjes së veprës penale dhe dhënies së aktgjyqimit të formës së prerë, ishte më i favorshëm për të. Në dritën e sa më sipër, gjykata konsideron që shteti i paditur nuk e ka përmbushur detyrimin e tij për t'i dhënë kërkuesit përfitimin e dispozitës që parashikon një dënim më të butë që kishte hyrë në fuqi pas kryerjes së veprës penale. Nga kjo rrjedh se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 7 paragrafi 1 të Konventës.”. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se pavarësisht se dispozita që rregullon procedurën e gjyqimit të shkurtuar citohet në KPP, ajo është dispozitë procedurale me elemente materiale, pasi përmban rregulla që lidhen me dënimet dhe kohëzgjatjen e saj.

177. Në këtë mënyrë, duke mbajtur parasysh gjithçka u soll në vëmendje më lart, Kolegji vlerëson se në shqyrtimin e apelit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë, pavarësisht se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar sipas ritit të posaçëm të gjyqimit të shkurtuar, nevoja e shqyrtimit të apelit kundër vendimit të pafajësisë është e tillë që bën të domosdoshme marrjen e një/më shumë provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e shkallës së dytë, duke përsëritur shqyrtimin gjyqësor, tashmë në këtë shkallë sipas rregullave të gjyqimit të zakonshëm. Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast fokusohet vetëm në marrjen e një prove e cila duhet të merret në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi është vendimtare për përfundimin e gjyqimit në këtë shkallë.

178. Nevoja për marrjen e provave të reja në apel ose detyrimi i gjykatës së apelit për të ndrequr gabimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, brenda kompetencave të saj rishikuese si gjykatë ligji dhe fakti, të cilat kanë diktuar nevojën e zhvillimit të gjyqimit në shkallë të dytë përmes riçeljes së shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të cenojnë të drejtat procedurale të fituara nga i pandehuri për uljen e 1/3 së dënimit, dhe se një interpretim i ndryshëm i ligjit penal do të ishte jo proporcional për shkak të rëndimit *in pejus* të pozitës së të pandehurit dhe cenimit të parimit të sigurisë juridike.

179. Kolegji vlerëson se interpretimi në këtë mënyrë i nenit 427 paragrafi 4 i KPP-së, nuk cenon karakteristikat e gjyqimit të shkurtuar gjatë të cilit nuk kemi shqyrtim gjyqësor, ndërkohë që në këtë nen parashikohet mundësia e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor. Në mënyrën sesi Kolegji arsyetoi më sipër, shqyrtimi gjyqësor është pikërisht ajo pjesë e gjyqimit në apel që konsiston në nevojën për marrje në mënyrë të drejtpërdrejtë të një prove në procedurën e gjyqimit të zakonshëm. Detyrimi për një gjykim të drejtë e një vendim të bazuar në prova tejkalon kufizimin procedural për shkak të natyrës së veçantë të gjyqimit të shkurtuar dhe garanton një gjykim objektiv.

180. Si përfundim, Kolegji arrin në konkluzionin se, zbatimi i gjyqimit të shkurtuar në shkallë të parë, nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, qoftë edhe përmes marrjes së provave të reja, ku në rast se gjykata e apelit ndryshon vendimin e pafajësisë, të pandehurit i ruhet dhe i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit.

181. Sa më sipër, **lidhur me çështjen e tretë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Nëse çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjyqimit të shkurtuar, parashikimi i nenit 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor edhe përmes marrjes së provave të reja. Të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit, në rast të dhënies së vendimit të fajësisë nga ana e gjykatës së apelit.

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

182. Në lidhje me shkaqet e parashtruara në rekurs nga ana e të gjykuarit Gjergj Lekaj, Kolegji konstaton se ato paraqiten në dy drejtime, në lidhje me shkeljet procedurale të pretenduara gjatë gjyqimit të çështjes pranë gjykatës së apelit, për shkak të përsëritjes pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, po kështu edhe pretendime në lidhje me zgjidhjen e çështjes pranë gjykatës së apelit.

183. Lidhur me pretendimin e të gjykuarit se gjykata e apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 427 të KPP-së, pasi ka bërë riçelje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që shqyrtimi gjyqësor duhet të bëhet tërësor, Kolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Sipas analizës dhe interpretimit të kryer më sipër në këtë vendim njësuës, Kolegji ka arsyetuar se,

riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste është kompetencë diskrecionare e gjykatës së apelit, e cila përsërit shqyrtimin gjyqësor në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave. Rrjedhimisht përsëritja e shqyrtimit gjyqësor mund të jetë e plotë ose e pjesshme në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se përsëritja e pjesshme e shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së apelit, nuk sjell zbatim të gabuar të nenit 427/4 të KPP-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk e ka deklaruar fajtor të gjykuarin mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave.

184. Lidhur me pretendimin e të gjykuarit se prokurori nuk ka parashtruar shkaqe në ankimin e ushtruar pranë gjykatës së apelit, Kolegji konstaton se ky pretendim është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka argumentuar kërkimet e prokurorit në mjetin procedural ankim. Ndryshe nga sa pretendon i gjykuari se prokuroria nuk ka zbatuar pikën 2, të nenit 415, të KPP-së, për shkak se prokurori ka kërkuar gjatë gjykimit riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, apo se prokurori ka bërë analizë ligjore të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga gjykata e apelit është arsyetuar se, “kjo dispozitë (neni 415, KPP) bën fjalë për parashtrimin e argumenteve të tjera shtesë, të arsyeve që lidhen me ankimin, ndërkohë që në rastin konkret nuk ndodhemi përpara arsyeve shtesë që lidhen me ankimin, por ndodhemi përpara një kërkesë për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Ky veprim i prokurorit nuk rregullohet nga kjo dispozitë ligjore. Në këtë kuptim referimi në këtë dispozitë nuk gjen zbatim në rastin konkret”. Po kështu, edhe pretendimi i të gjykuarit se prokurori është lejuar nga gjykata për të ngritur arsye të tjera, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se nuk ndodhemi përpara arsyeve shtesë që lidhen me ankimin, por para interpretimit ligjor të ligjit.

185. Lidhur me pretendimin e të gjykuarit se gjykata e apelit ka cenuar parimin e barazisë së armëve, Kolegji vëren se ky pretendim është i pabazuar. Ky pretendim, sikurse edhe pretendimet e tjera të parashtruara nga i gjykuari gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se, nuk qëndron pretendimi se gjatë gjykimit në apel është cenuar parimi i barazisë së armëve.

186. Gjykata e apelit me të drejtë ka vlerësuar se parimi i “Barazisë së armëve” është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që: a) secilës palë në proces t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj) në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër; b) me vlerësimin e njëjtë që duhet t’u bëjë gjykata provave dhe fakteve të paraqitura nga të gjitha palët në proces dhe pranimin ose jo të tyre vetëm pasi t’i ketë shqyrtuar dhe arsyetuar mjaftueshmërisht pranimin ose mospranimin e tyre, sipas rastit. Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj ka theksuar se marrja dhe vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e apelit ka kryer të gjitha veprimet procedurale për respektimin e barazisë së armëve. Gjykata i ka dhënë të pandehurit dhe avokatit mbrojtës të gjithë kohën e duhur për të shqyrtuar provat që ka paraqitur prokurori, i ka dhënë gjithë kohën e mundshme për shqyrtimin e tyre. Për sa i përket kërkesës për caktimin e një grupi ekspertësh, rrëzimi i kërkesës nga gjykata e apelit, nuk e bën procesin e parregullt. Kërkesa për caktimin e një grupi ekspertësh nuk është pranuar nga gjykata, duke dhënë edhe arsyet përkatëse në vendim.

187. Për sa u përket pretendimeve të të gjykuarit se mungojnë elementet e veprës penale të “Shpërdorimit të kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i KP-së, Kolegji rikonfirmon qëndrimin se vlerësimi i fakteve dhe provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se, gjykata e apelit ka arsyetuar gjerësisht lidhur me konsumimin e elementeve të veprës penale, sipas standardit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova. Ndryshe nga sa pretendon i gjykuari, vendimmarrja e gjykatës së apelit është e mirarsyetuar, duke marrë në analizë të gjitha elementet e veprës penale, po kështu edhe pretendimet e të gjykuarit të parashtruara para gjykatës së apelit.

188. Lidhur me pretendimet e të gjykuarit për mungesën e subjektit të veprës penale, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit, me të drejtë ka arritur në konkluzionin se i gjykuari, në cilësinë e drejtorit të shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a. është subjekt i posaçëm i veprës penale të “Shpërdorimit të kompetencave”, parashikuar nga nenin 164 i KP-së. Neni 164 i KP-së parashikon se *“Shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”*. Dispozita ligjore ka parashikuar si subjekt të posaçëm të kryerjes së kësaj veprë penale, funksionet drejtuese të shoqërisë, konkretisht anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërisë. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se i gjykuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur emërtimin drejtor i shoqërisë “Emanuel Gas” sh.a., funksioni i tij ka qenë administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë, funksion i njëjtë me atë të administratorit të shoqërisë. Me të drejtë, gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk është emri ai që e bën një shtetas subjekt të një marrëdhënie juridike civile apo penale që rregullohet me ligje të posaçme, por është funksioni që kryen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fakti i mosndryshimit të emrit të përfaqësuesit të shoqërisë nga ana e Këshillit Mbikëqyrës, apo e asamblesë së ortakëve, nga drejtor në administrator, nuk e përjashton të gjykuarin nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga funksioni që ai ka ushtruar në shoqërinë tregtare “Emanuel Gas” sh.a., funksion i cili rregullohet si nga ligji për shoqëritë tregtare, ashtu edhe nga statusi i shoqërisë. Mungesa e këtij titullimi formal nuk mund ta përjashtojë atë nga përgjegjësitë që rrjedhin nga ushtrimi i kësaj veprimtarie. Vetë pasqyrimet në regjistrin tregtar në ekstraktin e QKR-së i shkarkimit apo zëvendësimit të të gjykuarit Gjergj Lekaj, nga funksioni i drejtorit, tregon se funksioni i tij ka qenë i njëjtë me atë të administratorit.

189. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret objekt shqyrtimi, në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 441, të KPP-së, duhet të vendoset lënia në fuqi e vendimit nr. 110, datë 30.7.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 110, datë 30.7.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 6.11.2024

Kryesues: Ilir Panda

Anëtarë: Sokol Binaj, Albana Boksi, Medi Bici, Sandër Simoni